

PËRMBAJTJA E REVISTËS:

Numri XLII, viti 2008

Faqe

Reforma ligjore dhe procesi i integritit:

Udhëzues për negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në BE	Alfred KELLERMANN	4
Mbrojtja e të dhënave vetjake - një sfidë e re për shoqërinë shqiptare	Rezana BALLA	21

E Drejta Kushtetuese:

Shteti i së Drejtës dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës	Prof. Dr. Avdullah ROBAJ	41
Konfliktet gjeopolitike në Europë dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Strasburgut	Merita ANDREA	52
Gjykata në politikë	Gustavo ZAGREBELSKY	92

Nga veprimtaria e Kuvendit:

Legjislacioni i miratuar	Filipi LAKO	107
--------------------------	-------------	-----

TABLE OF CONTENTS:

42th issue, year 2008

Page

Legal reform and the Integration process:

Guidelines for Accession Negotiations of Albania in EU

Alfred KELLERMANN 4

Personal data protection – a new challenge for the Albanian society

Rezana BALLA 21

Constitutional Law:

Rule of Law and the Constitution of the Republic of Kosovo

Prof. Dr. Avdullah ROBAJ 41

Geopolitical conflicts in Europe and jurisprudence of
the European Court of Strasbourg

Merita ANDREA 52

Court in Politics

Gustavo ZAGREBELSKY 92

From the activity of the Assembly:

Information about legislation approved by the Assembly

Filip LAKO 107

Rubrikat në vijim synojnë prezantimin e politikave ligjore dhe të trajtimeve teorike për organizimin dhe funksionimin e institucioneve kushtetuese. Botuesi vlerëson si një kontribut në zhvillimin dhe përmirësimin e funksionimit të institucioneve kushtetuese, paraqitjen e opinioneve dhe të mendimeve të studiuesve të ndryshëm, në mënyrë të paanshme dhe objektive, duke nxitur një debat profesional.

Opinionet e paraqitura janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë qëndrimin e botuesit të kësaj reviste.

Udhëzues për negociatat e Shqipërisë për anëtarësimin në BE

*Alfred Kellermann**

Përktheu: Erjola Xhuvani

PARAQITJE

Pas ratifikimit të MSA-së nga të gjitha vendet anëtare të BE-së, e cila pritet të përfundojë në fund të vitit 2008, MSA-ja mund të hyjë në fuqi në fillim të vitit 2009. Si rrjedhojë do të hyjnë në fuqi shumë të drejta dhe detyrime të reja.

Disa nene të MSA-së do të kenë efekt të drejtpërdrejtë, si për shembull, nenet 46 dhe 49 për trajtimin e njëjtë të qytetarëve dhe kompanive shqiptare. Nene të tjera (neni 116, 120 dhe neni 122, Kreu X, Dispozita Institucionale, të Përgjithshme dhe të Fundit), parashikojnë krijimin e Këshillit të Stabilizim-Asociimit, Komitetin e Asociimit, si dhe Komitetin Parlamentar të Stabilizim-asociimit.

Përfaqësues të Qeverisë Shqiptare do të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit dhe Komitetit të Stabilizim-Asociimit. Këto zhvillime do të rrisin volumin e punës për Zyrat e Administratës Shqiptare dhe nevojën për bashkërendim. Pra, si rrjedhojë, nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor për çështjet e bashkërendimit.

Mund të ngrihen pyetje të reja, për shembull, mbi efektet ligjore të vendimeve

* Autori është Drejtues i Ekipit në Projektin “Për forcimin e kapaciteteve administrative të Ministrisë së Integrimit”.

të Këshillit të Stabilizim-Asociimit në rendin e brendshëm ligjor shqiptar.

Nëse më pas do të paraqitet një aplikim për anëtarësim (ku sipas projektit të Traktatit të Lisbonës, aplikimi nuk do të notifikohet vetëm nga Këshilli i BE-së dhe Parlamenti European, por edhe nga parlamentet e shteteve anëtare të BE-së), Shqipëria ndoshta mund të marrë statusin e vendit kandidat. Kështu, pas këtij hapi mund të ngrihen pyetje të reja. Pas miratimit të vendimit përfundimtar të Shqipërisë për aplikimin për anëtarësim, për sa i përket njohjes së Shqipërisë si vend kandidat, do të këshillohej nisja e negociatave të anëtarësimit dhe zhvillimi i një konference dypalëshe ndërqeveritare për anëtarësimin.

Në mënyrë që Administrata Shqiptare të ketë njohuri më të mira për procedurat e negociatave të anëtarësimit, impaktin e saj si dhe në mënyrë që të rritet ndërgjegjësimi për nevojën në rritje të bashkërendimit në Qeverinë Shqiptare, janë hartuar udhëzuesit e mëposhtëm.

NEGOCIATAT E ANËTARËSIMIT NDRYSHOJNË NGA NEGOCIATAT NDËRKOMBËTARE TRADICIONALE.

Siç u vendos në Këshillin European të dhjetorit në vitin 2004, negociatat e anëtarësimit do të mbështeten në nenin 49 të Traktatit të Bashkimit European.

“Çdo shtet anëtar që respekton parimet e shpallura në nenin 6, paragrafi 1 mund të kërkojë të bëhet anëtar i BE-së. Ai i drejton kërkesën e tij Këshillit, i cili mund të shprehet njëzëri, pasi të jetë këshilluar me Komisionin dhe më pas merret pëlqimi nga Parlamenti European, i cili shprehet me shumicën absolute të anëtarëve që e përbëjnë.

Kushtet e pranimit dhe të përshtatjes që duhen bërë, për shkak të këtij pranimi, traktatet, mbi bazën e të cilave është themeluar Bashkimi, janë objekt i një marrëveshjeje ndërmjet shteteve anëtare dhe shtetit kërkues. Kjo marrëveshje i nënshtrohet ratifikimit nga ana e të gjitha shteteve palë, në përputhje me rregullat e tyre kushtetuese”.

Në fillim të bisedimeve, Shqipëria e cila aplikon për anëtarësim, pritet që

të deklarojë gatishmërinë e saj për të përafuar legjislacionin e saj me *acquis communautaire*. Për të pranuar këtë kusht, duhet të bëhet ekzaminimi i legjislacionit aktual dhe një analize e boshllëkut legjislativ.

Këto lloj detyrimesh bëjnë dallimin e negociatave të anëtarësimit nga ato tipike ndërkombëtare. Gjatë negociatave ndërkombëtare palët bëjnë lëshime të ndërsjella, në mënyrë që të arrijnë në një marrëveshje të balancuar. Një vend, i cili aplikon për anëtarësim, duhet të pranojë detyrimet që rrjedhin nga anëtarësimi dhe nuk mund të pranojë ndryshime në rregullat themelore mbi të cilat është mbështetur funksionimi i Bashkimit Europian. Objektivi i përbashkët i negociatave është anëtarësimi. Këto negociata janë një proces, fundi i të cilit nuk ka një datë të caktuar dhe përfundimi nuk mund të garantohet para kohe. Duke respektuar të gjitha Kriteret e Kopenhagenit, përfshirë këtu edhe kapacitetin e përthithjes, nëse Shqipëria nuk është në gjendje të realizojë të gjitha detyrimet e anëtarësimit, duhet të sigurojë që është e ankoruar në strukturat europiane nëpërmjet një detyrimi të fortë. Në përgjithësi, negociatat mbështeten në meritat e Shqipërisë dhe ritmi do të varet nga progresi i Shqipërisë në realizimin e kërkesave për anëtarësim. BE-ja do të vendosë nëse kushtet për përfundimin e negociatave janë plotësuar. Kjo do të bëhet në bazë të një raporti të Komisionit Europian për plotësimin e kërkesave të anëtarësimit. Aspektet e veçanta të natyrës dhe karakteri i veçantë të negociatave të BE-së ndikojnë të gjithë procesin. Rregullat bazë të negociatave dhe të praktikës të zgjerimit të mëparshëm të BE-së përcaktojnë procesin e vendimmarrjes për negociatat e ardhshme. Zgjerimi duhet të fuqizojë procesin e integritimit, në të cilin janë angazhuar BE-ja dhe vendet e tij anëtare. Komisioni duhet të monitorojë kapacitetin e integritit të Shqipërisë gjatë negociatave, duke përcaktuar gjithë çështjet që i përkasin perspektivës së anëtarësimit të Shqipërisë në një dokument të vetëm, në mënyrë që të konkludohet në një vlerësim nga ana e Këshillit si dhe të shikohet nëse janë realizuar kushtet e anëtarësimit.

Duhet të studiohen tri karakteristikat e praktikave të mëposhtme të negocimit:

▪ **Pranimi i zbatimit të *acquis communautaire* në fillim të negociatave**

Negociatat hapen pas “shqyrtimit”, nëse Shqipëria ka realizuar mjaftueshëm kriteret politike të parashikuara në Këshillin European të Kopenhagenit 1993, kryesisht nenin 6 (1) të Traktatit të Bashkimit European, të cituar dhe në Kartën e të Drejtave Themelore dhe pas një rishikimi analitik dhe vlerësimi të shkallës së përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis*. BE-ja pret që Shqipëria të mbështesë procesin e reformave dhe të punojë për përmirësimin e respektimit të parimeve të lirisë, demokracisë dhe të shtetit të së drejtës, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe liritë themelore, përfshirë këtu dhe jurisprudencën e legjislacionit european. Gjithashtu, Shqipëria duhet të konsolidojë legjislacionin dhe të zbatojë masat veçanërisht për sa i përket tolerancës zero në luftën kundër torturës dhe keqtrajtimit, si dhe zbatimit të masave lidhur me lirinë e shprehjes, të besimit, të drejtave të grave, standardeve ILO, duke përfshirë këtu të drejtat e dhomave të tregtisë dhe të minoriteteve. BE-ja dhe Shqipëria do të vazhdojnë dialogun politik në mënyrë intensive. Për të siguruar progres të pakthyeshëm në këto fusha, sidomos në atë të lirive themelore dhe respektimit të të drejtave të njeriut, progresi do të monitorohet nga Komisioni, i cili është i ftuar të raportojë rregullisht në Këshillin e BE-së, duke adresuar të gjitha pikat problematike, të cilat janë identifikuar në raportet e Komisionit dhe rekomandimet, si dhe në raportet vjetore.

▪ **Karakteri ndërqeveritar i negociatave të anëtarësimit**

Kur Shqipëria të aplikojë për anëtarësim, ajo duhet të informojë jo vetëm Këshillin e BE-së dhe Parlamentin European, por edhe siç e parashikon Traktati i Lisbonës kur të hyjë në fuqi, edhe parlamentet e vendeve anëtare të BE-së.

Në një dokument të Projektit SMEI, i hartuar nga Steven Blockmans në

mars të vitit 2008, publikuar në Raportin e Tretë të SMEIT, kushtet për aplikimin për anëtarësim janë përpunuar ashtu si dhe koha për aplikim për vendet anëtare të Ballkanit Perëndimor. Për Shqipërinë skenari i mëposhtëm është imagjinar. Me anë të tij mund të dallojmë rolin e institucioneve shqiptare dhe të institucioneve të BE-së.

Propozimi i Qeverisë Shqiptare për aplikimin duhet të dërgohet për miratim në Parlamentin e Shqipërisë. Pas kësaj, propozimi duhet të dërgohet në Presidencën e BE-së e cila duhet ta fusë në axhendën e saj, si dhe në Këshillin dhe Komisionin e BE-së, për mendim. Në të njëjtën kohë, sipas Traktatit të Lisbonës, propozimi duhet të dërgohet te parlamentet e vendeve anëtare të BE-së, të cilat duhet ta miratojnë.

Si rezultat i kërkesës për mendim, të bërë nga Shqipëria, Komisioni European duhet të dërgojë një pyetësor për Shqipërinë. Nëse përgjigjet e pyetësorit vlerësohen pozitivisht, Komisioni European mund t' i japë Shqipërisë statusin e vendit kandidat dhe të miratojë një kuadër për negociatat e anëtarësimit. Së fundi, Parlamenti European duhet të japë një opinion për këtë çështje. Në procesin e vendimmarrjes gjatë negociatave, Këshilli i BE-së dhe BE-ja luan një rol kryesor nëpërmjet miratimit në mënyrë të njëzëshme të dokumentit për qëndrimin e përbashkët të BE-së. Në përputhje me Traktatin e BE-së, të gjitha vendet anëtare, pas vlerësimit të Parlamentit European, duhet të ratifikojnë Traktatin e Anëtarësimit. Në praktikë negociatat në pjesën më të madhe trajtojnë çështje teknike në përgatitjen e të cilave Komisioni European luan një rol kyç, në bashkëpunim dhe me vendet anëtare të BE-së. Fakti që dokumenti kërkon njëzëshmëri, ka pasojë të mëdha për mënyrën në të cilën janë drejtuar negociatat dhe procesi i vendimmarrjes brenda BE-së mund të ndikohet nga një vend kandidat. Për pasojë, mbështetja diplomatike e Shqipërisë nuk duhet të përqendrohet vetëm te Brukseli. Ka raste të veçanta ku vendet candidate duhet të përpiqen të bindin kryeqytetin e një vendi anëtar në favor të tij. Vendimet kyçe merren nga Këshilli European dhe Këshilli i BE-së. Ato garantojnë dhe respektojnë elementet e bashkëpunimit ndërqeveritar brenda BE-së. Vendimet

për lehtësitë teknike për shërbimet negociuese i përkasin Komisionit European dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Zgjerimit, e cila merret me karakterin teknik të procesit të integrimit.

Detyrat e kësaj Drejtoria janë:

- 1) Menaxhimi dhe bashkërendimi i procesit legjislativ “screening”;
- 2) bashkërendimi i përgatitjes së projektpozicioneve të përbashkëta të BE-së;
- 3) përgatitja e projektlegjislacioneve lidhur me negociatat;
- 4) përfaqësimi i Komisionit në Këshillin e BE-së;
- 5) bashkërendimi i shërbimeve teknike lidhur me zgjerimin.

Ndërsa Parlamenti European jep vlerësimin e tij për aplikimin për anëtarësim dhe duhet të miratojë përfundimin e negociatave, Shqipëria (Qeveria dhe Parlamenti) duhet të bindë anëtarët e Parlamentit European që anëtarësimi i Shqipërisë do të jetë një vlerë e shtuar për integrimin në BE.

▪ **Negociata të veçanta me vendet e tjera që aplikojnë në të njëjtën kohë**

Nuk është ende e qartë nëse vende të tjera do të aplikojnë për anëtarësim. Për lehtësi reference dhe krahasimi midis të gjitha vendeve të Ballkanit Perëndimor, SMEI ka hartuar një tabelë me të dhënat relevante në procesin e stabilizim-asociimit, si dhe të procesit të paraanëtarësimit. Nëse Shqipëria do të aplikojë për anëtarësim në vitin 2010, cilat vende të tjera do të përfshihen në negociatë? Kroacia dhe Maqedonia kanë statusin e vendit kandidat. Vetëm për Kroacinë kanë filluar negociatat e anëtarësimit. Gjithsesi pritet që në një të ardhme të afërt vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, si Maqedonia dhe Serbia do të fillojnë negociatat e anëtarësimit.

Formalisht negociatat me çdo vend aplikant do të jenë të veçanta. Procesi “screening” për vendet e Ballkanit në përafrimin e legjislacioneve ka nevojë për një trajtim “tailor made”. Përvoja e Kroacisë është instruktuese për

Shqipërinë, përderisa Kroacia ka kaluar në procesin e stabilizim-asociimit. Në periudhën e anëtarësimit, Shqipërisë do t'i kërkohet të përshtatë politikat e saj në mënyrë progresive me vendet e treta dhe me organizatat ndërkombëtare (duke përfshirë anëtarësimin nga të gjitha vendet anëtare të BE-së të këtyre organizatave), me politikat dhe pozitat e miratuara nga Bashkimi European dhe vendet e tij anëtare.

Hapja formale e negociatave do të bëhet në Bruksel. Vendimi për të filluar procesin e zgjerimit do të merret në samitin e Këshillit European.

Substanca e negociatave do të paraqitet në një Konferencë Ndërqeveritare me pjesëmarrjen e të gjitha vendeve anëtarë, nga njëra palë dhe të Shqipërisë nga pala tjetër.

SUBSTANCA E NEGOCIATAVE

Anëtarësimi nënkupton pranimin e të drejtave dhe të detyrimeve të sistemit të Bashkimit European dhe kuadrin institucional të njohur si *acquis* e BE-së. Shqipëria duhet të zbatojë të drejta dhe detyrimet e lartpërmendura gjatë fazës së anëtarësimit. Ndërsa *acquis* shtohet çdo vit, Shqipëria duhet të përditësohet me *acquis* e përditësuar. Gjithashtu, anëtarësimi nënkupton edhe zbatim efektiv dhe në kohë të *acquis*, i cili po evoluon në mënyrë konstante dhe përfshin:

- përmbajtjen, parimet dhe objektivat politike të Traktatit të themelimit të BE-së;

- legjislacionin dhe vendimet e miratuara në mbështetje të Traktatit dhe jurisprudencës së Gjykatës së Drejtësisë;

- akte të tjera, të detyrueshme ligjërish ose jo, të miratuara brenda kuadrit të Bashkimit European, si marrëveshjet ndërinsticionale, rezolutat, deklaratat, rekomandimet, udhëzuesit;

- veprimet e përbashkëta, pozicionet e përbashkëta, deklaratat, përfundimet dhe veprime të tjera në kuadër të politikës së përbashkët të jashtme dhe të sigurisë;

- veprimet e përbashkëta, konventat e nënshkruara, rezolutat, deklaratat dhe akte të tjera në kuadër të drejtësisë dhe çështjeve të brendshme;

- marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Komuniteti, komunitetet së bashku me vendet anëtare të BE-së, Bashkimi Europian dhe ato të nënshkruara nga vendet anëtare midis tyre me qëllim veprimtaritë e Bashkimit Europian;

- të drejtat dhe detyrimet të cilat Shqipëria duhet t'i respektojë si një vend anëtar, nënkuptojnë përfundimin e të gjitha marrëveshjeve ekzistuese midis Shqipërisë dhe Komunitetit Europian dhe të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare të nënshkruara nga Shqipëria, të cilat janë në pajtueshmëri me detyrimet e anëtarësimit. Cilido nen i MSA-së, i cili nuk është në përputhje me *acquis*, nuk mund të konsiderohet si precedent në negociatat e anëtarësimit.

PËRKTHIMI

Shqipëria ka nevojë të përkthejë *acquis* në gjuhën shqipe në kohë përpara anëtarësimit në BE dhe për këtë gjë i nevojitet të trajtojë një numër të mjaftueshëm përkthyesish për funksionimin e duhur të institucioneve të BE-së gjatë kohës së anëtarësimit.

KUSHTI I NEGOCIATAVE

Në zgjerimet e mëparshme traktate e anëtarësimit u nënshkruan bazuar në prezumimin se vendet candidate do të zbatojnë *acquis* siç ishte rënë dakord në procesin e negociimit. Në rastin e një zbatimi të pjesshëm të *acquis*, Gjykata Europine e Drejtësisë do ta detyrojë një vend kandidat, pasi ai të bëhet vend anëtar, të përputhë legjislacionin e tij me *acquis*. Për anëtarësimin e Shqipërisë do të miratohet një mekanizëm verifikimi për kontrollin e *acquis* gjatë periudhës së paraanëtarësimit.

Procedura “screening” do të ndihmohet nga Gap Analyses, e cila nevojitet për të matur shtrirjen e *acquis* të zbatuar nga Shqipëria. Progresi vjetor, i cili përmban vlerësimin e detajuar të progresit gjatë përgatitjes për anëtarësim në të

gjitha fushat e negociatave, do të japë vlerësimin përfundimtar për kualifikimin e vendit kandidat për anëtarësim. Progresi në negociata, i cili reflektohet në mbylljen e negociatave të anëtarësimit, ndonjëherë varet drejtpërdrejt nga arritja e një niveli të veçantë të përparimit në procesin e përshtatjes. Strategjia e Bashkimit European për zgjerim paracakton të drejtën për Komisionin European të rekomandojë një rihapje të negociatave në një kapitull të mbyllur, në rast se një vend kandidat nuk përmbush detyrimet e ndërmarra gjatë negociatave.

PROCESI “SCREENING”

Komisioni do të ndërmarrë një proces formal shqyrtimi për *acquis*, të ashtuquajturën procesi “screening”, me qëllim që t’u shpjegojë autoriteteve shqiptare, që të vlerësojnë statusin e përgatitjes së Shqipërisë për negociim të hapur në fusha të veçanta. “Screening” përfshin një vlerësim të shkallës së përfutimit të legjislacionit vendas me *acquis*. *Acquis* duhet të ndahet në numër kapitujsh, sipas fushave të veçanta.

Një listë e këtyre kapitujve parashikohet në anekse. Çdo pikëpamje e shprehur nga Shqipëria ose nga BE-ja për kapituj të veçantë të negociatave nuk do të paragjykojnë pozicionin që është mbajtur për kapitujt e tjerë. Gjithashtu, marrëveshjet e arritura në negociata për kapituj të veçantë, edhe pse të pjesshëm, nuk do të konsiderohen si përfundimtarë deri sa të jetë përfunduar e gjithë Marrëveshja për të gjithë kapitujt. Përparimi i negociatave do të udhëhiqet nga progresi i Shqipërisë në përgatitjen e anëtarësimit, brenda një kuadri konvergjençash ekonomike dhe sociale dhe me referencë të raportet e Komisionit European. Ky progres do të matet në mënyrë të veçantë sipas kërkesave të mëposhtme:

- Kriteret e Kopenhagenit, të cilat parashikojnë kërkesat e mëposhtme për anëtarësim.
- Stabilitet të institucioneve, duke garantuar demokracinë, shtetin e së drejtës, mbrojtjen e të drejtave të njeriut, si dhe respektimin dhe mbrojtjen e minoriteteve.

- Ekzistencën e një ekonomie funksionale të tregut sikundër dhe kapaciteti për të vepruar në kushtet e një tregu konkurrues brenda Bashkimit European.

- Aftësinë për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit, duke zbatuar objektivat politike, ekonomike dhe monetare.

- Kushtet për integrim nëpërmjet rregullimit të strukturave administrative përkatëse, në mënyrë që legjislacioni komunitar i përçuar në legjislacionin vendas të zbatohet me frytshmëri përmes strukturave të përshtatshme administrative dhe gjyqësore.

- Angazhimi i qartë për marrëdhënie të mira fqinjësie dhe zgjidhja e ndonjë konflikti kufitar të diskutueshëm në përputhje me parimin e zgjidhjeve paqësore dhe me Kartën e Kombeve të Bashkuara, duke përfshirë, nëse është e nevojshme, juridiksionin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë.

- Zbatimi i detyrimeve të Shqipërisë, të parashikuara në MSA dhe në Protokollin shtesë të saj, e shtrin Marrëveshjen e Asociimit në të gjitha vendet anëtare të BE-së.

Procesi *screening* i përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me atë komunitar është një fazë parapërgatitore e negociatave.

Vlerësimi i bërë me anë të analizës së boshllëkut legjislativ do të mbulojë të gjithë kapitujt e *acquis*. Në rastet kur *acquis* është shumë voluminoze, si bujqësia, mbrojtja mjedisore dhe politika e transportit, duhet të zhvillohen disa procese *screening*. Objektivi i këtij procesi është të përfshijë kandidatët më shumë në legjislacionin komunitar dhe të identifikojë problemet e mëtejshme të negociatave. Lista e kapitujve, që parashikon aktet ligjore që duhen traspozuar, është hartuar nga Komisioni European dhe përbën bazën ligjore për rishikim legjislativ. Paralelisht me negociatat e anëtarësimit, Bashkimi European do të ketë me Shqipërinë një dialog intensiv politik dhe social civil. Qëllimi i dialogut civil gjithëpërfshirës do të jetë të theksojë kuptimin e dyanshëm, duke u afruar njerëzit më pranë, veçanërisht me qëllimin për të siguruar një mbështetje për qytetarët evropianë për procesin e anëtarësimit.

ETAPAT PËR NEGOCIATAT E HAPJES DHE TË MBYLLJES SË KAPITUJVE

Në Strategjinë e Zgjerimit të vitit 2007, Komisioni European paraqiti si një instrument të ri “etapat” si rezultat i mësimave të mësuara nga zgjerimi i pestë. Qëllimi i tyre është të përmirësojnë cilësinë e negociatave, duke siguruar nxitës për vendet candidate, në mënyrë që ato të ndërmarrin reformat e nevojshme në një fazë të hershme. Etapat janë të matshme dhe lidhen me elementet kyçe të kapitujve të *acquis*. Pasi një kapitull, ka kaluar në procesin *screening*, vendi anëtar vendos, nëse kapitulli mund të hapet për negociata, mbështetur në një rekomandim të Komisionit ose në bazë të etapave, të cilat duhet të realizohen nga vendi kandidat përpara se të hapen negociatat. Kur hapen negociatat, Bashkimi paraqet pozicionin e përbashkët, duke përfshirë etapat që duhet të realizohen për të mbyllur kapitullin. Në përgjithësi, etapat e hapjes lidhen me hartat përgatitore për bashkimin e ardhshëm (si strategjitë ose planet e veprimit) dhe realizimin e detyrimeve kontraktuese që pasqyrojnë kërkesat e *acquis*. Etapat e mbylljes kryesisht lidhen me masat legjislative, administrative ose institucionet e gjyqësorit dhe zbatimin e *acquis*. Hartimi i raporteve për Komisionin European lidhur me progresin e Shqipërisë në procesin e anëtarësimit në BE dhe veçanërisht me informacionin e siguruar nga Komisioni gjatë procesit *screening*, Këshilli i BE-së, me vota të njëzëshme dhe mbi bazën e një propozimi të Komisionit European, do të hartojë etapat për mbylljen dhe, aty ku është e nevojshme hapjen e çdo kreu. BE-ja do të komunikojë etapa të tilla për Shqipërinë. Në varësi të kapitullit, etapat precize do t’i referohen në veçanti ekzistencës së ekonomisë funksionale të tregut, përshtatjes legjislative me *acquis* dhe një zbatim të kënaqshëm të *acquis*, duke demonstruar ekzistencën e një administrate të përshtatshme dhe një kapacitet gjyqësor. Aty ku është e nevojshme, etapat do të përfshijnë përmbushjen e angazhimeve të MSA-së, në veçanti ato që i përkasin bashkimit doganor BE-Shqipëri dhe ato që lidhen me zbatimin e *acquis*. Në rastet ku negociatat mbulojnë një periudhë të caktuar kohe ose ku një kapitull rishikohet

në një datë të mëvonshme, duke futur elemente të reja si *acquis* e re, etapat mund të përditësohen.

Shqipëria do të kërkojë t'i tregohet roli i saj në lidhje me *acquis* dhe në raport me progresin e saj në mënyrë që të realizojë etapat. Traspozimi korrekt i legjislacionit europian nga ana e Shqipërisë dhe zbatimi i *acquis*, duke përfshirë zbatim efektiv dhe eficient nëpërmjet strukturave të përshtatshme administrative dhe gjyqësore, do të përcaktojë shpejtësinë e negociatave. Në fund të këtij procesi Komisioni Europian do të monitorojë progresin e Shqipërisë në të gjitha fushat, duke përdorur të gjitha instrumentet e vlefshme, përfshirë vërejtjet e ekspertëve.

Komisioni do të informojë Këshillin e BE-së për progresin e bërë nga Shqipëria mbi fushat kur paraqitet projekt qëndrimi i përbashkët i BE-së. Këshilli do të japë vlerësimin e tij, duke marrë në konsideratë kur të vendosë për hapat e mëtejshëm mbi negociatat e atij kreu. Shqipëria do të vazhdojë të sigurojë në mënyrë të rregullt progresin e detajuar sipas dhe në zbatim të *acquis* edhe pas mbylljes së një kapitulli. Në rast të mbylljes së kapitullit, Komisioni Europian mund të rekomandojë rihapjen e negociatave, në veçanti aty ku Shqipëria ka dështuar për të realizuar etapa të rëndësishme ose për të zbatuar angazhimet. Në rast të një moszbatimi të vazhdueshëm të parimit të lirisë, demokracisë, respektimit të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore të njeriut nga ana e Shqipërisë, Komisioni Europian, me nismën e tij ose me kërkesë të 1/3 të vendeve anëtare të BE-së, do të rekomandojë ndërprerjen e negociatave për atë kapitull të veçantë pasi të ketë dëgjuar palën shqiptare. Nëse Shqipëria nuk i plotëson etapat e mbylljes në një kapitull që ka qenë i mbyllur, Komisioni Europian mund t'u propozojë vendeve anëtare të BE-së që të rihapen negociatat e anëtarësimit.

PËRGATITJA E QËNDRIMIT TË PALËS SHQIPTARE

Gjatë të ashtuquajturave takime bashkërendimi në Shqipëri, qëndrimet e palës shqiptare mund të bashkërendohen sipas datave dhe mënyrës së zbatimit të legjislacionit komunitar në një kapitull të veçantë. Mbështetur në rezultatet

e procesit *screening* të fazës së dytë, vendi aplikant duhet të përgatisë një qëndrim për çdo kapitull të negociuar. Përgatitja e këtij dokumenti duhet të përmbajë disa faza:

Një projekt duhet të hartohet nga një grup pune në varësi të Grupit Ndërministerial për përgatitjen e negociatave. Kjo do të marrë dy javë kohë ose disa muaj, në varësi të kompleksitetit të fushës. Më pas projekti i parë dërgohet në skuadrën negociuese, e cila duhet të bëjë disa modifikime për ta përshtatur atë me strategjinë e negocimit.

Këto dokumente duhet të diskutohen në Komitetin Ndërministror Bashkërendues, i cili është propozuar nga SMEI. Ky Komitet jep vlerësimin nëse duhet të kalojë për miratim te Këshilli Ndërministror për Integrim European përpara se të dërgohet në Bruksel.

PËRCAKTIMI I STRUKTURËS PËRGJEGJËSE PËR PROCESIN E NEGOCIIMIT

Makineria vendimmarrëse negociuese nuk duhet të sigurojë vetëm bashkërendim eficient të punës nga ana e drejtorive të administratës publike dhe agjencive, detyra këto të përcaktuara në shume vende candidate nga Kryenogociatori me skuadrën negociuese dhe atë ndërinstitucionale për përgatitjen e negociatave të anëtarësimit, por edhe të garantojë legjitimitetin e nevojshëm të vendimeve të marra si *postion papares*, të cilat përcaktojnë mundësitë e politikës strategjike. Në fillim të procesit të negociatave, vendimet për negociatat e anëtarësimit, për skuadër negociatore dhe ndërinstitucionale për përgatitjen e negociatave të anëtarësimit duhet të jenë në formën e akteve ligjore dhe të miratohen nga qeveria.

STRUKTURA E BE-SË PËRGJEGJËSE PËR PROCESIN E NEGOCIIMIT

Përgatitja e qëndrimit të përbashkët të BE-së

Komisioni European përgatit një përgjigje në formën e një projektqëndrimi që

në shumicën e rasteve përgatitet nga Drejtoria për Zgjerim e BE-së, me drejtori të tjera të përgjithshme të Komisionit Europian. Vetëm në rastet e Çështjeve të Jashtme dhe të Politikës së Përbashkët dhe të Drejtësisë dhe të Çështjeve të Brendshme, të cilat janë të përjashtuara nga kompetencat e Komunitetit, projektqëndrimet përgatiten nga Presidenca e BE-së në bashkëpunim të ngushtë me vendet anëtare dhe Komisionin Europian. Një projektqëndrim në këtë rast do të jetë në Axhendën e Grupit të Zgjerimit të Këshillit të Ministrave të BE-së. Dokumenti për të cilin është rënë dakord duhet të pranohet nga ambasadorët e vendeve anëtare në një mbledhje të COREPER dhe më pas të pranohet nga Këshilli i BE-së. Më pas dokumenti i dërgohet Shefit të Delegacionit në Tiranë. Nevojitet një përgjigje nga ana e Shqipërisë për këtë dokument. Projektpërgjigjet për qëndrimin e përbashkët të BE-së përgatiten nga anëtarët e skuadrës negociatore përgjegjëse për kapitullin në fjalë. Kur arrihet marrëveshja nga palët për kapitullin në fjalë, zhvillohet seancë mbyllëse e negociatave. Kjo do të thotë që është rënë dakord për dispozitat që parashikoheshin në qëndrimin e palës europiane dhe asaj shqiptare.

PËRFUNDIMI I PROCESIT TË NEGOCIATAVE

Mbyllja përfundimtare e negociatave për të gjithë kapitujt do të zhvillohet në fazën finale të negociatave, kur qëndrimet janë plotësuar nga çdo shtesë lidhur me *acquis*, e cila ka hyrë në fuqi gjatë negociatave të anëtarësimit dhe nga të dyja anët duhet të përshtaten qëndrimet. Duke rakorduar me njëra-tjetrën. Në fazën finale marrëveshja për të cilën është rënë dakord do të përfshihet në tekstin e Traktatit të Anëtarësimit. Negociatat e anëtarësimit do të përfundojnë me nënshkrimin e Traktatit të Anëtarësimit nga vendet anëtare të BE-së dhe të Shqipërisë.

MASA TË PËRKOHSHME DHE DËRGIME

Pranimi i Shqipërisë, për të marrë për sipër të drejta dhe detyrime që rrjedhin nga *acquis*, mund të kërkojë përshtatje të veçanta për *acquis* dhe

mund të vendosë masa tranzitore, të cilat duhet të përcaktohen gjatë negociatave të anëtarësimit. Periudhat e përkohshme të fiksuara dhe përjashtime të përkohshme janë të negociueshme. Një periudhë tranzitore, për shembull, mund të sigurojë një shtyrje të hyrjes në fuqi të dispozitave të veçanta të legjislacionit të BE-së. Përjashtimet duhet të jenë të kufizuara dhe ose cilësore. Ndonjë rregullim i përkohshëm duhet të jetë i kufizuar në kohëzgjatje dhe në qëllim. Kriteret e përgjithshme për pranimin e rregullimeve të përkohshme kanë qenë të specifikuara në detaje gjatë negociatave dhe janë të parashikuara në Strategjinë për Zgjerim së bashku me një klasifikim të detajuar, i cili ndan periudhat tranzitore në të pranueshme, të negociueshme dhe të papranueshme.

Arsyeja për të pyetur për rregullime tranzitore është kryesisht e mbështetur në kostot e larta të miratimit dhe të vështirësive teknike për zbatim. Aty ku është e nevojshme, do të bihet dakord për përshtatje të veçanta të *acquis* mbi bazën e parimeve, kushteve dhe parametrave të asaj *acquis* e cila është zbatuar për vendet anëtare, duke marrë në konsideratë specifikimet për Shqipërinë. BE-ja mund të bjerë dakord me kërkesat e palës shqiptare për masa tranzitore, duke siguruar që ato të jenë të kufizuara në kohë dhe në qëllim, si dhe të jenë të shoqëruara me një plan, i cili parashikon faza të qarta për zbatimin e *acquis*. Në çdo rast, rregullimet tranzitore duhet të mos përfshijnë ndryshime ndaj rregullave ose politikave të BE-së, të përçajë funksionimin e tyre ose të kenë të bëjnë me shtrembërimin e konkurrencës. Komisioni duhet të konsiderojë periudha tranzitore, përjashtimet, rregullimet specifike ose klauzolat e masave mbrojtëse të përhershme, për shembull, masat të cilat janë barabarta me ato të masave mbrojtëse në fusha si lëvizja e lirë e personave, politikat strukturore ose bujqësia. Për më tepër procesi vendimmarrës lidhur me vendosjen e lëvizjes së lirë të personave duhet të lejojë një rol maksimal të vendeve individuale anëtare. Rregullimet tranzitore ose masat mbrojtëse duhet të rishikohen për sa i përket impaktit të tyre që kanë mbi konkurrencën ose funksionimin e tregut të brendshëm. Nuk do të

jetë e nevojshme që të bëhen rregullime të detajuara teknike për *acquis* gjatë negociatave të anëtarësimit. Ato do të përgatiten në bashkëpunim me Shqipërinë dhe do të miratohen nga institucionet e BE-së në kohën e hyrjes në fuqi. Në fazën e fundit të negociatave duhet të diskutohen disa probleme të komplikuar të një rëndësie thelbësore për BE-në dhe vendet e tij anëtare dhe për Shqipërinë.

Një pikë, për shembull, është zgjatja dhe hyrja në fuqi e neneve për Politikën e Përbashkët Bujqësore. Një tjetër subjekt i rëndësishëm për fazën e fundit janë mënyrat në të cilat vendet e reja anëtare do të marrin pjesë në politikat e BE-së, për shembull, Politika e Përbashkët Bujqësore dhe/ose politika strukturore, si dhe kontributi i ardhshëm në buxhetin e BE-së. Praktika ka treguar se në fazën finale të negociatave, problemet që janë diskutuar më parë nuk diskutohen në mënyrë të veçantë, por mblidhen së bashku dhe në formën e një marrëveshjeje kuadër. Në fazën finale do të vazhdohet me nivelin politik. Aspektet financiare të anëtarësimit të Shqipërisë duhet të lihen për kuadrin financiar të zbatueshëm. Kështu që, ndërsa anëtarësimi i Shqipërisë mund të ketë pasoja të konsiderueshme financiare, negociatat mund të përfundojnë pas përcaktimit të kuadrit financiar për periudhën nga viti 2014 së bashku me reformat financiare. Ndonjë rregullim mund të sigurojë që detyrimi financiar të jetë i ndarë në mënyrë të drejtë midis të gjitha vendeve anëtare. Shqipëria do të marrë pjesë në Bashkimin Ekonomik dhe Monetar nga data e anëtarësimit si një vend anëtar me përjashtime dhe do të pranojë euron si monedhë të brendshme, me një vendim të Këshillit të BE-së mbi bazat e një vlerësimi të përmbyshjes së disa kushteve. *Acquis* e mbetur për t'u miratuar në këtë fushë do të zbatohet që nga data e anëtarësimit. Për sa i përket fushave të drejtësisë, lirisë dhe të sigurisë, anëtarësimi në BE i Shqipërisë kërkon që Shqipëria të zbatojë plotësisht të gjithë *acquis* në këto fusha, duke përfshirë këtu edhe *acquis* e Kartës Schengen. Gjithsesi, pjesa e *acquis* do të zbatohet vetëm në Shqipëri, ndjekur nga një vendim i Këshillit për të kontrolluar personat në kufijtë e brendshëm mbi bazën e vlerësimit të

zbatimit të Kartës Schengen. BE-ja thekson rëndësinë e mbrojtjes mjedisore, duke përfshirë të gjitha aspektet e mbrojtjes bërthamore për Shqipërinë. Në të gjitha fushat e *acquis* Shqipëria duhet të përshtatë institucionet, kapacitetet menaxhuese dhe administrative, si dhe sistemin gjyqësor me standardet e BE-së, si në nivel kombëtar dhe në atë rajonal, me synim zbatimin efektiv të *acquis* ose zbatimin e saj përpara anëtarësimit në BE. Në nivel të përgjithshëm kjo kërkon një mirëfunksionim dhe qëndrueshmëri të administratës publike dhe një sistem gjyqësor të pavarur dhe eficient.

PAS PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË NEGOCIATAVE

Pas nënshkrimit të projekttekstit të Traktatit të Anëtarësimit nga vendet anëtare të BE-së, Shqipëria, Këshilli i BE-së dhe Parlamenti Europian, nevojitet edhe miratimi nga parlamentet kombëtare të vendeve anëtare të BE-së. Republika e Shqipërisë (Qeveria dhe Parlamenti) duhet të promovojnë miratimin e Traktatit të Anëtarësimit nga Parlamentet e vendeve anëtare, të rritin ndërgjegjësimin në të gjitha vendet anëtare për anëtarësimin e Shqipërisë në BE dhe të bindin anëtarët e parlamenteve që anëtarësimi i Shqipërisë është një vlerë e shtuar për integrimin europian.

Mbrojtja e të dhënave vetjake - një sfidë e re për shoqërinë shqiptare

*Rezana Balla**

Teknologjia e re për përpunimin e informacionit ka evoluar shumë dhe është transformuar në një mënyra të re se si ne shohim botën, në mënyra të reja të komunikimit të shpejtë, mënyra se si ne jetojmë në punë, në shtëpi etj. Teknologjia e re vazhdon të zhvillohet dhe, nëse përdoret në mënyrën e duhur, është një forcë e re shtytëse drejt përparimit. Për të siguruar përdorimin e drejtë të kësaj teknologjie nevojiten rregulla të reja.

Informacioni është çelësi dhe burimi i njohurive. Në kohët moderne ne mund ta mbledhim më lehtë, mund ta përpunojmë më shpejt, mund ta përdorim për shumë qëllime dhe mund ta transmetojmë menjëherë në të gjithë botën.

Pjesa më e madhe e informacionit ka të bëjë me njerëzit, pra informacion rreth një individi të caktuar. Informacioni rreth personave është shumë i rëndësishëm në një “shoqëri informacioni” që ne jemi sot. Sektori publik ka nevojë për këtë informacion për të siguruar shërbime për publikun. Bizneset kanë nevojë për informacionin për të qenë konkurruese në treg.

Disa përdorime të të dhënave vetjake janë sigurimi i trajtimit mjekësor ose i shërbimeve sociale, mbajtja e regjistrave në shkolla dhe universitete, regjistrimi në lista për qëllime strehimi, mbajtja e regjistrave të nëpunësve,

* Autorja është përgjegjëse e Sektorit të Organizimit dhe Trajnimit të Gjyqësorit në Ministrinë e Drejtësisë.

regjistrimi i pasagjerëve në aeroplanë etj. Njëkohësisht, përdorime të tjera të informacioneve vetjake janë: hetimi dhe ndjekja penale për vepra penale, zhvillimi i seancave gjyqësore, sigurimi i shërbimeve bankare dhe përfitimi i sigurimeve, regjistrimi në hotele, shkrimi i artikujve për median, blerja e makinës ose marrja e patentës, organizimi i seminareve dhe workshopeve etj.

Pra, rritja e përdorimit të të dhënave vetjake është e pashmangshme. Forcimi i teknologjisë së re të informacionit ka rritur mundësinë e ndërhyrjes në jetën tonë private. Individët nuk kanë kontroll të vërtetë mbi informacionet rreth tyre. Informacioni mund të jetë i gabuar ose i keqpërdorur. Këto janë shqetësime të ndërhyrjes në jetën private, të cilat i krijojnë problemet si: humbja e bazave të të dhënave, informacione joaktuale, keqpërdorimi i informacioneve dhe shitja e padrejtë e informacioneve vetjake.

Por çfarë është mbrojtja e të dhënave vetjake? Një përkufizim mund të jetë: Një paketë rregullash të përcaktuara nga ligji, të cilat rregullojnë mënyrën se si informacioni rreth individëve duhet të përdoret”.

Çfarë synon mbrojtja e të dhënave? Ajo nuk do të zgjidhë të gjitha problemet, por mendojmë që do të kontribuojë në zgjidhjen e disa problemeve. Ajo balancon nevojën e organizatave për përdorimin e informacioneve rreth individëve me të drejtën për të respektuar privatësinë e tyre. Ajo u garanton individëve se informacionet rreth tyre do të përdoren në mënyrë të drejtë. Gjithashtu, mbrojtja e të dhënave vetjake ndihmon organizatat për një menaxhim më të mirë të informacionit.

Nuk ekziston ndonjë vend i fshehtë. Informacioni mbi jetën tonë të përditshme është i disponueshëm në mënyrë rutine, në një sërë njësisish ose organizatash të sektorit publik ose privat. A është kjo një “shoqëri mbikëqyrëse”? Individët duhet të përpiqen të kufizojnë dhënien e të dhënave të tyre vetjake, por që prej shumë kohësh në shumicën e rasteve ne nuk mendojmë për të. Nëse ne duam të marrim pjesë në shoqëri, është e pamundur të shmangësh dorëzimin e të dhënave vetjake. Për këto arsye mbrojtja e të

dhënave vetjake është kaq e rëndësishme.

Në përdorimin e përditshëm termat “të dhëna” ose “informacion” zakonisht kanë të njëjtin kuptim, por ato gjithnjë lidhen me termin “mbrojtja e të dhënave”. Në Europë¹ termi “privatësia” është shumë i gjerë e ka të bëjë me të drejtën për t’u lënë vetëm, por termi “mbrojtja e të dhënave” është një pjesë e “privatësisë” që lidhet vetëm me informacionin vetjak. Ndërsa jashtë Europës, për shembull në SHBA, Australi ose në Zelandën e Re, me termin “privatësi” zakonisht kuptohet “mbrojtja e të dhënave”.

Mbrojtja e të dhënave vetjake mund të themi që i ka fillimet e saj që në kohën e grekëve të lashtë me betimin e Hipokratit².

Në fillim të viteve ’60, ndërtimi i të ashtuquajturit shtet i mirëqenies sociale u shoqërua me nevojën për një informacion gjithnjë e më të madh. Në atë kohë kompanitë e mëdha, që posedonin sasi të mëdha dosjesh, filluan të përdornin sisteme kompjuterike. Meqenëse kapaciteti i tyre konsiderohej si një burim i shtrenjtë dhe i kufizuar, lindi ideja që të dhënat, për arsye praktike, të ruheshin në një vend të vetëm dhe t’u njëhej përdoruesve të ndryshëm e drejta e aksesit si rruga më e thjeshtë për të krijuar, administruar dhe përditësuar sistemin. Këto zhvillime, si dhe shfaqja e nocionit “administrim i të dhënave të integruara” çuan në lindjen e debatit për mbrojtjen e të dhënave vetjake. Në shoqëritë moderne shumë vendime që lidhen me individët bazohen në informacionin e ruajtur në dosje kompjuterike me të dhëna. Por, përgjegjësit e dosjeve duhet të sigurojnë që avantazhet e padiskutueshme të përpunimit automatik të të dhënave në të njëjtën kohë nuk duhet të dobësojnë pozitën e

¹ “Pse mbrojtja e të dhënave” fjala e z. G. SUTTON, ekspert Këshillit të Europës për mbrojtjen e të dhënave, në Konferencën “Për mbrojtjen e të dhënave vetjake në Shqipëri”, qershor 2007, Tiranë.

² “Hippocratic Oath”, ishte betimi në një Grupim Hippocratic, versione të ndryshme të të cilit kanë qenë përdorur prej 2000 vjetësh nga mjekët që hynin , në mjekësi në praktikë për herë të parë.

personave të cilëve u përkasin të dhënat. Dosjet e automatizuara, krahasuar me dosjet manuale,³ kanë një kapacitet ruajtjeje shumë më të lartë dhe ofrojnë mundësi për një shumëllojshmëri transaksionesh, të cilat i kryejnë me shpejtësi të madhe, duke sjellë një ndikim të padiskutueshëm në zhvillimin e marrëdhënieve tregtare dhe ekonomike, duke iu përgjigjur në të njëjtën kohë sfidave të modernizimit dhe teknologjisë.

Mbrojtja ligjore e privatësisë e ka origjinën në SHBA⁴, por legjislacionet e para për mbrojtjen e të dhënave vetjake dhe burim i shumë ligjeve për privatësinë u bë kontinenti evropian⁵. Me gjithë mbrojtjen e akorduar në nivel kombëtar nga vende të ndryshme, gjithnjë e më tepër konsiderohej e nevojshme ndërmarrja e veprimeve në nivel ndërkombëtar, për të siguruar që legjislacioni kombëtar nuk do të bëhej pengesë për qarkullimin ndërkufitar të të dhënave vetjake. Veprimi i parë ndërkombëtar u shënuar me hartimin e Udhëzimeve për Mbrojtjen e Privatësisë dhe Qarkullimin Ndërkombëtar të të Dhënave nga ana e Organizatës për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), në vitin 1980. Këto udhëzime nënvizonin parimet bazë për mbrojtjen e të dhënave dhe qarkullimin e tyre mes shteteve. Megjithatë udhëzimet nuk kanë vlerë ligjore, ato përcaktuan një emërues të përbashkët ndërmjet SHBA-së dhe BE-së, duke marrë në konsideratë pjesëmarrjen e tyre përkatëse në OECD.

Përsa i përket institucioneve europiane, Këshilli i Europës dhe Bashkimi European miratuan norma të përbashkëta dhe parashikuan krijimin e institucioneve të posaçme në vendet anëtare me qëllim mbrojtjen e të dhënave vetjake. Tashmë rreth 40 shtete në Europë kanë legjislacion për mbrojtjen e

³ Këto dosje përmbajnë shënime ose të dhëna që mbahen me dorë.

⁴ Shumë shtete në SHBA nuk kanë legjislacion për mbrojtjen e të dhënave edhe sot ato renditen ndër shtetet që nuk ofrojnë nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave vetjake.

⁵ Ligji I parë për mbrojtjen e të dhënave vetjake është hartuar në shtetin gjerman Hesse më 1970.

të dhënave vetjake. Studimi në vijim trajton përvojën shqiptare në adoptimin e standardeve për mbrojtjen e të dhënave vetjake, në zbatim të angazhimeve të ndërmarra në kuadër të Këshillit të Europës dhe Bashkimit Europian, të reflektuara në Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit (MSA).

A GARANTOHET MBROJTJA E TË DHËNAVE VETJAKE?

Megjithëse në Shqipëri ekzistonte ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave vetjake”, mbrojtja e të dhënave vetjake përbënte një fushë të panjohur për vendin tonë.

Për shkak të lëvizjeve të të dhënave përtej kufijve, mbrojtja e privatësisë së individëve nuk mund të ezaurohej tërësisht vetëm në nivel kombëtar. Rritja e konsiderueshme e qarkullimit ndërkombëtar të informacionit ka theksuar nevojën për përpjekje të përbashkëta ndërshtetërore, për të rregulluar në mënyrë të balancuar nevojat për lëvizjen e lirë me kërkesat për mbrojtjen e të dhënave vetjake.

Mbrojtja e të dhënave vetjake në territorin e Republikës së Shqipërisë gjen mbështetje edhe në Kushtetutë. Kështu, në nenin 35 të Kushtetutës parashikohet se askush nuk mund të detyrohet, përveçse kur e kërkon ligji, të bëjë publike të dhëna që lidhen me personin e tij. Në paragrafin e dytë të kësaj dispozite përcaktohet se mbledhja, përdorimi dhe bërja publike e të dhënave rreth personit bëhet me pëlqimin e tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj. Pra, kushdo ka të drejtë të njihet me të dhënat e mbledhura rreth tij, me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, si dhe të kërkojë ndreqjen ose fshirjen e të dhënave të pavërteta, të paplota ose të mbledhura në kundërshtim me ligjin. Por edhe në këtë aspekt hartuesit e Kushtetutës janë treguar skeptikë. Garancia për mbrojtjen efektive të të dhënave vetjake është ngritja e një mekanizmi mbikëqyrës. Pra, duke qenë një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e drejta e privatësisë meriton një mbrojtje të veçantë. Autoriteti mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave vetjake duhet të jetë një institucion i pavarur me burime të mjaftueshme

financiare dhe njerëzore, për të ushtruar këtë detyrë kaq të rëndësishme. Prandaj ngritja e këtij institucioni duhej të ishte parashikuar në Kushtetutë. Gjithsesi, ngritja e këtij institucioni është shumë e rëndësishme për procesin e mbrojtjes së të dhënave vetjake dhe një institucion i tillë duhet të ngrihet me ligj.

Dallimet në mbrojtjen e privatësisë ishin bërë pengesë për lëvizjen e të dhënave vetjake midis Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së, në të cilën mallrat, shërbimet, kapitalet dhe njerëzit lëvizin lirisht. Për të shmangur pengesa të tilla Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit detyron Shqipërinë të adoptojë Direktivën 95/46/EC “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me trajtimin automatik të të dhënave vetjake dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”.

Për këto arsye, me ligjin nr. 8137, datë 31.7.1996, Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”. Në nenin 8 të Konventës parashikohet e drejta për respektimin e jetës private dhe familjare, në të cilën përcaktohet se çdokush ka të drejtë t’i respektohet jeta private dhe familjare, vendbanimi dhe korrespondenca e tij. Në lidhje me këtë parim çdo njeri ka të drejtë të informohet në rast se të dhënat vetjake që lidhen me jetën e tij private dhe familjare janë objekt përpunimi për qëllime të ndryshme nga subjekte të autorizuar. Ndër të tjera, në këtë nen theksohet se autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji, në rast se është e domosdoshme për sigurimin kombëtar, për sigurinë publike, për mirëqenien ekonomike të vendit, për mbrojtjen e rendit ose për parandalimin e veprave penale, për mbrojtjen e shëndetit ose të moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Për të ballancuar respektimin e privatësisë kundrejt lëvizjes së lirë të informacionit përtej kufijve, Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 9288, datë 7.10.2004 “Për ratifikimin e Konventës “Për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Vetjake”, është bërë shtet palë i Konventës. Në zbatim të Konventës shtetet palë detyrohen të sigurojnë

mjete ligjore mbrojtjeje nëpërmjet përcaktimeve të masave mbrojtëse në dispozitat e ligjit të brendshëm, për të bërë të efektshme parimet themelore për mbrojtjen e të dhënave vetjake. Konventa përcakton se të dhënat duhet të mbliidhen dhe të përpunohen në mënyrë të drejtë, të ruhen për qëllime ligjore, të jenë të sakta dhe të përditësohen. Konventa i njeh individëve të drejtën e aksesit në të dhënat, ajo përcakton parimet bazë të mbrojtjes së privatësisë. Konventa nuk është e vetëzbatueshme. Zbatimi i saj në territorin dhe rendin juridik shqiptar kërkon nxjerrjen e një ligji në bazë të nenit 122 të Kushtetutës.

Gjithashtu, me ligjin nr. 9287, datë 7.10.2004 Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkuftar i të dhënave”, i cili parashikon ndërmarrjen e masave nga organet mbikëqyrëse të shteteve palë, për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake, si dhe në transmetimet e tyre përtej kufijve kombëtare.

Ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave vetjake” që nga miratimi i tij nuk ka funksionuar dhe nuk ka gjetur asnjëherë zbatim në praktikë. Mangësitë në praktikë të këtij ligji kanë sjellë për pasojë pengesa në fushën e bashkëpunimit të institucioneve shqiptare me shtete të veçanta dhe organizata ndërkombëtare si: EUROJUST, EUROPOL, marrëveshjet e bashkëpunimit ekonomik, tregtar, policor dy ose shumëpalëshe etj.

E meta kryesore e këtij ligji qëndron në faktin se ai rregullon në një farë mënyre, sepse as kjo gjë nuk rregullohet plotësisht, përpunimin e të dhënave vetëm nga autoritetet publike. Një mangësi e tillë aktualisht i lë subjektet, qofshin këto persona fizikë ose juridikë, pa mbrojtje ndaj veprimtarisë së sektorit privat. Dihet që sot veprimtarinë më të madhe në realizimin e shërbimeve e kryejnë institucione të sektorit privat si bankat, kompanitë e sigurimeve, të pensioneve etj., me të cilat individët hasen përditë. Pra, ligji nuk mbikëqyrte veprimtarinë e këtyre institucioneve private për mbrojtjen e

të dhënave. Qytetarët shqiptarë nuk gëzojnë asnjë garanci për mbrojtjen e të dhënave vetjake. Ata vazhdojnë t'u japin edhe sot për përdorim të dhënat e tyre vetjake kompanive private për të mundësuar shërbimet nga ana e këtyre kompanive.

Ky ligj nuk reflekton angazhimet e shprehura në instrumentin e ratifikimit të Konventës për zbatimin e saj për të dhënat që lidhen me shoqatat, fondacionet, shoqëritë etj.

Aktualisht Banka e Shqipërisë ka ngritur një regjistër kredish me informacion mbi detyrimet financiare të çdo kredimarrësi. Ky sistem informacioni synon të parandalojë rrezikun që vjen nga rritja e shpejtë e kredidhënies në Shqipëri⁶. Regjistri do të përmbajë të dhëna jo vetëm për individët, por edhe për shoqëritë tregtare. Për këtë arsye, mbledhja e të dhënave të kredive të tyre kërkon një rregullim të rëndësishëm dhe të kujdesshëm të ligjor, për të mos lënë shteg për shpërdorime.

Duhet të theksojmë se ligji nuk parashikon asnjë rregullim për raportin e privatësisë me lirinë e shprehjes. Rregullat e vendosura për mbrojtjen e të dhënave vetjake mund të kufizojnë lirinë e shprehjes së individëve dhe në veçanti lirinë e shtypit. Sipas nenit 9 paragrafi 2 të Konventës së Këshillit të Europës, shtetet mund të dërgojnë nga parimet bazë të mbrojtjes së të dhënave vetjake kur derogimi bëhet me ligj dhe përbën një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të mbrojtjes së lirisë së shtypit. Në parim, veprimtaria e shtypit duhet të respektojë rregullat e vendosura për mbrojtjen e privatësisë. Megjithatë, zbatimi i këtyre rregullave nuk duhet të bjerë ndesh me lirinë e shtypit, sekretin gazetaresk dhe parimet e gazetarisë investigative, të domosdoshme në një shoqëri demokratike, ku media prezumohet të jetë pushteti i katërt.

Për shembull, një gazetar mund të kërkojë një informacion në një institucion

⁶ Neni 127 i ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë".

shtetëror, por sipas rregullit ai nuk lejohet për këtë, prandaj shpesh herë gazetarëve u duhet t'i sigurojnë informacionet në rrugë konfidenciale. Pra, për të realizuar lirinë e shtypit, Konventa lejon shtetet që të bëjnë përjashtime nga rregullat e parashikuara për mbrojtjen e të dhënave vetjake. Ky problem është evidentuar në raportet vjetore të Avokatit të Popullit, ku përsëritet se “mediat tona duket se akoma nuk e konsiderojnë shkelle të japin me hollësi të dhëna vetjake që shkelin të drejtën e privatësisë të rregulluar nga dispozitat e ligjit për të dhënat vetjake”. Pavarësisht se një shqetësim i tillë qëndron, Avokati i Popullit nuk merr parasysh faktin që rrezja e veprimit të ligjit bie vetëm mbi autoritetet publike dhe, si i tillë, nuk detyron organet e shtypit të cilat janë institucione private.

Në lidhje me transferimin e të dhënave vetjake jashtë shtetit, sipas ligjit, të dhënat mund të transferohen te një përdorues i huaj jashtë Republikës së Shqipërisë, kur juridiksioni në të cilin vepron personi i huaj ofron të njëjtat garanci sikurse edhe ligji shqiptar ose kur parashikohet me ligj ose kur është dhënë pëlqimi me shkrim i individit. Një rregullim i tillë është i pamundur. Për këtë arsye ligji duhet të plotësohet, duke lejuar transferimin në përmbushje të një interesi të rëndësishëm publik dhe kritere te tjera.

Këto janë disa prej arsyeve prej të cilave nuk është mundësuar të zbatohet ligji për mbrojtjen e të dhënave vetjake në praktikë. Por juristët e dinë mirë që një ligj nuk është i mirë nëse nuk parashikon masa shtrënguese dhe njëkohësisht një autoritet mbikëqyrës.

Pra, në Republikën e Shqipërisë autoriteti përgjegjës për zbatimin e ligjit ishte Avokati i Popullit. Ashtu siç thamë më lart, Republika e Shqipërisë aderoi në Protokollin Shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkuftar i të dhënave”, i cili parashikon ngritjen e autoriteteve përgjegjëse për zbatimin e ligjit. Protokollin mbështetet mbi parimin që mbrojtja efektive e të drejtave të garantuara në Konventë kërkon jo vetëm harmonizimin e parimeve bazë të përpunimit të të dhënave vetjake, por edhe

të mënyrave të zbatimit të tyre. Në zbatim të këtij parimi shumica e shteteve palë kanë ngritur autoritete mbikëqyrëse për mbrojtjen e të dhënave vetjake, në formën e një komisioneri (Mbretëria e Bashkuar, Irlanda, Sllovenia), komisioni (Franca, Italia, Belgjika), ombusmani (Finlanda), inspektorati (Polonia, Suedia, vendet Baltike) ose zyrë (Spanja, Holanda, Republika Çeke). Këto autoritete gëzojnë pavarësi të plotë nga çdo formë ndërhyrjeje gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre.

Ndërsa në Shqipëri, për shkeljen e privatësisë, individët kanë të drejtë të ankohen tek Avokati i Popullit. Një zgjedhje e tillë duhet të jetë mbështetur në konsideratën që ky institucion i pavarur, me funksion themelor mbrojtjen e interesave të individëve përballë administratës publike, mund të përmbushë detyra në fushën e të dhënave vetjake dhe të përgjigjet për rivendosjen e të drejtave të shkelura.

Një përjasje e tillë krejtësisht e ndryshme nga ajo e shteteve anëtare të BE-së dhe atyre kandidate nuk i shërben as zbatimit të detyrimeve të ndërmarra, në përputhje me nenet 70 dhe 79 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe shqetësimeve të Komisionit European të shprehur në dy progres-raportet e fundit të tij. Ky fakt e ka ekspozuar Shqipërinë si një vend pa një institucion të dedikuar posaçërisht ndaj mbrojtjes së privatësisë së individëve. Problemet kryesore që pengojnë Avokatin e Popullit të funksionojë si një autoritet i mirëfilltë mbikëqyrës lidhen me kompetencat e kufizuara që ligji i njej këtij institucioni posaçërisht në fushën e të dhënave vetjake dhe me mangësitë në mënyrën e organizimit, funksionimit dhe burimeve njerëzore të tij. Pra, fusha e veprimtarisë së këtij institucioni nuk përputhet me atë të një institucioni monitorues dhe garantues të të dhënave vetjake në praktikë.

Për më tepër, të vetmet instrumente që ka në dispozicion Avokati i Popullit për zgjidhjen e ankesave të individëve janë rekomandimet për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi përgjegjës. Për shkak të natyrës së tyre jodetyruese, rekomandimet dhe propozimet nuk mund të jenë mjeti i

duhur për shtrëngimin e frytshëm të legjislacionit për të dhënat vetjake. Për të mundësuar vënien në vend të së drejtës së shkelur, ai duhet të urdhërojë bllokimin, pezullimin e përpunimit të të dhënave vetjake dhe njëkohësisht të ndërmarrë masa shtrënguese ndaj kontrolluesve.

Nga ana tjetër, veprimtaria e Avokatit të Popullit, qoftë kjo edhe e cunguar, ushtrohet vetëm mbi organet e administratës publike, duke mos garantuar individët nga shkeljet e të drejtave të tyre nga subjektet private.

Mangësitë në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Avokatit të Popullit, për sa i përket mbrojtjes së të dhënave vetjake, janë:

a) Mungesa e stafit të kualifikuar. Që nga koha e miratimit të ligjit për të dhënat vetjake e deri më sot, që kanë kaluar 9 vjet, struktura organizative e Avokatit të Popullit nuk ka pasur ndonjë person që të ngarkohet me kompetencat e parashikuara nga ligji për mbrojtjen e të dhënave vetjake.

b) Avokati i Popullit ka luajtur një rol joaktiv në promovimin e mbrojtjes së të dhënave vetjake.

c) Ai pothuajse nuk ka realizuar veprimtari në fushën e mbrojtjes së të dhënave vetjake, për të mundësuar rritjen e sensibilizimit të publikut.

ç) Mungon bashkëpunimi ndërkombëtar me autoritetet e huaja mbikëqyrëse.

Pavarësisht këtyre mangësive, qeverisjet e këtyre viteve të fundit, të çfarëdolloj ngjyrimi politik, nuk mund të përjashtohen nga përgjegjësia për mungesën e garancive për mbrojtjen e të dhënave vetjake. Këto qeveri nuk e kanë konsideruar si çështje të rëndësishme për t'u adresuar, pa marrë parasysh pasojat e trajtuara më sipër. Kjo reflektohet edhe në Planin Kombëtar të Përafritimit të Legjislacionit dhe Zbatimit të MSA-së, ku thuhet: “Aktualisht asnjë institucion shqiptar nuk ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë ligjore për adresimin e boshllëqeve në fushën e mbrojtjes së të dhënave vetjake”.

Përvoja e deritanishme për zbatimin e këtij ligji ka treguar se edhe autoriteti mbikëqyrës i cili ushtrohej nga Avokati i Popullit, ka dështuar në aplikimin e tij, si pasojë e burimeve të pamjaftueshme njerëzore dhe financiare, si dhe të

pengesave ligjore që lidhen me kufizimin e veprimtarisë së këtij institucioni. Në përputhje me nenin 60 të Kushtetutës, Avokati i Popullit ka të drejtë vetëm të nxjerrë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të të drejtave të njeriut nga administrata publike. Po për shkeljet që mund të bëhen nga kompanitë që operojnë në sektorin privat? Cili institucion do të monitorojë këto shkelje? Institucioni duhet jo vetëm të mbikëqyrë, por njëkohësisht të marrë masa për veprimet e paligjshme të kontrolluesve. Këto detyra kaq të rëndësishme për mbrojtjen efektive të të dhënave vetjake nuk mund të ushtrohen nga Avokati i Popullit edhe ndaj organeve të administratës publike, pasi ai nxjerr vetëm rekomandime dhe propozime, të cilat nuk kanë natyrën e duhur shtrënguese për procesin.

MBROJTJA E TË DHËNAVE VETJAKE NË PLANIN NDËRKOMBËTAR.

Plani Kombëtar i Zbatimit të MSA-së parashikon adoptimin e acquis communautaire për të dhënat vetjake. Por, pavarësisht zbatimit të detyrimeve që rrjedhin nga MSA-ja, ekzistojnë aspekte të tjera të cilat u parashtruan më lart.

Direktiva 95/46/EC lejon transferimin e të dhënave vetjake nga Komuniteti European drejt shteteve të tjera vetëm nëse këto të fundit sigurojnë një nivel të mjaftueshëm mbrojtjeje. Kjo është reflektuar edhe në mosmarrëveshjet ndërmjet BE-së dhe SHBA-së lidhur me transferimin e të dhënave për pasagjerët e linjave ajrore për qëllime të luftës ndaj terrorizmit dhe krimin të organizuar. Sipas Komisionit European, transferimi i këtyre të dhënave mund të realizohet vetëm pasi vendet të garantojnë mbrojtjen e këtyre të dhënave dhe përdorimin e tyre vetëm për qëllime të sigurisë së aviacionit dhe kontrollit të kufijve.

Niveli i mbrojtjes së të dhënave vetjake për një shtet, vlerësohet, duke konsideruar të gjitha rrethanat në lidhje me përpunimin, natyrën, qëllimin dhe kohëzgjatjen e tij, shteti i origjinës dhe destinacioni përfundimtar, aktet ligjore dhe standardet e sigurisë në fuqi në shtetin marrës. Vlerësimi i nivelit të

mjaftueshmërisë përfshin përmbajtjen e legjislacionit dhe funksionimin e mekanizmave shtrengues. Parimet themelore, të shqyrtuara gjatë vlerësimit, janë:

1. Parimi i kufizimit të qëllimit; të dhënat duhet të përpunohen për një qëllim specifik të përcaktuar qartë dhe të mos e tejkalojnë qëllimin për të cilin janë mbledhur.

2. Cilësia e të dhënave dhe parimi i proporcionalitetit; të dhënat duhet të jenë të sakta, të përditësuara të mjaftueshme dhe relevante.

3. Parimi i transparencës; individët duhet të informohen lidhur me qëllimin e përpunimit dhe identitetin e kontrolluesit në një shtet tjetër.

4. Parimi i sigurisë; kontrolluesit duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme teknike dhe organizative për shmangien e humbjeve aksidentale ose shkatërrimin e të dhënave.

5. Të drejtat e subjekteve të të dhënave si e drejta e aksesit, e korigjimit, e informimit, e kompensimit të dëmit dhe e ankimit.

6. Kufizimi i transferimit të mëtejshëm nga një marrës te një i tretë.

Respektimi i parimeve të mësipërme është veçanërisht i rëndësishëm në kuadër të bashkëpunimit policor në luftën kundër terrorizmit, krimit të organizuar, trafikëve dhe emigracionit të paligjshëm. Aktet ndërkombëtare për bashkëpunimin policor, për shembull: Schengen, Europol, Interpol, u referohen parimeve bazë të mbrojtjes së privatësisë dhe mund të zbatohen vetëm pas adoptimit të parimeve bazë të Konventës. Në këtë mënyrë, asnjë nismë në fushën e bashkëpunimit policor nuk mund të mendohet pa mbrojtjen e duhur të të dhënave vetjake. Çdo shkëmbim i të dhënave vetjake ndërmjet policive të Shqipërisë dhe shteteve anëtare të BE-së është i lidhur pazgjidhshmërisht me këtë kërkesë.

Por ajo që e bën më interesante funksionimin e këtij bashkëpunimi kaq të rëndësishëm policor, duke pasur parasysh rritjen dhe forcimin e krimit të organizuar kohët e fundit, është se ligji nuk zbatohet për policinë dhe prokurorinë pra, për qëllime të ndjekjes penale. Kjo e bën të pamundur

transferimin e të dhënave policore nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës,⁷ të cilat duhet të sigurohen për mjaftueshmërinë e mbrojtjes së këtyre të dhënave në Shqipëri.

Nga ana tjetër, mosekzistenca e një autoriteti mbikëqyrës për mbrojtjen e të dhënave vetjake është një tjetër pengesë për shkëmbimin e informacionit me institucionet e huaja të zbatimit të ligjit, veçanërisht për sa i përket nënshkrimit të një marrëveshjeje për shkëmbimin e të dhënave për krimin e organizuar me Europolin. Kriteret ligjore për përpunimin e të dhënave vetjake synojnë mbrojtjen e subjekteve të të dhënave.

Objektivat themelorë për mirëfunksionimin e sistemit mbikëqyrës duhet të jenë:

a) Zbatimi i drejtë i legjislacionit; kontrolluesit që bëjnë përpunimin e të dhënave dhe subjektet, që u përpunohen të dhënat, duhet të jenë në dijeni të të drejtave dhe detyrimeve të tyre. Një rol të rëndësishëm këtu luan autoriteti mbikëqyrës, i cili duhet ta ketë detyrim ligjor sensibilizimin e subjekteve të të dhënave për të drejtat e tyre dhe mjetet ligjore të ushtrimit të këtyre të drejtave.

b) Ofrimi i mbështetjes dhe ndihmës ndaj individëve; duke shqyrtuar në mënyrë të pavarur ankesat e tyre.

c) Kompensimi i dëmit për palët e dëmtuara.

NEVOJA E LIGJIT TË RI

Ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” nuk garanton një mbrojtje efektive të privatësisë së individëve. Ai, gjithashtu, nuk adreson angazhimet e Shqipërisë në Këshillin e Europës dhe mund të bëhet pengesë për qarkullimin e të dhënave ndërmjet Shqipërisë dhe vendeve anëtare të kësaj organizate në të ardhmen.

Mbrojtja e privatësisë së individëve është një çështje që nuk duhet konsideruar vetëm në kontekstin e zbatimit të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe

⁷ Raporti i Komisionit European për vitin 2006, f 44.

adoptimit të *acquis*, por, si një domosdoshmëri kundrejt garancive që shteti duhet t'iu ofrojë qytetarëve shqiptarë për mbrojtjen e të drejtave të tyre.

Në këto kushte lind nevoja e hartimit të një projektligji të ri, për të garantuar mbrojtjen e efektshme të të dhënave vetjake si një ndër çështjet e rëndësishme të procesit të integritimit evropian të Shqipërisë, për t'iu përgjigjur angazhimeve të ndërmarra në përputhje me nenet 70 dhe 79 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe shqetësimeve të Komisionit Evropian të shprehur në dy progres-raportet e fundit të tij.

Neni 79 i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit parashikon jo vetëm harmonizim të legjislationit shqiptar në fushën e të dhënave vetjake me *acquis communautaire* dhe legjislationin ndërkombëtar për privatësinë, por edhe krijimin e organeve mbikëqyrëse të pavarura me burime të mjaftueshme financiare dhe njerëzore, për të monitoruar dhe garantuar në mënyrë të frytshme zbatimin e ligjit në praktikë.

Ky angazhim është përsëritur dhe shtjelluar më tej në Planin Kombëtar për Zbatimin e MSA-së 2007-2012 (PKZMSA), të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 463 të datës 5. 7. 2006. PKZMSA-ja përcakton krijimin e një strukture të pavarur për mbrojtjen e të dhënave të aftë për të monitoruar zbatimin e legjislationit për mbrojtjen e të dhënave vetjake në mënyrë të frytshme, si një nga përparësitë afatshkurtra për periudhën kohore 2007-2008.

Sipas *acquis communautaire*, krijimi i autoriteteve të pavarura mbikëqyrëse është thelbësor për të garantuar mbrojtjen e individëve në kuadër të përpunimit të të dhënave të tyre vetjake. Gjithashtu, autoritetit mbikëqyrës duhet t'i jepen një sërë kompetencash hetimore, kompetenca të efektshme për ndërhyrje dhe kompetenca për t'iu përfshirë në procedura ligjore së bashku për zbatimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave vetjake, duke përfshirë sektorin privat dhe shtetëror.⁸

⁸ Shihni Direktivën 95/46/KE, Recitalin 62 dhe Nenin 28.

Edhe pse standardet e përcaktuara nga Direktiva 95/46/EC për mbrojtjen e të dhënave vetjake janë ndër më të lartat në botë, për disa çështje specifike shteteve u lihet hapësirë që ato të veprojnë në përputhje me kushtet dhe rendin e brendshëm juridik.

Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave vetjake përcaktohet nga Direktiva 95/46/EC, për të mundësuar zbatimin e parimeve të përcaktuara në Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Objektivi i Direktivës 95/46/EC është forcimi i marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkimit Europian, duke siguruar përmirësimin ekonomik dhe social nëpërmjet veprimeve të përbashkëta për të eliminuar barrierat që ndajnë Europën; inkurajimi i përmirësimeve të qëndrueshme të kushteve të jetesës të qytetarëve të tyre; forcimi i paqes dhe lirisë dhe promovimi i demokracisë mbi baza të lirive themelore të njohura nga kushtetutat dhe ligjet në shtetet anëtare dhe Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Sistemet e përpunimit të të dhënave janë dizenuar t'i shërbejnë njeriut. Ato duhet të respektojnë liritë dhe të drejtat themelore të njeriut dhe veçanërisht të drejtën e privatësisë, pavarësisht kombësisë ose vendit të qëndrimit të individit dhe të kontribuojnë në përmirësimin ekonomik dhe social, në zgjerimin e tregut dhe në mirëqenien e individëve.

Shtetet anëtare duhet të sigurojnë, pavarësisht nga themelimi dhe funksionimi i tregjeve të brendshme, lëvizjen e lirë të produkteve, personave, shërbimeve dhe kapitaleve, si dhe jo vetëm që të dhënat vetjake të lëvizin lirisht por, gjithashtu, të sigurojnë mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të individëve.

Pra, qëllimi kryesor i Direktivës 95/46/EC është që shtetet anëtare duhet të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti të drejtën e privatësisë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave vetjake.

Gjithsesi, meqenëse projektligji e ka origjinën tek teknologjia e re e informimit dhe komunikimit, e cila ka ndikuar gjerësisht në shoqërinë moderne

dhe natyrisht ai sjell koncepte të reja ligjore, koncepte, të cilat juristët e vjetër e kanë të vështirë t'i pranojnë, është e rëndësishme që të drejtat themelore të njeriut të mbrohen në mënyrë efektive nga pasojat negative të teknologjive të reja. Pra, duhet të gjendet një ekuilibrim i vazhdueshëm interesash midis mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përdorimit të frytshëm të teknologjive të reja nga institucionet e ndryshme të sektorit publik dhe privat. Pikërisht nga ky këndvështrim duhen lexuar komentet tona të mësipërme.

Sipas *acquis communautaire*, krijimi i autoriteteve të pavarura mbikëqyrëse është thelbësor për të garantuar mbrojtjen e individëve në kuadër të përpunimit të të dhënave të tyre vetjake. Gjithashtu, autoritetit mbikëqyrës duhet t'i jepen një sërë kompetencash hetimore, kompetenca të efektshme për ndërhyrje dhe kompetenca për t'u përfshirë në procedura ligjore së bashku për zbatimin e standardeve të mbrojtjes së të dhënave vetjake, duke përfshirë sektorin privat dhe shtetëror.⁹

Rëndësia e mbrojtjes së të dhënave vetjake përcaktohet nga Direktiva 95/46/EC, për të mundësuar zbatimin e parimeve të përcaktuara në Konventën Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Objektivi i Direktivës 95/46/EC është forcimi i marrëdhënieve midis Shteteve të Bashkimit Europian, duke siguruar përmirësimin ekonomik dhe social nëpërmjet veprimeve të përbashkëta, për të eliminuar barrierat që ndajnë Europën; inkurajimi i përmirësimeve të qëndrueshme të kushteve të jetesës të qytetarëve të tyre; forcimi i paqes dhe lirisë dhe promovimi i demokracisë mbi bazë të lirive themelore të njohura nga kushtetutat dhe ligjet në shtetet anëtare dhe Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut.

Pra, qëllimi kryesor i Direktivës 95/46/EC është që shtetet anëtare duhet

⁹ Shihni Direktivën 95/46/KE, Recitalin 62 dhe Nenin 28.

të mbrojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, në veçanti të drejtën e privatësisë gjatë procesit të përpunimit të të dhënave vetjake.

Ministria e Drejtësisë, e mbështetur nga ekspertë të Këshillit të Europës, hartoi projektligjin “Për mbrojtjen e të dhënave Vetjake”, i cili u miratua nga Kuvendi më 10.3.2008.

Grupi i punës, i ngritur për hartimin e projektligjit, u mbështet në Konventën “Për Mbrojtjen e Individëve në lidhje me Përpunimin Automatik të të Dhënave Vetjake”, Direktivën nr. 95/46/EC, datë 24.10.1995 të Këshillit të Evropës, si dhe në Protokollin Shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”.

Gjithashtu, u shfrytëzuan legjislacioni dhe përvoja e shteteve evropiane në fushën e mbrojtjes së të dhënave vetjake, si: legjislacioni austriak, portugez dhe anglez, si dhe këshillimet me ekspertë të fushës, të Këshillit të Evropës.

Ligji parashikon ndërmarrjen e masave, për të siguruar mbrojtjen e të drejtave të subjekteve të të dhënave vetjake, duke krijuar në këtë mënyrë një sistem të drejtë, të ligjshëm dhe transparent bashkërendimi dhe bashkëpunimi ndërmjet autoriteteve kompetente që operojnë në fushën e mbrojtjes së të dhënave vetjake.

Gjithsesi, meqenëse ligji e ka origjinën tek teknologjia e re e informimit dhe komunikimit, e cila ka ndikuar gjerësisht në shoqërinë moderne dhe natyrisht ai sjell koncepte të reja ligjore. Koncepte të cilat juristët e vjetër e kanë të vështirë t’i pranojnë. Është e rëndësishme që të drejtat themelore të njeriut të mbrohen në mënyrë efektive nga pasojat negative të teknologjive të reja. Pra duhet të gjendet një ekuilibrim i vazhdueshëm interesash midis mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe përdorimit të frytshëm të teknologjive të reja nga institucionet e ndryshme të sektorit publik dhe privat.

Ligji nr.9887, datë 10.3.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” konsiderohet si një kornizë e përgjithshme për mbrojtjen e privatësisë së individëve në Shqipëri. Në këtë mënyrë synohet që Shqipëria të klasifikohet

në listën e shteteve me nivel të mjaftueshëm të mbrojtjes së të dhënave vetjake.

Përballë sfidës së forcimit të besimit të qytetarit tek institucionet shtetërore, jemi të ndërgjegjshëm se angazhimi ynë nuk mbaron thjesht dhe vetëm te procesi ligjvënës, por është pjesë komplementare e procesit të zbatimit të ligjit. Ky proces është i vazhdueshëm, por kjo nuk na pengon që krahas kontributeve për plotësimin e legjislacionit, të vazhdojmë të bëjmë detyrën tonë edhe në marrjen e masave konkrete që mundësojnë arritjen e rezultateve konkrete dhe shtimin e treguesve të suksesit në zbatimin e ligjit.

Ligji i ri është konsideruar nga përfaqësuesit e organizatave ndërkombëtare në Shqipëri, por njëkohësisht edhe nga ekspertë të Këshillit të Europës, si një prej ligjeve më të mirë të përafuar me *acquis communautaire*. Por që prej miratimit të tij, në muajin shtator, është ngritur autoriteti mbikqyrës që do të monitorojë zbatimin e ligjit në praktikë. Ka pasur shumë debate dhe është diskutuar shumë për themelimin dhe ngritjen e këtij institucioni të pavarur që është mekanizmi i vetëm në Republikën e Shqipërisë për garantimin e mbrojtjes së të drejtave dhe lirve të njeriut një prej të cilave është mbrojtja e privatësisë. Gjithsesi, komisioneri sapo është emëruar dhe pritet të ngrihet dhe të funksionojë ky institucion kaq i rëndësishëm. Mbetemi me shpresë që ky institucion të ngrihet sa më shpejt, në mënyrë që qytetarët e Republikës së Shqipërisë të kenë ku të ankohen në rast të shkeljes së të drejtave të tyre.

BIBLIOGRAFIA:

1. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë.
2. Ligji nr. 8137, datë 31.7.1996 me të cilin Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Konventën Europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”.
3. Ligji nr. 8517, datë 22.7.1999 “Për mbrojtjen e të dhënave vetjake”
4. Ligji nr. 9288, date 7.10.2004 “Për ratifikimin e Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake”.
5. Direktiva 95/46/EC “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me trajtimin automatik të të dhënave vetjake dhe lëvizjen e lirë të këtyre të dhënave”.
6. Ligji nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”.
7. Ligji nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”.
8. Ligji nr. 9287, datë 7.10.2004, me të cilin Republika e Shqipërisë ka ratifikuar Protokollin shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”
9. “Pse Mbrojtja e të Dhënave” fjala e z. G. SUTTON, ekspert Këshillit të Europës për mbrojtjen e të dhënave, në Konferencën “Për mbrojtjen e të dhënave në Shqipëri”, qershor 2007, Tiranë.
10. Raporti i Komisionit European për vitin 2006.
11. Raporti Shpjegues i Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake”.
12. Raporti Shpjegues i Protokollit shtesë të Konventës “Për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave vetjake nga organet mbikëqyrëse dhe fluksi ndërkufitar i të dhënave”.

Shteti i së drejtës dhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Prof. Dr. Avdullah Robaj

PËRMBLEDHJE

Studimi është rezultat i një pune kërkimore të hulumtimit dhe të vështrimit të ndërtimit të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës. Duke studiuar dhe analizuar procesin e tranzicionit dhe të shtetkrijimit të Republikës së Kosovës, që nga vendosja e saj nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së më 10 qershor 1999, shpallja e Kosovës shtet i pavarur dhe sovran më 17 shkurt 2008, e deri te nxjerrja dhe miratimi i Kushtetutës, kam bërë përpjekje dhe angazhime hulumtuese për të nxjerrë në pah të arriturat dhe sfidat e Republikës së Kosovës në ndërtimin e shtetit të së drejtës dhe të një demokracie të qëndrueshme parlamentare.

Jam angazhuar dhe impenjuar në studimin e sistemit politiko-kushtetues në aspektin teorik, duke vështruar dhe analizuar rregullativën juridike të Republikës së Kosovës, e me theks të veçantë Kushtetutën dhe mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, si dhe funksionimin e shtetit të së drejtës.

Në studim është përmbledhur përvoja 9-vjeçare e tranzicionit dhe e shtetkrijimit të Republikës së Kosovës, e paraqitur në mënyrë analitike dhe profesionale.

Fjalë kyçe: shteti i së drejtës, kushtetutshmëria, ligjshmëria, Kushtetuta.

MATERIALI DHE METODAT E PUNËS

Me rastin e punimit të studimit më kanë shërbyer burime të ndryshme

shkencore e profesionale, duke përfshirë tekste universitare, punime dhe artikuj shkencorë, analiza, të dhëna statistikore, akte kushtetuese e legjislativë, e në mënyrë të veçantë sistemin kushtetues të Republikës së Kosovës.

Studimi është punuar me metoda të ndryshme shkencore, të cilat janë tipike për hulumtimet shkencore të shkencave shoqërore dhe humanitare, përkatësisht të së drejtës kushtetuese. Në rastin konkret është përdorur metoda dogmatike, si metodë themelore dhe më e vjetër e studimit të së drejtës kushtetuese, pastaj metoda politikologjike dhe metoda aksiologjike.

DISKUTIMI DHE REZULTATET

Koncepti i shtetit ligjor është njaft kompleks dhe shumëpërmasor. Ai përfshin në vete tërësinë e parimeve juridiko-politike, me të cilat sigurohet sundimi i ligjit në shoqëri. Sundimi i ligjit, përkatësisht qeverisja e të drejtës nënkupton, epërsinë e ligjit ndaj qytetarëve dhe ndaj vet shtetit, si autorë të tij.¹

Termin dhe konceptin “shteti ligjor” e sajuan teoricienët juridikë gjermanë Labandi dhe Jelineku. Mirëpo koncepti i shtetit ligjor, me zhvillimin e vet shtetit, më vonë ka evoluar dhe ka fituar përmbajtjen më të gjërë.²

Në teorinë juridike e politike përdoren shprehjet *shteti juridik*, *shteti ligjor* dhe kohëve të fundit edhe *shteti i së drejtës*. Arsyet pse unë në këtë studim e përdori nocionin “shteti i së drejtës” janë të njëjtat arsye, të cilat i shpjegon profesori i njohur shqiptar Luan Omari. Ai si arsye kryesore emërtimin “shteti i së drejtës” e lidhë me përdorimin e termit në frëngjisht “Etat de droit” dhe italisht “stato di diritto”, që nënkupton “shteti i së drejtës”. Derisa termi “juridik”, në frëngjisht “juridique” dhe në italisht “giuridico”, në shqip përkthehen me “gjendje juridike”, d.m.th. statusi, pozita juridike e një personi, tërësia e të drejtave dhe detyrimeve që i përkasin atij.³

¹ Prof. Dr. Arsim Bajrami, “Demokracia parlamentare”, Prishtinë, 2005, faqe 51.

² Prof. Dr. Kurtesh Salju, “E drejta kushtetuese”, Prishtinë, 2004, faqe 105.

³ Akademik Luan Omari, “Shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002, faqe 1 e 2.

Parimi i shtetit të së drejtës, pa dyshim është një nga parimet më të rëndësishme e më thelbësore për çdo shtet dhe shoqëri demokratike.⁴ Realizimi sa më i plotë i tij në jetën e përditshme është garancia më e mirë për zhvillimin e demokracisë dhe për njohjen dhe zbatimin e të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve.⁵ Mu për këtë, parimet e përgjithshme të shtetit të së drejtës, sot zënë vend të veçantë dhe fiksohen shprehimisht në kushtetutat dhe legjislacionin demokratik bashkëkohor.

Të ashtuquajtura vende të demokracive perëndimore kanë krijuar prej kohësh një përvojë mjaft të pasur e me vlerë në këtë drejtim. Mirëpo kjo dukuri është vënë re dhe si përparësore, sidomos viteve të fundit pas ndryshimeve të rëndësishme politike që u bënë në vendet e Europës Qendrore e Lindore. Në kushtetutat dhe legjislacionin e miratuar prej tyre është treguar kujdes i veçantë që parimet e shtetit të së drejtës të zënë vendin që i takon në të gjithë sistemin shtetëror e shoqëror.⁶

Kur flasim për vendosjen e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës, duhet të kemi parasysh se Kosova, sikurse edhe vendet e tjera ish-RSFJ-së, doli nga një regjim në të cilin mohohej vetë nocioni i shtetit të së drejtës dhe se Kosova për nëntë vite ishte koloni e Serbisë, përkatësisht nën okupimin klasik të Serbisë, ku kjo formë e regjimit serb konsiderohej shtet policor dhe diktatorial. Lufta e UÇK-së dhe intervenimi i NATO-së në mars të 99-ës, bënë që më 10 qershor 1999 Kosova të vendoset nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së.⁷

Vendosja e Kosovës nën administrimin ndërkombëtar të OKB-së kishte

⁴ Prof. Dr. Xhezair Zaganjori, “Demokracia dhe shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002, faqe 70.

⁵ Prof. Dr. Avdullah Robaj, “Demokracia parlamentare dhe shteti i së drejtës në Republikën e Shqipërisë”, Prishtinë, 2007, faqe 170.

⁶ Prof. Dr. Avdullah Robaj, “Demokracia parlamentare dhe shteti i së drejtës në Republikën e Shqipërisë”, Prishtinë, 2007, faqe 170.

⁷ Rezoluta e OKB-së 1244 .

për qëllim ndërtimin e institucioneve të para demokratike dhe përgatitjen e Kosovës për statusin e saj politik e juridik.

Ndërtimi i shtetit të së drejtës në Kosovë paraqet elementin thelbësor të tranzicionit demokratik, të cilën e ka filluar Kosova pas vendosjes së saj nën administrimin ndërkombëtar, në bazë të Rezolutës së OKB-së 1244.⁸

Pavarësia e Republikës së Kosovës më 17 shkurt 2008 dhe njohja e saj ndërkombëtare shtron nevojën imediate për ndërtimin e një shteti demokratik e ligjor dhe me vlera europiane.

Hartimi i Kushtetutës dhe miratimi i saj janë një domosdoshmëri historike, sepse që nga 5 korriku 1990, kur edhe u bë okupimi klasik i Kosovës nga Serbia, e deri më sot, Kosova ishte i vetmi ndër vendet e dala nga regjimi komunist dhe shpërbërja e ish-RSFJ-së që nuk kishte Kushtetutë të plotë e tërësore.

Me Kushtetutën e vitit 2008, e cila duhet vlerësuar si në pajtim të plotë me standardet demokratike europiane, në Republikën e Kosovës hapet rruga për demokratizimin e mëtejshëm të shoqërisë dhe për fuqizimin e shtetit të së drejtës.

Mund të thuhet se kjo Kushtetutë u përgjigjet kërkesave të shkencës bashkëkohore të së drejtës kushtetuese, pavarësisht nga vërejtjet e veçanta që mund të bëhen për ndonjë formulim të saj.

Shfrytëzimi i përvojës së vendeve të tjera parlamentare vlen edhe për një problem kyç, siç është ai i raportit ndërmjet pushteteve të ndryshme, nga i cili përcaktohet edhe forma e qeverisjes, në rastin tonë lloji i republikës. Karakteri parlamentar i Republikës së Kosovës është parashikuar shprehimisht në nenin 1, sikurse edhe në nenin 4 të Kushtetutës. Por, më shumë sesa përkufizimi formal i llojit të republikës, rëndësi ka përcaktimi i qartë dhe i drejtë i ndarjes së pushteteve, i raportit ndërmjet tyre, i

⁸ Prof. Dr. Arsim Bajrami, "Demokracia parlamentare", Prishtinë, 2005, faqe 53.

kompetencave që ka secili nga këto pushtete. Nga ky raport, që përcakton Kushtetuta, del gjithashtu pa mëdyshje karakteri parlamentar i Republikës së Kosovës, sepse Qeveria dhe Parlamenti janë lidhur nga një raport besimi, ndërsa Presidenti i Republikës është një organ kushtetues i veçuar nga Qeveria.

Parimet e shtetit të së drejtës janë këto:

- zgjedhjet e lira dhe demokratike,
- ushtrimi i pushtetit nga shumica,
- respektimi i opozitës,
- konstitucionalizmi,
- garancia e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,
- pavarësia e gjyqësorit,
- ndarja dhe kontrolli i ndërsjellë i pushteteve etj.⁹

Kështu edhe Kushtetuta Republikës së Kosovës, ka bërë përpjekje dhe hapa konkretë që t'i sanksionojë parimet e lartpërmendura dhe parimeve tjera të shtetit të së drejtës, të cilat përbëjnë thelbin e demokracisë. Në këtë drejtim Kosova duhet të vazhdon përpjekjet për të krijuar një shtet të vërtetë të së drejtës. Nisur nga parimet e teorisë së mendimit juridik e politik për karakteristikat kryesore të shtetit të së drejtës, të cilat u përmendën më lart, atëherë duhet të themi se Kushtetuta e Republikës së Kosovës ka përfshirë në tërësi parimet dhe karakteristikat e shtetit të së drejtës. Kjo në të vërtetë edhe shihet më së miri në hyrje të Kushtetutës, përkatësisht këtë e ilustronjë më së miri preambula dhe dispozitat kushtetuese ku “Pavarësia e shtetit dhe tërësia e territorit të tij, dinjiteti i njeriut, të drejtat dhe liritë e tij, drejtësia shoqërore, rendi kushtetues, pluralizmi, të drejtat e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre, bashkëjetesa fetare, si dhe elementi qytetar-shtetas në

⁹ Akademik Luan Omari, “Shteti i së drejtës”, Tiranë, 2002, faqe 51.

vend të atij kombëtar janë bazë e këtij shteti, i cili ka për detyrë t’i respektojë dhe t’i mbrojë”.¹⁰ Sipas Kushtetutës “Kosova është Republikë demokratike e bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë”.¹¹

Në Kushtetutë është evidentuar roli i Kuvendit si organ ligjvënës dhe e drejta e tij për të kontrolluar Qeverinë, sepse pikërisht veprimtaria legjislative dhe kontrolli mbi Qeverinë janë atributet e qenësishme të Kuvendit. Rëndësia e Kuvendit përcaktohet nga fakti se parimet themelore të rendit juridik në Republikën e Kosovës janë sovraniteti i popullit dhe sistemi përfaqësues. Kuvendi përbëhet nga një dhomë e vetme që ka 120 anëtarë (deputetë)¹², ku 100 prej tyre janë të zgjedhur me votim të fshehtë bazuar në listat e hapura, ndërsa 20 vende janë të rezervuara për pakicat, përkatësisht 10 vende për pakicën serbe dhe 10 vende për të gjitha pakicat tjera¹³. Ky element i garantimit të ulëseve në Kuvend për pakicat është një diskriminim pozitiv për pakicat në Kosovë, që është sanksionuar me Kushtetutë e që rrallë ose fare e hasim në të drejtën ndërkombëtare.

Sipas Kushtetutës, “Presidenti përfaqëson unitetin e popullit të Republikës së Kosovës dhe është kreu i shtetit”.¹⁴ Duke u nisur nga ky përcaktim dhe nga konceptimi i rolit të Presidentit të Republikës si faktor ekuilibri në jetën e vendit dhe si një nga garantët e respektimit të Kushtetutës, përlijet plotësisht jo vetëm papajtueshmëria e funksionit të tij me çdo funksion shtetëror a privat, por edhe ndalimi i pjesëmarrjes së tij në çfarëdo parti politike.¹⁵ Presidenti zgjedhet nga Kuvendi me votim të fshehtë.¹⁶ “Zgjedhja e Presidentit

¹⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, nenet 1, 2 e 3.

¹¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4, alinea 1.

¹² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, alinea 1.

¹³ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 64, alinea 2, pika 1.

¹⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 83.

¹⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 88.

¹⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 86, alinea 1.

bëhet me 2/3 e votave të të gjithë deputetëve të Kuvendit¹⁷, ndërsa mandati i tij është 5 vjet, me të drejtë rizgjedhje edhe një herë.¹⁸

Qeveria e Kosovës ushtron pushtetin ekzekutiv në përputhje me Kushtetutën dhe ligjin.¹⁹ Pësha efektive e Qeverisë është pasqyruar dhe në të drejtën që i njihet për të nxjerrë akte normative, si dhe me të drejtën e ushtrimit të funksioneve të tjera ekzekutive, të cilat nuk u janë caktuar organeve të tjera qendrore ose vendore. Në kuadrin e kompetencave të Qeverisë, Kushtetuta parashikon një pozitë të veçantë për Kryeministrin: ai jo vetëm përfaqëson Qeverinë, por edhe koncepton dhe paraqet drejtimet kryesore të politikës së përgjithshme shtetërore dhe përgjigjet për të, si dhe bashkërendon e kontrollon punën e ministrave dhe të institucioneve tjera të administratës qendrore të shtetit.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës e ka zgjidhur në mënyrë demokratike çështjen e pavarësisë së pushtetit gjyqësor. Në bazë të Kushtetutës “Kosova është republikë demokratike, bazuar në parimin e ndarjes së pushteteve dhe kontrollit e balancimit në mes tyre, sikurse është përcaktuar me këtë Kushtetutë”²⁰, ndërsa “pushteti gjyqësor është unik, i pavarur, i drejtë e i paanshëm dhe siguron qasje të barabartë në gjykata”.²¹ Në Kushtetutë theksohet, gjithashtu, se “qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër shtetërore, politike ose private”.²²

Pushteti gjyqësor në Kosovë, si degë e tretë e pushtetit me Kushtetutë, është përcaktuar si i pavarur. Mirëpo çështja e pavarësisë së gjyqësorit dhe raportet e tij me pushtetin legjislativ dhe atë ekzekutiv janë probleme të prekshme për të gjitha demokracitë e pakonsoliduara.

¹⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 86, alinea 4.

¹⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 87, alinea 2 e 3.

¹⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 92, alinea 2.

²⁰ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 4.

²¹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 102, alinea 2.

²² Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 108, alinea 1.

Krijimi i një pushteti të pavarur gjyqësor është kusht më se i domosdoshëm për një shoqëri të lirë demokratike. Mospërfillja e pavarësisë së gjykatave dhe ndërhyrja në veprimtarinë e tyre është karakteristikë për regjimet totalitare e autoritare. Në shtetin demokratik, pavarësia e pushtetit gjyqësor është element dhe garanci tepër e rëndësishme për njohjen dhe zbatimin e parimit të shtetit të së drejtës dhe realizimin në praktikë të të drejtave dhe lirive themelore të njeriut. Pikërisht për këto arsye, pavarësia e pushtetit gjyqësor paraqitet sot si një dukuri e rëndësishme shtetërore me përmasa ndërkombëtare.

Parimi i kushtetutshmërisë ka kuptim vetëm atëherë kur bëhet realitet, kur të ketë efekt pozitiv në sistem dhe në shoqëri, kur harmonizon, orienton dhe zhvillon marrëdhëniet shoqërore në pajtim me kushtetutën dhe frymën e normave të saj.²³

Kushtetutshmëria është element kryesor i shtetit të së drejtës. Epërsia e Kushtetutës mbi të gjitha aktet tjera normative është një postulat i shtetit të së drejtës. Për të garantuar epërsinë e Kushtetutës, një mjet i rëndësishëm është ekzistenca e një drejtësie kushtetuese që bën të mundshëm realizimin e kërkesës që edhe shteti t'u nënshtrohet normave më të larta. Mekanizmi i mbrojtjes së Kushtetutës dhe i kushtetutshmërisë është Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës, gjykatë e cila është kategori kushtetuese. Kjo ilustron me faktin se “Gjykata Kushtetuese garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj”.²⁴

Krijimi dhe funksionimi i Gjykatës Kushtetuese është faktor i rëndësishëm e pozitiv drejt ndërtimit të një demokracie të qëndrueshme e funksionale dhe në mënyrë të veçantë drejt ndërtimit të shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës. Gjykata Kushtetuese është garanci dhe shpresë për forcimin dhe konsolidimin e shtetit demokratik dhe shtetit të së drejtës në Kosovë.

Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe garantimi i tyre me norma

²³ Prof. Dr. Kurtesh Saliu, “E drejta kushtetuese”, Prishtinë, 2004, faqe 137.

²⁴ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, alinea 1.

kushtetuese dhe mekanizma tjerë mbrojtës, janë garancë e veçantë për ndërtimin e shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës. Mu për këtë Kushtetuta e Kosovës në pjesën e dytë dhe të tretë ia kushton pikërisht këtyre të drejtave, që paraqet një dëshirë dhe detyrim të shtetit të Kosovës, që të vazhdojë rrugën e nisur drejt ndërtimit të vlerave demokratike, përkatësisht ndërtimit të një shteti të së drejtës.

Në Kushtetutën e Republikës së Kosovës të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe shtetasit janë përcaktuar në pjesën e dytë të saj²⁵, në të cilët janë trajtuar parimet e përgjithshme të këtyre të drejtave dhe lirive: liritë dhe të drejtat vetjake, liritë dhe të drejtat politike, liritë dhe të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore, objektivat sociale. Në këtë kre mbi të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, trajtohen parimet e përgjithshme, të cilat qartësojnë të drejtat dhe liritë e veçanta të njeriut. Ndër këto parime janë: karakteri i patjetërsueshëm i të drejtave dhe kuptimi i tyre si themel i të gjithë rendit juridik, detyrimi i organeve të pushtetit që, në përmbushje të detyrave të tyre, t'i respektojnë këto të drejta dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre etj.

Një kre i veçantë, përkatësisht kreu i tretë, u kushtohet të drejtave të bashkësive dhe pjesëtarëve të tyre.²⁶ Sipas Kushtetutës “banorët që i përkasin një grupi të njëjtë kombëtar apo etnik, gjuhësor apo fetar, tradicionalisht të pranishëm në territorin e Republikës së Kosovës (Komunitetet), do të kenë të drejta të posaçme, të parashikuara me këtë Kushtetutë”.²⁷ “Pjesëtarët e komuniteteve do të kenë të drejtë që të shprehin, të avancojnë dhe të zhvillojnë lirisht identitetin e tyre dhe atributet si komunitet”.²⁸ “Republika e Kosovës siguron kushtet e duhura, të cilat u mundësojnë komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre që të ruajnë, të mbrojnë dhe të zhvillojnë identitetin e tyre.”.

²⁵ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 21-56.

²⁶ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 57-62.

²⁷ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 57, alinea 1.

²⁸ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 57, alinea 3.

Për realizimin e të drejtave dhe lirive themelore janë parashikuar disa garanci kushtetuese. Gjykata Kushtetuese “garanton respektimin e Kushtetutës dhe bën interpretimin përfundimtar të saj.”²⁹ Ky konceptim i këtij organi, ndër të tjera, garanton respektimin e të drejtave themelore kushtetuese të shtetasve, nëpërmjet kontrollit të procesit ligjor.

Në Kosovë gjatë fazës së shtetndërtimit, përkatësisht të administrimit nga OKB-ja, janë organizuar 3 palë zgjedhje parlamentare pluraliste e demokratike, të cilat shënojnë një hap përpara drejt ndërtimit të shtetit të së drejtës. Mënyra e organizimit të zgjedhjeve dhe ushtrimi i pushtetit nga shumica, si dhe ndërimi i pushtetit pa dhunë, e sidomos kjo vlen për zgjedhjet e fundit parlamentare, janë premisa të forta dhe shpresëdhënëse se në Kosovë ngadalë, por sigurt, po vihen konturet dhe themelet e shtetit të së drejtës.

Respektimi i opozitës është një segment tjetër dhe element kyç në ndërtimin e demokracisë parlamentare dhe ndërtimin e shtetit të së drejtës. Në fund të fundit, qëllimi dhe synimi kryesor i forcave opozitare në Kuvend është të mbajnë gjallë procesin demokratik dhe të bindin zgjedhësit mbi domosdoshmërinë e ndryshimit të qeverisjes së vendit.

Gjithsesi duhet pasur parasysh se ekzistenca e kuadrit kushtetues e ligjor është vetëm një premisë e domosdoshme për shtetin e së drejtës. Rëndësi po aq të madhe ka funksionimi i mekanizmave të ndryshëm të kontrollit të zbatimit të normave kushtetuese e ligjore dhe veçanërisht krijimi i një mendësie të re, si të funksionarët publikë, ashtu edhe të qytetarët, që shprehet në qëndrimin e vetëdijshëm për nevojat e zbatimit të këtyre normave dhe në reagimin, me mjete ligjore e demokratike, ndaj shkeljeve të tyre nga kushdo qoftë.

PËRFUNDIME DHE REKOMANDIME

Përgjithësisht mund të vlerësohet se ndërtimi dhe funksionimi i shtetit të së drejtës në Republikën e Kosovës është i një rëndësie të veçantë dhe

²⁹ Kushtetuta e Republikës së Kosovës, neni 113, alinea 1.

faktor i rëndësishëm pozitiv në procesin e vështirë të shkëputjes nga e kaluara dhe të orientimit drejt ndërtimit të një shoqërie demokratike dhe multietnike. Edhe pse Republika e Kosovës është shteti më i ri në Europë dhe e dalë nga një luftë e përgjakshme dhe shkatërrimtare, megjithatë ka arritur që të konsolidohet dhe të ndërtojë institucione të mirëfillta demokratike gjatë periudhës së tranzicionit dhe të shtetkrijimit, duke krijuar imazhin dhe besimin e një shteti modern dhe me vlera europiane.

Megjithatë, Republika e Kosovës duhet të bëjë edhe më shumë në ndërtimin e një shteti funksional, të qëndrueshëm e demokratik. Ligjet që dalin nga Pakoja e Presidentit Martti Ahtisaari, dhe që kanë për qëllim mbrojtjen dhe garantimin e pakicave kombëtare dhe të trashëgimisë kulturore të tyre, si dhe integrimi i tyre në jetën institucionale e shoqërore të Kosovës, janë domosdoshmëri për ndërtimin e shtetit të së drejtës.

BIBLIOGRAFIA

Bajrami Arsim, “Demokracia parlamentare”, Prishtinë 2005.

Lëfor Klod, Demokracia dhe totalitarizmi, Tiranë 1993.

Omari Luan, Sistemi Parlamentar, Tiranë, 2000.

Omari Luan, Parime dhe institucione të së drejtës publike, Tiranë, 1999 dhe 2006 (botimi i tetë).

Omari Luan, Shteti i së drejtës, Tiranë, 2002.

Robaj Avdullah, “Demokracia parlamentare dhe shteti i së drejtës në Republikën e Shqipërisë”, Prishtinë, 2007.

Saliu Kurtesh “E drejta kushtetuese I”, Prishtinë, 2004.

Zaganjori Xhezair, Demokracia dhe Shteti i së Drejtës, Tiranë, 2002.

Kushtetuta e Republikës së Kosovës.

Rezoluta e OKB-së 1244, 10 qershor 1999.

Korniza Kushtetuese për Vetëqeverisje të Përkohshme në Kosovë, 15 maj 2001.

Konfliktet gjeopolitike në Europë dhe jurisprudenca e Gjykatës Europiane të Strasburgut

Merita ANDREA

Është e njohur tashmë që gjeopolitika, si një shkencë shoqërore në rend të ditës, vazhdimisht është e prirë të studiojë pasojat politike të gjeografisë dhe, në një rrafsh më gjithëpërfshirës raportet e ndryshme që krijohen midis të dhënave natyrore të gjeografisë dhe politikës së ndjekur nga shtete të ndryshme.

Një vështrim i shkurtër historik i kësaj shkence na lejon të shohim se që më 1904 profesori suedez Rudolph Kjellen e përkufizonte gjeopolitikën si “shkencën politike të shtetit”, marrë ky si një organizëm gjeografik ose si një entitet në hapësirë. “Si shkencë politike”, vinte në dukje ai, gjeopolitika “vëzhgon nga afër njësinë shtetërore dhe kërkon të ndihmojë në kuptimin e natyrës së Shtetit”¹. Në këtë përkufizim, Kjellen ka pasur parasysh elementet e gjeografisë politike parashtruar më parë nga Friedrich Ratzel, ati i *Geopolitik*, i cili e analizon shtetin në raport me gjeografinë, hapësirën, mjedisin e tij, duke qenë të dy në proces të vazhdueshëm ndërveprues.

Në vitet 1970, pas konflikteve të ndryshme që karakterizuan këtë periudhë, gjeopolitika rigjeti një përligjje të re trajtimi. Për gjeopolitikanin Yves Lacoste,

¹ Rudolph Kjellen, “Les grandes puissances”, *Stormakterna. Konturer kring samtidsens storpolitik*, 1905.

gjeopolitika e re nuk bën gjë tjetër veçse studion ndërveprimin midis politikës dhe territorit. Sipas tij, gjeopolitika është “më shumë një *orvatje intelektuale* e shkencore, sesa një shkencë e mirëfilltë, një *mënyrë shikimi e gjërave* që favorizon konfiguracionet hapësinore e gjeografike (gjeopolitike) të dukurive të llojeve të ndryshme që përfshihen në kategorinë e politikës”.²

Duke i vjelë të dhënat e saj herë nga historia e herë nga gjeografia, gjeopolitika bën të mundur në të vërtetë kuptimin e synimeve dhe të qëndrimeve të drejtuesve ndërkombëtarë, si dhe të marrëdhënieve midis shteteve. Në mënyrë më të përgjithshme ajo lejon të dallohen sfidat e marrëdhënieve ndërkombëtare. Për Pascal Larot, falë gjeopolitikës, mund të piketohen, identifikohen e analizohen “konfliktet sapo zënë e shfaqen strategjitë ofensive dhe difensive për marrje në zotërim të një territori”.

Ndër faktorët dhe motivet e shumta që shkaktojnë situata të caktuara gjeopolitike dhe përbëjnë “karburatorë të historisë”, François Thuau, nga ana e tij, dallon motivimet ideologjike, motivimet gjeostrategjike (lakminë për zotërim territorial) dhe përparësinë ekonomike (mondializimin e ekonomisë dhe krijimin e metropoleve politiko-ekonomike)³. Për të, “gjeopolitika nuk është shkencë, por thjesht një metodë, një mënyrë për të nxjerrë në pah kuptimin e thellë të ngjarjeve me qëllim që të diktohen pikësnyimet dhe të identifikohen ambiciet e antagonistëve të ndryshëm”⁴. Në morinë e konflikteve gjeopolitike europiane, ai veçon në radhë të parë konfliktin e identitetit, konflikt ky që shkaktohet pikërisht kur një grup ndjek objektiva gjeopolitike jo vetëm në emër të mbrojtjes së identitetit të vet, por edhe pasi është i sigurt se

² Alexandre de Valle, “*De la stratégie à la géopolitique, quelques éléments d’une approche pluridisciplinaire* » <http://www.strategicsinternational.com>.

³ François Thuau, *Méthodes de la géopolitique*, Ed. Ellipses 1996 ou www.dachary.org/obses/geopo.html.

⁴ Lucien Favre, « Les méthodes de la géopolitique », recension sur le livre de François Thuau, *Méthodes de la géopolitique. Apprendre à déchiffrer l’actualité*, Ed. Ellipses.

kërcënohet me zhdukje si pasojë e një sundimi të padurueshëm (shembull konkret: ish-Federata jugosllave). Një konflikt tjetër është konflikti i hershmërisë, konkretisht kur dy vende ndeshen në të njëjtin rajon në emër të një ekzistence më të hershme. Si shembull këtu mund të merret Karabaku i Sipërm, Transilvania ose edhe Kosova, e cila fitoi më në fund me të drejtë pavarësinë e saj. Por nuk mund të lëmë nga ana tjetër pa përmendur edhe konfliktet kombëtare të shkaktuara midis grupeve etnike ose fetare, në të shumtën e rasteve si pasojë e urrejtjeve të lashta. Janë pikërisht konfliktet kombëtare e ndërkombëtare ndër shkaqet kryesore për paqëndrueshmërinë në botë dhe për shtimin e dhunës për qëllime politike. Mund të përmenden këtu konfliktet kombëtare në ish-BRSS, përplasja e armenasve me azeritë myslimanë, e çeçenëve me rusët, e moldavëve me ukrainasit e rusët, si dhe në ish-Jugosllavi, përplasja historike të shqiptarëve të Kosovës me serbët ose në Europën Perëndimore përplasja e baskëve me spanjollët etj.

Shpërbërja e BRSS dhe rënia e murit të Berlinit shënuan, siç dihet, zhdukjen e rendit të vjetër botëror të mbështetur tek antagonizmi i dypalëve, duke e zëvendësuar këtë antagonizëm me probleme të tjera që shkaktuan një “çrregullim të ri”, pasqyrimi dramatik i së cilës shfaqet në pafuqishmërinë për të kontrolluar konfliktet, siç ka ndodhur në Ballkan ose siç ndodh në vendet balte.

Revolucioni paqësor që u zhvillua në Europën Qendrore e Lindore, ndryshoi pamjen politike të trashëguar pas Luftës së Dytë Botërore. Për rrjedhojë, vendet e saj hynë në rrugën e zhvillimit demokratik, por pa mundur t’u jepnin zgjidhje problemeve të tyre në lidhje me të shkuarën. Kështu, nuk do vononin të shfaqeshin disa konflikte midis shteteve, mjetet për zgjidhjen e të cilave nuk do mungonin po ashtu të shkaktonin ndryshime. Mosmarrëveshjet, që janë shkaku i këtyre konflikteve, lindën sidomos pas tërheqjes së trupave sovjetike, por nuk mund të mos përmendim edhe problemet që kishin të bënin me ribashkimin e dy Gjermanive.

Mjetet e para që përdorin zakonisht shtetet për të qetësuar konfliktet

gjeopolitike janë mënyrat diplomatike. Çdo vend, në të vërtetë, vë në lëvizje mekanizmin e tij diplomatik për të administruar marrëdhëniet e tij të jashtme, mbështetur këto mbi një rrjet aleancash e ndikimesh. Në të vërtetë, zgjidhja paqësore e konflikteve është bërë sot një objektiv madhor për çdo vend demokratik dhe për çdo organizëm europian e ndërkombëtar. Madje është bërë një kusht *sine qua non* për anëtarësim në Këshillin e Europës.

Kështu, në kuadrin e kërkesave për pranim të Armenisë e të Azerbaixhanit në organizatën më të vjetër europiane që është Këshilli i Europës, zgjidhja paqësore e konflikteve në Karabakun e Sipërm luajti një rol domethënës. Po kështu edhe për pranimin e Gjeorgjisë, e ftuar kjo të zgjidhë konfliktin e Abkasisë e të Osetisë së Jugut. Sa për Rusinë, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, gjatë seancës së vet dëgjimore të 30 janarit 1995 arriti deri aty sa të vendosë të pezullojë procedurën lidhur me dhënien e rekomandimit statutor për kërkesën e pranimin të këtij vendi në Këshillin e Europës, për aq kohë sa konflikti në Çeçeni nuk do të gjente një zgjidhje paqësore.⁵

Forcimi i paqes bazuar mbi drejtësi e bashkëpunim ndërkombëtar, është një çështje me interes jetësor për ruajtjen e shoqërisë njerëzore e të qytetërimit.⁶ Vetë Hyrja e Statutit të Këshillit të Europës (§ 7, përfshirë në Rekomandimin 1212 (1993) të Asamblesë Parlamentare) është formuluar si vijon:

“Këshilli i Europës ka për qëllim të mbledhë vendet e Europës për të bashkëpunuar në gjirin e tij mbi bazën e barazisë dhe të zhvillojë në të lidhje përherë e më të ngushta që garantojnë në këtë mënyrë paqen, sigurinë dhe stabilitetin demokratik të kontinentit.”

Pikërisht, një tekst i tillë i shërbeu Asamblesë Parlamentare të parashtronte për çdo anëtar të ri të Këshillit të Europës kushtin për të qenë një shtet

⁵ Rezolutë e Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës.

⁶ K. Drezwicki citë par Bruno Haller, dans « *L'Assemblée Parlementaire et les conditions d'adhésion au Conseil de l'Europe* », Kluwer, *Law international*, 2000, p. 73.

paqësor, një “peace-loving”⁷ e për të zgjidhur konfliktet e veta me shtete të tjerë anëtarë të Organizatës nëpërmjet rrugës së dialogut e të bashkëbisedimit. Një klauzolë e tillë tregon më së miri angazhimin e Këshillit të Europës në favor të zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve dhe kundërshtimin e tij të vendosur ndaj përdorimit të forcës. Ky qëndrim u shfaq praktikisht i dobishëm sidomos nga viti 1989, për të mbështetur vendet e Europës së Lindjes e të Jug-lindjes, shtetet kandidatë dhe anëtarët e rinj, drejt demokracisë, si dhe për të konsoliduar stabilitetin politik në Europë.

Nuk ka dyshim se nevoja për të shmangur konfliktet e armatosura, për të parandaluar përplasjet e dhunshme midis bashkësive, etnive, kombeve dhe shteteve, është e lidhur ngushtë me nevojën për të mbrojtur tërësinë e të drejtave të njeriut, një qëllim ky “i pashmangshëm, përderisa bëhet fjalë për Njeriun, për Njeriun në njëjësinë e tij të plotë”.⁸ Konventa e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), zbatimi i parë i vërtetë i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut⁹, përmban pikërisht “nene që jo vetëm mbrojnë individin kundër shtetit, por e detyrojnë shtetin të mbrojë të drejtat e individit qoftë edhe kundër veprimeve të të tjerëve”.¹⁰

Duhet theksuar se konfliktet gjeopolitike, zgjidhja e të cilave përfaqëson në vetë thelbin e saj mbrojtjen dhe garancinë e të drejtave individuale e kolektive, asnjëherë nuk kanë munguar në jurisprudencën e Gjykatës së Strasburgut. “Shumica e konflikteve, nënvizon Vincent Berger, “vetë-parashtrohen”, herët a vonë, para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut

⁷ Po aty.

⁸ G. Cohen-Jonathan, « La Déclaration universelle et la conception des droits de l’homme », *Law in Greater Europe*, f. 219, 372-373.

⁹ Ibid. p. 208.

¹⁰ G. Cohen-Jonathan, «La Convention européenne des Droits de l’Homme », *Economica*, 1989, p. 372-373.

në Strasburg, e ngarkuar për të ndjekur nga afër zbatimin e KEDNJ-së në dyzet e gjashtë shtete anëtare të Këshillit të Europës. Veç terrenit politik, diplomatik dhe ndonjëherë ushtarak ku veprojnë, ato [konfliktet] marrin, gjithashtu, edhe një përmasë juridiksionale.”¹¹

Një pyetje parashtrohet natyrshëm në këtë rast: A është në gjendje Gjykata europiane e të Drejtave të Njeriut të parashtrorë zgjidhje për konflikte të tilla?

Në të vërtetë, ky studim nuk ka për qëllim të tregojë rolin e Gjykatës së Strasburgut për zgjidhjen e konflikteve gjeopolitike. Duke qenë se në origjinë të këtyre konflikteve janë problemet politike, edhe zgjidhjet, kuptohet, duhet të jenë po të karakterit politik. Mundësitë e Gjykatës për të ndryshuar gjërat në një kontekst të përcaktuar konfliktesh gjeopolitike janë tepër të kufizuara. Gjykatësi europian Pettiti shprehet në çështjen Loizidu (Qipro) se “tërësia e problemit të dy bashkësive [turke e greke]... ka të bëjë më shumë me fushën politike e diplomatike se sa me një shqyrtim juridiksional europian”. Dhe dihet që Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut nuk është tjetër veçse një instrument juridik, vlera e parë e të cilit mbështetet mbi një mekanizëm kontrolli që ka për qëllim të sigurojë mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Ky studim, pas një klasifikimi të çështjeve që pasqyrojnë konfliktet gjeopolitike sipas tipologjisë së tyre, ka për qëllim të përqendrohet te disa veçori procedurale të ankesave të paraqitura në këtë drejtim në Gjykatë, si nëpërmjet rekurseve shtetërore, ashtu edhe atyre individuale, si dhe të tregojë se si Gjykata, përveç analizës juridike të fakteve, në raste të veçanta ka qenë e detyruar që në vende të caktuara të hetojë faktet e paraqitura nga palët përpara se të marrë një vendim të caktuar.

Në përfundim, do dëshironim të nxirrnim në pah faktin se në jurisprudencën e saj, Gjykata e Strasburgut jo vetëm frymëzohet nga e drejta ndërkombëtare, sidomos kur trajton probleme delikate siç janë konfliktet gjeopolitike, por ajo

¹¹ Vincent Berger, « Cour européenne des Droits de l’Homme et conflits géopolitiques ».

ka dhënë para së gjithash një ndihmesë me vlerë të veçantë në vetë evolucionin e nocioneve juridike.

I. TIPOLOGJIA E ÇËSHTJEVE LIDHUR ME KONFLIKTET GJEOPOLITIKE

Studimi i vendimeve të marra nga Gjykata europiane e të Drejtave të Njeriut në çështjet që pasqyrojnë konfliktet gjeopolitike midis shteteve palë, si dhe literatura e konsultuar për këtë qëllim, japin mundësinë e klasifikimit të këtyre çështjeve në dy kategori:

1. Çështje ku Gjykata përballet e vetme me Palët kontraktuese në konflikt

Kjo kategori ka të bëjë me çështje në të cilat Gjykata ndodhet e vetme për të trajtuar pasojat që sjellin konfliktet gjeopolitike në rrafshin e të drejtave të njeriut. Janë ankesa të shtrua para saj sidomos nëpërmjet rekurseve individuale, të cilat janë bërë më të shpeshta si rezultat i konflikteve gjeopolitike të krijuara pas shpërbërjes së BRSS-së. Në shumicën e çështjeve të kësaj kategorie, ankuesit parashtrojnë kryesisht shkelje që kanë të bëjnë me bërthamën e Konventës, por edhe shkelje të neneve të tjera si nenet 8, 11, 13 e të nenit 3 të Protokollit n° 1.

A. Shkelje të neneve bazë, konkretisht të neneve 2, 3 dhe 5 të Konventës

Çështjet që vijnë nga ankues që banojnë në vendet e Kaukazit, kanë të bëjnë kryesisht me nenin 2 (e drejta për jetën), nenin 3 (ndalimi i torturës) dhe nenin 5 (e drejta e lirisë dhe e sigurisë).

Kaukazi i Veriut, arenë e një lufte që po zgjat që prej dhjetë vjetësh midis ushtrisë ruse dhe independentistëve çeçenë, ka njohur ekzekutime dhe shkatërrime masive. Konflikti shfaqet në jurisprudencën e Gjykatës, midis të tjerave nëpërmjet një serie çështjesh drejtuar kundër Ruisisë, në të cilat,

një shkelje e dyfishtë e nenit 2 është vënë re gjatë operacioneve të forcave të armatosura ruse në Çeçeni. Në çështjen *Khachiev e Akaieva kundër Ruisë*, Gjykatës së Strasburgut iu desh të përballej me vështirësinë për të përcaktuar kush përgjigjej me të vërtetë për vdekjen e njerëzve të afërt të ankuesit, trupat e të cilëve të bërë shosh nga plumbat u rigjetën në Grozni. Dy çështjet e tjera, *Issaieva e të tjerë kundër Ruisë dhe Issaieva kundër Ruisë*, kanë të bëjnë drejtpërdrejt me bombardimin, kryer në mënyrë të verbër, të një karvani me civilë dhe të një fshati të tërë.

Këto ankesa, paraqitur në vitin 2000, menjëherë pas ngjarjeve që ndodhën në verë të 1999-ës në Grozni, çuan në vendime për pranueshmërinë e themelit nga ana e Gjykatës, e cila arriti në përfundimin se vëren shkelje të neneve 2 dhe 3, për përdorim force vdekjeprurëse nga agjentë shtetërorë, dhe për mosrealizim të hetimeve në kohën e duhur dhe në mënyrë efektive.

Në këto vende, ku konflikti është i fortë, ku atentatet vdekjeprurëse janë të pranishme dhe luftimet shumë të ashpra, e drejta për jetën shkelet në mënyrë të përhershme dhe rrjedhimisht, ankesat që parashtrajnë shkelje të tilla të së drejtave themelore vazhdojnë të paraqiten rregullisht para Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut. Një gjë e tillë dëshmon qartë se Konventa për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive themelore, ka fituar përherë e më shumë forcë në vetë terrenin e përplasjeve e të konflikteve, duke u bërë kështu një instrument juridik ndërkombëtar i denjë për t'u besuar nga çdo qytetar europian dhe çdo viktimë, instrument i aftë për të mbrojtur efektivisht e aktivisht të drejtat themelore të njeriut në vetë terrenin konkret.

Po kështu, çështja e kurdëve në Turqi u përfaqësua para Gjykatës së Strasburgut nëpërmjet ankesës *Issa e të tjerë kundër Turqisë* (16 nëntor 2004). Ankuesit janë njerëz të afërt të barinjve kurdë të arrestuar, të burgosur, të keqtrajtuar e më pas të asgjësuar gjatë një operacioni ushtarak të ndërmarrë nga ushtria turke në veri të Irakut në prill 1995. Duke analizuar me kujdes faktet, Gjykata vlerësoi se Iraku ndodhet jashtë hapësirës juridiksionale të Konventës e për rrjedhojë nuk e gjykoi të nevojshme të vazhdojë shqyrtimin

e akuzave të tjera parashtruar nga ankuesit, mbështetur në nenet 2, 3, 5 dhe 8 të Konventës Europiane.

Çështja e zhdukjes së personave ka qenë strumbullari i ankesës së vetme ndërshtetërore të shqyrtuar në vitin 2001. Ankesa, drejtuar nga Qiproja kundër Turqisë, parashtronte akuza të shumta dhe konkretisht vinte në dukje se Turqia vazhdonte të shkelte nene të ndryshme të Konventës pas miratimit të dy raporteve të Komisionit europian të të Drejtave të Njeriut. Megjithëse zhdukjet e personave kishin ndodhur më 1974, Gjykata vlerësoi se mungesa hetimore efektive e mëpasshme kishte sjellë shkelje të nenit 2, si dhe të nenit 5 të Konventës.

Në çështjen *Xenides-Arestis kundër Turqisë*, që pasqyron sikurse vendimi *Loizidou* një aspekt tjetër të pasojave që rrjedhin nga konflikti Qipro-Turqi, Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 1 të Protokollit n° 1, por edhe shkelje të nenit 8 të Konventës, duke qenë se ankueses iu ndalua të rikthehej në banesën e saj në pjesën veriore të ishullit. Në këtë çështje, nën këndvështrimin e nenit 46 të Konventës, Gjykata paraqiti komentin e vet se shteti mbrojtës “duhet të vendosë një rekurs që të garantojë me të vërtetë një dëmshpërblim efektiv të shkeljeve të Konventës dhe se ky dëmshpërblim duhet të jepet brenda tre muajve që pasojnë dhënien e vendimit”, çka dëshmon vullnetin e Gjykatës për të përcaktuar masa konkrete që duhet të marrë një shtet për t’u përshtatur me vendimin e Gjykatës.

Moldavia, ish-republikë sovjetike, humbi kontrollin e Transnistrisë, ku ishte vendosur një regjim i vetëshpallur që nuk është njohur nga bashkësia ndërkombëtare dhe ku është stacionuar një ushtri ruse. Konflikti i Transnistrisë pasqyrohet në jurisprudencën e Gjykatës me çështjen *Iliaciu e të tjerë kundër Moldavisë e Rusisë*. Ankuesit, njohur fajtorë nga një gjykatë e “Republikës moldave të Transnistrisë” u dënuan, njëri me dënim kapital dhe tre të tjerët me burgim. Vendimi u deklarua më pas i pakushtetueshëm nga Gjykata e lartë e Moldavisë. Një nga ankuesit u lirua në vitin 2001 ndërsa tre të tjerët vetëm në vitin 2007, pasi përfunduan ekzekutimin e dënimit që ishte lëshuar nga autoritetet e brendshme.

Ankuesit i janë drejtuar Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në bazë të nenit 6 të Konventës (e drejta për një proces të drejtë), duke u ankuar për procedurën (e cila përfundoi me dënimin e tyre më 1993), dhe duke e cilësuar burgimin e tyre prej asaj kohe si të parregullt, që bie ndesh me nenin 5 të Konventës. Ata denoncojnë, gjithashtu, kushtet e burgimit, duke përmendur nenin 3 (për ndalimin e trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese) dhe nenin 8 (të drejtën për të respektuar jetën private dhe korrespondencën). Në mënyrë të veçantë, ata e vënë theksin në shkeljen e nenit 34 të Konventës (të drejtën për rekurs individual).

Sipas ankuesve, autoritetet moldave janë përgjegjëse në bazë të Konventës për shkeljet e parashtruara të të drejtave që u garanton kjo Konventë, duke qenë se ato nuk kanë marrë masat e duhura për t'u dhënë fund shkeljeve. Nga ana tjetër, bëjnë me përgjegjësi edhe Federatën e Rusisë, sepse territori i Transnistriës gjendej e gjendet ende nën kontrollin faktik të Rusisë, për shkak të trupave dhe pajisjeve ushtarake ruse të stacionuara në të, si dhe të përkrashjes që ky vend i bën regjimit separatist.

Konflikti i brendshëm në Gjeorgji midis autoriteteve vendore dhe autoriteteve qendrore është përcjellë në Gjykatë nëpërmjet ankesës *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, në të cilën ankuesi, deputet i Këshillit të lartë të Republikës Autonome të Axharisë padit mbajtjen e tij në burg nga autoritetet e RA të Axharisë, pavarësisht nga falja presidenciale që i është bërë. Gjykata vëren se R.A e Axharisë është pjesë përbërëse e territorit të Gjeorgjisë dhe është e mendimit se faktet prej nga rrjedhin shkeljet e përmendura varen nga “juridiksioni” i shtetit gjeorgjian në kuptimin e nenit 1 (detyrimi për të respektuar të drejtat e njeriut) të Konventës.

Konflikti i jashtëm i Gjeorgjisë gjen shprehjen e vet në Gjykatë nëpërmjet çështjes *Chamaiev kundër Gjeorgjisë e Rusisë*. Ankuesit, me kombësi ruse e gjeorgjiane (çeqene) i janë drejtuar Gjykatës për të kundërshtuar ekstradimin e tyre kërcënues në Rusi, ku dënimi me vdekje nuk është hequr, çka i vë ata përpara rrezikut real të vdekjes ose të torturave, në shkelje të

neneve 2 dhe 3 të Konventës. Ata denoncojnë nga ana tjetër keqtrajtimet që u bëhen. Pas një kërkese parashtruar nga autoritetet ruse, të cilat deklarorin se të burgosurit ishin rebelë terroristë që kishin marrë pjesë në konfliktin e Çeçenisë, homologët gjeorgjianë, nisur nga akuzat e rënda ndaj këtyre personave në Rusi, vendosën të japin pëlqimin për ekstradimin e tyre në tetor 2002.

Pas një shqyrtimi të hollësishëm të fakteve, Gjykata, duke pasur parasysh rrethanat e ekzekutimit të vendimeve për ekstradimin e katër ankuesve nga autoritetet gjeorgjiane dhe, nisur nga dëmtimet fizike shkaktuar të interesuarit të çështjes nga ana e forcave speciale, pasuar nga mungesa e përkujdesit mjekësor të nevojshëm e në kohën e duhur, konkludoi se vëren shkelje të nenit 3. Gjykata nuk i kurseu nga ana tjetër as autoritetet ruse, duke i shpallur fajtores për shkelje të nenit 5 § 4 të Konventës, për shkak se ankuesit nuk ishin informuar në kohë për mbajtjen e tyre në burg.

B. Shkelje të neneve të tjera të Konventës

Ndërsa në zonën e Kaukazit e të Transnistrisë, shpërbërja e perandorisë sovjetike shkaktoi konflikte të ashpra, karakterizuar nga viktima njerëzore dhe shkelje të rënda të lirive themelore, në zonën e vendeve balte konfliktet u shprehën nëpërmjet çështjesh që pasqyrojnë shkelje të neneve që kanë të bëjnë me të drejtën për respektimin e jetës private e familjare, siç e tregon çështja *Slivenco kundër Letonisë*. Ankueset (nënë e bijë) përmendin shkelje të nenit 8 të Konventës, sepse masa e marrë për largimin e tyre nga territori leton përbente një diskriminim, për shkak të përkatësisë së tyre në minoritetin rusofon dhe për faktin se ato ishin familje e një ushtaraku rus. Gjykata nuk mund të ishte e mendimit se masa e largimit nga territori leton, marrë ndaj të interesuarave, ishte “e domosdoshme në një shoqëri demokratike”.

Në çështjet balte është shumë i pranishëm po ashtu neni 3 i Protokollit n° 1 të Konventës, e drejta për zgjedhje të lira. Çështjet *Zdanoka kundër Letonisë e Podglozina kundër Letonisë*, fokusohen në kundërshtimin nga

ana e autoriteteve vendore lidhur me të drejtën e çdo personi për t'u shpallur kandidat në zgjedhje. Në çështjen e parë ankuesja nuk është lejuar për t'u shpallur kandidatë në zgjedhjet legjislativë, për shkak të pjesëmarrjes së saj të shkuar në veprimtaritë e partisë komuniste. Gjykata arriti në përfundimin se kishte shkelje të nenit 3 të Protokollit nr.1 dhe të nenit 11 të Konventës. Duke pasur parasysh rëndësinë e çështjes, kjo u kalua, gjithashtu, për shqyrtim në Dhomën e Madhe të Gjykatës. Lidhur me çështjen e dytë, ankuesja, anëtare e minoritetit rusofon në Letoni padit faktin se emri i saj ishte fshirë nga lista e kandidatëve për zgjedhjet parlamentare nën pretekstin e pamjaftueshmërisë së njohjes së gjuhës letone dhe përmend nga ana tjetër shkeljen e nenit 3 të Protokollit nr.1. Si shqyrtoi çështjen, Gjykata vërejti se procedura e zbatuar ndaj ankuses ishte e papajtueshme me kushtet e barazisë procedurale dhe të sigurisë ligjore kërkuar në fushën e zgjedhjes së kandidatëve dhe në këtë mënyrë arriti në përfundimin se vërente shkelje të nenit 3 të Protokollit nr.1.

Edhe pse konfliktet e kësaj kategorie mund të konsiderohen si probleme të brendshme, mjetet e përdorura nga autoritetet vendore përbëjnë shkelje të detyrimeve ndërkombëtare, duke qenë se këto çështje mbartin në vetvete konflikte qytetarësh nga radhët e minoriteteve.

2. Çështje ku hyjnë në lojë organizatat dhe/apo organizmat ndërkombëtare

Kategoria e dytë lidhur me konfliktet gjeopolitike ka të bëjë me çështje në të cilat Gjykata e Strasburgut është e përfshirë, përkrah organizmave ndërkombëtare, për të trajtuar pasojat e konfliktit në zonën e Ballkanit, konkretisht në ish-Jugosllavi. Ndryshe nga çështjet e kategorisë së parë, këtu, palët kontraktuese të akuzuara janë njëkohësisht edhe anëtare të Këshillit të Europës, edhe anëtare të NATO-s.

¹² Michel Roux, « Le Kosovo, dix clés pour comprendre », Ed. la Découvert, 1999, f. 62.

Kosova, e konsideruar si një “zonë në rindërtim e sipër”¹², përbënte, një rast të veçantë, krejtësisht origjinal nga pikëpamja e përgjegjësive të marra përsipër për shkak të shkeljeve të KEDNJ-së kryer mbi këtë territor. Ky konflikt, gjatë të cilit u kundërvunë forcat e armatosura serbe dhe ato shqiptare në Kosovë në vitet 1998-1999, shkaktoi një gjendje shumë të nderë në rajon. Përpara shkallëzimit të dhunës dhe duke pasur parasysh shqetësimin në rritje të bashkësisë ndërkombëtare, si dhe dështimin e nismave diplomatike, ndërhyrja e Grupit të Kontaktit, që vendosi organizimin e bisedimeve midis palëve në konflikt, ishte e domosdoshme. Në këtë kuadër, përballë spastrimit etnik të realizuar nga forcat serbe, ndërkohë që lindte nevoja për të “mbrojtur kosovarët shqiptarë dhe për t’i imponuar Beogradit pranimin e kushteve të Rambujesë”¹³, përballë mosrespektimit të kërkesave të bashkësisë ndërkombëtare, NATO-ja, organizatë ndërkombëtare me personalitet juridik të vetin, dha shenjë e goditjeve ajrore mbi territorin e RFJ-së.

Ky konflikt gjeopolitik u përcoll në Gjykatë nëpërmjet ankesës *Bankovia e të tjerë kundër Belgjikës dhe 16 vendeve të tjera*, anëtare të Këshillit të Europës dhe, gjithashtu, anëtare të NATO-s. Ankuesit serbë, të afërm të viktimave, parashtrajnë shkelje të neneve 2 dhe 10 të Konventës, për shkak të bombardimit të Radio-Televizionit serb të Beogradit, gjatë konfliktit në Kosovë. Çështja më delikate për Gjykatën ishte të përcaktonte nëse shtetet, anëtare të NATO-s dhe në të njëjtën kohë shtete Palë të Konventës, mbanin ose jo përgjegjësi për shkeljet e Konventës Europiane kryer mbi këtë territor. Gjykata e shqyrtoi çështjen nën prizmin e nenit 1 të Konventës, pavarësisht nga fakti se vetë ankuesit përmendnin shkeljen e neneve 2 dhe 10 të Konventës. Pasi iu referua punimeve përgatitore dhe traktateve ndërkombëtare, Gjykata vuri në dukje se bombardimi përbënte një akt ekstraterritorial dhe se ankuesit nuk vareshin nga juridiksioni i shteteve mbrojtëse.

Gjykata këmbënguli, gjithashtu, mbi faktin se “Konventa është një traktat

¹³ Po aty.

i shumanshëm veprues... në një kontekst kryesisht rajonal,... nga i cili është e qartë që RFJ nuk ka varësi.”¹⁴ Në këtë kuadër rajonal, Gjykata veproi duke shmangur një zonë “*de non-droit*”, çka mund të çonte drejt idesë se sikur një veprim i tillë të ndërmerrej në “hapësirën europiane,” çështja *Bankovia* kishte gjasë të konsiderohej e pranueshme.

Me gjithë përpjekjet e Gjykatës që KEDNJ-ja të jetë e zbatueshme mbi territorin e krejt palëve kontraktuese, duke pasur mirë parasysh zonat ku është e vështirë të sigurohet zbatimi i saj, vështirësitë nuk mungojnë të shfaqen herë pas here për të përcaktuar përgjegjësit e shkeljeve. Vendosja e sistemit të protektoratit në Kosovë i krijoi kështu probleme Gjykatës Europiane, e cila do ta shohë veten të përballur me ankesa të tjera të përngjashme, po aq të ndjeshme sa edhe e para. Është fjala këtu për çështjen *Behrami e Behrami kundër Francës*, ku ankuesit denoncojnë pakujdesinë e trupave franceze në atë pjesë të Kosovës që ishte vendosur nën autoritetin dhe kontrollin e tyre. Ankuesit parashtrojnë faktin se në origjinë të vdekjes së djalit të tyre ishin trupat franceze, të cilat, nga njëra anë nuk sinjalizuan ekzistencën e një zone me bomba copëtuese të pashpërthyer, lëshuar gjatë bombardimeve të NATO-s dhe, nga ana tjetër, nuk vepruan për çminimin e tyre. Ankuesit përmendin kështu shkeljen e nenit 2 të Konventës dhe denoncojnë mosveprimin e trupave të KFOR-it.

Gjykata e Strasburgut e gjeti me vend të nënvizonte se në këtë çështje duhej parë në radhë të parë nëse ajo vetë kishte kompetencë për të marrë në shqyrtim, në bazë të Konventës, rolin që luanin këto shtete në gjirin e OKB-së, e cila kishte për qëllim të ushtronte kontrollin e saj në Kosovë.

Një çështje e tillë ka të bëjë me papajtueshmërinë *ratione persone* të ankesave që ngrejnë ankuesit lidhur me veprimin dhe mosveprimin që vihet në ngarkim të OKB-së, nëpërmjet misionëve të saj civile e të sigurisë (UNMIK dhe KFOR) në Kosovë. Për Gjykatën, veprimi dhe mosveprimi

¹⁴ Vendimi *Bankovia*, § 80.

në parim i njihen pra “në ngarkim” OKB-së, e cila ka një personalitet juridik të veçantë nga ai i shteteve të saj anëtare dhe nuk është palë kontraktuese e KEDNJ-së.

Gjykata vëren konkretisht se UNMIK-u është një organ në përdorim të OKB-së, krijuar në bazë të kapitullit VII të Kartës, dhe të drejtat e plota që ushtronte KFOR në terren i ishin njohur atij nga Këshilli i Sigurimit në zbatim po të kapitullit VII. Veprimet e tij i takojnë kështu drejtpërdrejt OKB-së si një organizatë me përmasë universale në misionin e saj për të përmbushur një objektiv të domosdoshëm për sigurinë kolektive.

Në këtë çështje, Gjykata, krahas mbështetjes që i jep Kapitullit VII të Kartës, lë të kuptojë nga ana tjetër se ky kapitull duhet të jetë i formuluar qartë dhe mjaft i detajuar, me qëllim që shtetet të mos fshihen për të gjetur strehë për veprimet ose dhe “shkeljet” e tyre prapa OKB-së.

Këto dy çështje përfaqësojnë Në të vërtetë gjendje të tilla kur shtete anëtare, si pjesë e një bashkësie ndërkombëtare më të gjerë, ndërmarrin një proces rindërtimi pas një konflikti të armatosur mbi territoret europiane të pambuluara juridikisht nga KEDNJ-ja. Këto territore duhej të kishin mjetet juridike të nevojshme për të shmangur shndërrimin e tyre në zonë “de non droit” në fushën e të drejtave të njeriut, nën kontrollin e shteteve anëtare.

II. PROCEDURA E ÇËSHTJEVE LIDHUR ME KONFLIKTET GJEOPOLITIKE

1. Hapja e procesit gjyqësor

Ankesat lidhur me konfliktet gjeopolitike mund t’i drejtohen Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut në formë rekursi shtetëror ose individual.

A. Rekursi shtetëror

Neni 33 (neni i vjetër 24) i KEDNJ-së përcakton shprehimisht: “Çdo palë e lartë kontraktuese mund t’i drejtohet Gjykatës për çdo shkelje të dispozitave të Konventës e të protokolleve të saj, për të cilat mendon se ka

faj një palë e lartë kontraktuese tjetër”.

Rekursi shtetëror ishte një ide e madhe e etërve themelues të Konventës që synonin nëpërmjet tij të krijonin një instrument të aftë për të penguar çdo shkarje të shteteve drejt një regjimi totalitar, diktatorial dhe për të garantuar mbrojtjen e sistemit demokratik si faktor paqeje. Për t’ia arritur këtij qëllimi, sistemi parashikonte rekursin ndërshtetëror, qëllimi i të cilit ishte të siguronte nëpërmjet shteteve anëtare kontrollin e funksionimit të mekanizmave mbrojtës.

Shteti që hap proces, në bazë të nenit 33 të Konventës, nuk vepron që të respektohen thjesht të drejtat e tij, por për të parashtruar në Gjykatë një çështje me karakter të përgjithshëm në emër të të gjithëve, në përfitim të çdo individi. Ankesa shtetërore mund të dërgohet kështu në Gjykatë nga një shtet kundër një shteti tjetër, në mungesë të çdo mosmarrëveshjeje midis tyre dhe pa qenë po ashtu shteti ankues viktimë e një shkeljeje të Konventës.

Rekursi ndërshtetëror nuk konsiderohet domosdoshmërisht nga shtetet si një mënyrë e re për të zgjidhur mosmarrëveshjet që ekzistojnë mes tyre. Kështu, për shembull, çështja *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* synonte konkretisht të ndalonte keqtrajtimet e ushtrisë britanike në Irlandën e Veriut dhe jo të ndihmonte për një zgjidhje paqësore të konfliktit mes tyre. Kjo ankesë tregon qartë që edhe kur dy shtete kanë marrëdhënie të ngushta ekonomike e kulturore mes tyre, përsëri ato nuk kanë ngurruar të parashtrojnë në Gjykatën e Strasburgut problemin e të burgosurve dhe të keqtrajtimeve që u bëhen.

Në një fazë të parë, shtetet kanë vënë në përdorim më shumë mekanizmin e rekursit ndërshtetëror. Dhe kjo, për faktin se ankesa shtetërore kishte disa përparësi, konkretisht:

- i. ajo i parashtrohej menjëherë shtetit të paditur, ndërkohë që për një ankesë individuale, shteti i paditur mund të vihej në dijeni vetëm po qe se Komisioni e shihte të arsyeshme;
- ii. ajo zbatohet nga çdo shtet kontraktues, pavarësisht nga fakti që qeveria

e tij mund të mos njihej nga ana e shtetit tjetër. Çështja *Qipro kundër Turqisë* shërben këtu si shembull kuptimplotë: Turqia kundërshtoi Qeverinë Qipriote për të vepruar në cilësinë e saj me pretekstin se kjo e fundit mund të përfaqësonte vetëm palën “greke” të ishullit dhe jo shtetin qipriot, arsyetim që nuk u morë parasysh nga Komisioni;

iii. ajo i drejtohej çdo shteti kontraktues, pavarësisht nga data në të cilën ky ka ratifikuar Konventën. “Komisioni vuri në dukje se zbatimi i nenit 24 (nenit 33 të Konventës) i përkiste çdo shteti kontraktues, cilado qoftë data kur ai ka ratifikuar Konventën”¹⁵. Ky problem u parashtrua edhe në çështjen *Austria kundër Italisë*. Kjo e fundit mbështeste idenë se ishte zotuar vetëm ndaj shteteve që ishin Palë të larta kontraktuese të Konventës, ndërkohë që faktet e përmendura në çështje kishin ndodhur para tre shtatorit 1958, datë kur Austria u bë palë e Konventës;

iv. ajo nuk mund të shpallej e papranueshme për arsye se në thelb është e ngjashme me një çështje shtetërore të mëparshme. Shembulli më i qartë është Qiproja që ka hapur në Gjykatë tre çështje për të demaskuar operacionet ushtarake të kryera nga Turqia në veri të Qipros në korrik dhe gusht 1974, ndarjen e territorit të saj dhe pasojat që rrjedhin. Në vendimin e saj përfundimtar të majit 2001, Gjykata vërejti se Turqia nuk kishte marrë masat e nevojshme për rregullimin e gjendjes dhe se “shkelja e paditur është objekt i një politike të ndjekur që nga viti 1974, dhe si e tillë duhet cilësuar e vazhdueshme”;¹⁶

v. ajo shtronte para organeve europiane të kontrollit një çështje që ka të bëjë me rendin publik europian.¹⁷ Sikurse e thekson Gjykata në vendimin e

¹⁵ Juge Petitti, «Le règlement pacifique des différends internationaux en Europe : perspective de l'avenir », Akademia e së drejtës ndërkombëtare të Hagës, f. 338.

¹⁶ Vendimi *Qipro kundër Turqisë*, 10 maj 2001, f. 46.

¹⁷ Vendimi *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, përmendur nga P. Llambert « Les bénéficiaires du droit de recours », Bruylant (Bruxelles) 1999, f. 26.

saj përfundimtar *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, dhënë më 18 janar 1978, “në dallim nga traktatet ndërkombëtare të tipit klasik, Konventa e tejkalon kuadrin e dyanshmërisë midis shteteve kontraktuese. Përveç një rrjeti zotimesh sinalagmatike të dyanshme, ajo krijon detyrime objektive të cilat, në bazë të tekstit hyrës të saj, përftojnë garanci kolektive. Nëpërmjet nenit 33, ajo u lejon shteteve kontraktuese të kërkojnë respektimin e këtyre detyrimeve, pa qenë nevoja të përligjin ndërhyrjen e tyre si të interesuar për shembull nga fakti që një masë e caktuar që ata padisnin cenon një nga shtetasit e tyre”. Që këtej rrjedh se viktimat e shkeljes së një dispozite të Konventës nuk kanë pse të jenë domosdoshmërisht qytetarë të shtetit ankues.

Në të vërtetë, ankesat ndërshtetërore të paraqitura në Gjykatën e Strasburgut nuk janë të shumta. Që prej krijimit të saj më 1959, Gjykata ka dhënë vendim vetëm për tri çështje shtetërore: *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* (1978), *Danimarka kundër Turqisë* (2000) dhe *Qipro kundër Turqisë* (2001), ndërkohë që ish-Komisioni Europian i të Drejtave të Njeriut ka marrë në shqyrtim shtatëmbëdhjetë ankesa të tjera shtetërore.

Kohët e fundit, në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut u hap proces për një çështje shtetërore: *Gjeorgjia kundër Federatës së Rusisë*. Kjo çështje ka të bëjë me ngjarjet që pasuan arrestimin në Tbilissi të katër oficerëve rusë të dyshuar për spiunazh. Më 4 tetor 2006, këta ushtarakë u liruan për pasojë të qëndrimit të moderuar të vetë Gjeorgjisë. Njëmbëdhjetë qytetarë gjeorgjianë u arrestuan për të njëjtat shkaqe nga autoritetet ruse.

Në përputhje me nenin 51 të rregullores së Gjykatës, kryetari i Gjykatës ia bëri menjëherë të njohur ankesën shtetit mbrojtës dhe çështja vazhdon të jetë në proces shqyrtimi.

B. Rekursi individual

Neni 34 i KEDNJ-së parashikon që “Gjykata mund të pranojë kërkesa nga çdo person fizik, çdo organizatë joqeveritare ose nga çdo grup individësh që pretendon se është viktimë e një shkeljeje nga një palë e lartë kontraktuese

e të drejtave të njohura nga Konventa ose protokollet e saj. Palët e larta kontraktuese zotohen të mos pengojnë në asnjë mënyrë ushtrimin efektiv të kësaj të drejte”. Kjo e drejtë është shndërruar në “gur themeli për mekanizmin e ruajtjes së të drejtave të njeriut vendosur nga KEDNJ”¹⁸ dhe në “mbështetjen kryesore të tij”¹⁹.

Duke filluar nga vitet '70 të shekullit të shkuar, kërkesa individuale, shtylla e Konventës, u bë mekanizmi më i përdorur i saj. Ndonëse i pranuar mjaft me vonesë nga disa shtete, rekursi individual njohu një sukses të madh. Kjo për faktin se shtetet anëtare, në marrëdhëniet e tyre të ngushta në gjirin e Organizatës, privilegjuan rrugën e kompromisit diplomatik në raport me detyrimet e parashtruara në nenet kyçe. Një dukuri i tillë është bërë më i dukshëm që prej ndryshimit historik të vitit 1989, kur vendet e Europës Lindore njohën proceset demokratike dhe u bashkuan me Këshillin e Europës. Anëtarësimi i tyre në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut dhe pranimi që u bënë kompetencave të Gjykatës Europiane përmbysën krejt raportet e vjetra midis kërkesave shtetërore dhe kërkesave individuale dhe bënë që, përballë rekursit individual, përherë e më shumë mbisundues, rekursi shtetërore të humbasë vazhdimisht terren.

Ankesat individuale paraqesin karakteristikat e mëposhtme:

i. Ndryshe nga neni 33 (neni 24 i vjetër) i Konventës që i lejon çdo shteti t'i drejtohet Gjykatës për cilëndo shkelje të dispozitave të Konventës, pa qenë doemos viktimë e shkeljes së një prej neneve të saj, neni 34 parashikon si kusht që ankuesi të jetë viktimë e shkeljes së një prej të drejtave të njohura nga Konventa.

Kështu, në çështjet që kanë të bëjnë me konfliktet gjeopolitike, pikërisht

¹⁸ F. Sudre, *Droit européen et international des droits de l'homme* botimi 7 i ripërpunuar, f. 561.

¹⁹ Vendimi *Mamatkulov dhe Abdurasulovic kundër Turqisë*, 6 shkurt. 2003, § 106.

në çështjen *Chamaiev kundër Gjeorgjisë e Rosisë*, Gjykata e Strasburgut arriti në përfundimin se kishte shkelje të këtij neni, për faktin se ankuesit ishin mbajtur në izolim, pa kontakt me përfaqësuesit e tyre. Nëpërmjet manovrimesh të ndryshme, Rusia kishte kërkuar të pengonte ankesën e tyre në Gjykatë, me pretekstin se vetë të interesuarit nuk kishin dashur të ankoheshin, se “shqyrtimi i kësaj çështjeje ishte i pamundur nga pikëpamja procedurale”, pasi “këta persona nuk kishin paraqitur në Gjykatë asnjë ankesë kundër Rosisë”.

ii. Edhe pse kërkesat paraqiten në Gjykatë nga individë, në bazë të nenit 34 të Konventës, prapa tyre qëndrojnë shtetet kontraktuese, sepse problemi nuk i përket vetëm një individi ose një rasti të izoluar, por një problemi të përgjithshëm që silltet në Gjykatë nëpërmjet një ankese individuale. Ato marrin kështu rëndësinë e një kërkesë shtetërore dhe Gjykata është e detyruar të japë vendimin e saj për çështje shpesh mjaft delikate që lindin midis dy vendesh, duke u bërë kështu zëdhënësja e një çështjeje politike të përcaktuar. Në çështjen *Assanidze*, për shembull, ishin vetë autoritetet qendrore që i propozuan bashkëshortes së ankuesit të hapte proces gjyqësor në Gjykatën Europiane të Drejtave të Njeriut nëpërmjet një ankese drejtuar shtetit gjeorgjian duke vënë në dukje se “...autoritetet e RA të Axharisë bëjnë shkelje flagrante të ligjit dhe të drejtave të njeriut.”²⁰ Ankuesja iu drejtua në këtë mënyrë Gjykatës në bazë të nenit 35 § 3 të Konventës, e mbështetur nga prokuroria e përgjithshme e Gjeorgjisë, Gjykata e lartë e Gjeorgjisë si dhe nga Këshilli i sigurimit kombëtar.

Ka edhe raste kur autoritetet kombëtare i pengojnë ankuesit t’i drejtohen Gjykatës sidomos kur bëhet fjalë për ankues të burgosur. Në raste të tilla Gjykata është treguar e vendosur duke ndëshkuar autoritetet për mosnjohje të nenit 34 të Konventës. Dëshmon për këtë çështja *Ila^ocu*, ku Gjykata dënoi si Moldavinë ashtu dhe Federatën e Rosisë për shkelje të nenit 34 të

²⁰ Vendimi *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, 8 prill 2004, f. 13.

Konventës. Në këtë çështje autoritetet moldave shkuan deri aty sa i propozuan ankueses ta tërhiqte ankesën që kishte depozituar në Gjykatë kundër Moldavisë e Rosisë, në këmbim të një premtimi për të liruar edhe ankuesit e tjerë.

Për të njëjtën çështje, Ministria e Punëve të Jashtme të Federatës së Rosisë u bëri presion autoriteteve moldave, duke u kërkuar të marrin të gjitha masat për të siguruar tërheqjen e dosjes së depozituar në Gjykatën Europiane të të Drejtave të Njeriut në tetor 2000, nën pretekstin se “shqyrtimi i dosjes në fjalë nga Dhoma e Madhe e Gjykatës Europiane ... mund të dëmtojë rëndë interesat e Federatës së Rosisë e të Moldavisë” (*Ila^ocu*, § 278).

C. Ankesa drejtuar kundër një a më shumë shteteve

Çështjet lidhur me konfliktet gjeopolitike mund të drejtohen kundër një, dy a më shumë shteteve. Mund të përmendim si shembull çështjen *Ila^ocu kundër Moldavisë e Rosisë*, ku ankuesit kanë përcaktuar në formularin e ankimit se kërkonin të ankoheshin ndaj të dy shteteve për shkelje të të drejtave të tyre ose për mos marrje masash të nevojshme në këtë drejtim. Me qëllim që të përcaktohej nëse akuzat e formuluar mund t’i drejtoheshin njëkohësisht të dy shteteve mbrojtëse, ishte thelbësore të përcaktohej nëse ankuesit mund të trajtoheshin se “kishin varësi nga juridiksioni i tyre” në kuptimin e nenit 1 të Konventës. Nëse po, shtetet do të cilësoheshin në parim përgjegjëse për shkelje të Konventës. Dhe ndryshe nga çështja *Qipro kundër Turqisë*, për herë të parë në çështjen *Ila^ocu*, shteti – territori i të cilit është i pushtuar dhe nën ndikimin e shteteve të tretë -, u konsiderua si përgjegjës për këtë pushtim.

Në çështjen *Bankovia e të tjerë*, ankuesit denoncojnë bombardimin e Radiotelevizionit serb, (RTS) të Beogradit nga forcat e NATO-s. Kështu 17 shtete u akuzuan për shkelje të nenit 2 (e drejta për jetën), të nenit 10 (e drejta për lirinë e të shprehurit) dhe të nenit 13 (e drejta për një rekurs efektiv).

Ankuesi R. S. mbajtur në paraburgim me urdhër të KFOR-it, paraqet në Gjykatë ankesë më 28 shtator 2001 kundër Francës, Gjermanisë e Norvegjisë. Akuzohen tri shtete, pikërisht sepse urdhrat për paraburgim ishin lëshuar

nga komandantët e KFOR-it.

Ç. Trajtimi i çështjes nga Dhoma e Madhe dhe ndërhyrja e të tretit

Rëndësia politike e çështjeve që trajtojnë konflikte gjeopolitike ka qenë e tillë që sistematikisht ato janë parashtruar për shqyrtim në Dhomë të Madhe. Neni 36 (1) i Konventës përcakton shprehimisht se “Në çdo çështje para një dhome të madhe, një palë e lartë kontraktuese, shtetasi i së cilës është kërkues, ka të drejtë të paraqesë vërejtje me shkrim dhe të marrë pjesë në seancat”. Në ditët tona, ndërhyrja e shteteve të treta është e rrallë dhe Gjykata do të dëshironte që ajo të zhvillohej më tej për të përforcuar më shumë autoritetin e vendimeve.

Ndërhyrja e të tretit që përfaqëson kombësinë e ankuesit, ka për qëllim të mbështesë këtë të fundit. Në çështjen *Ila^ocu*, Qeveria Rumune theksoi, në ndërhyrjen e saj si palë e tretë se nuk dëshiron të mbajë qëndrim lidhur me përgjegjësinë e Moldavisë, por se do të paraqiste prova faktike dhe do të bënte analizë juridike për të mbështetur çështjen e atyre ankuesve që janë shtetas të saj. Kështu, qeveria rumune paraqiti vërejtje që e ndihmuan Gjykatën në shqyrtimin e çështjes, duke qenë se ishin shumë pozitive dhe të dokumentuara më së miri.

Nga ana tjetër, është e rëndësishme të theksohet se shtetet nuk e kanë përdorur shpesh të drejtën e ndërhyrjes si palë e tretë garantuar nga neni 36 (1) i Konventës. Madje, disa shtete kanë kundërshtuar ta përdorin. Ka edhe raste kur kryetari i Gjykatës e ka hedhur poshtë kërkesën për ndërhyrjen e të tretit depozituar në emër të autoriteteve të Republikës Autonome të Axharisë në çështjen *Assanidze kundër Gjeorgjisë*. “Ai theksoi se në parim, në procedurën para Gjykatës, autoritetet e shtetit mbrojtës, duke përfshirë edhe autoritetet vendore, qoftë edhe të pajisura me status autonomie, duhet të jenë të përfaqësuara nga autoritetet qendrore e rrjedhimisht, ndërhyrja e

²¹ Vendimi *Assanidze kundër Gjeorgjisë*, 8 prill 2004, f.3.

tyre në procedurë në cilësinë e palës së tretë, ishte e përjashtuar”.²¹

Nga ana tjetër, larmia e zërave në vendime të kësaj gjinie, si dhe numri e shtjellimi i analizave, dëshmojnë për gjerësinë e mendimeve të shfaqura gjatë vendimmarrjes për këto çështje. Mund të përmendim këtu mendimin pjesërisht disident të gjykatësit european Loucaides lidhur me dënimin e Moldavisë për mosrealizim e detyrimeve të saj pozitive ndaj ankuesve: “...të arrish në përfundimin se ka “juridiksion” ndaj disa personave mbi bazën e Konventës, nisur nga fakti i thjeshtë se qeveria përkatëse nuk ka marrë masat juridike, politike, diplomatike e ekonomike, ose njërën prej këtyre masave të përmendura nga shumica, me qëllim që t’u njihen ankuesve të drejtat e parashtruara në Konventë, ndërkohë që qeveria e përmendur nuk ushtronte një autoritet të vërtetë mbi këta persona, do të thotë të zgjerosh nocionin e “juridiksionit” gjer në absurditet”.²²

2. Hetimi i fakteve

Hetimi i fakteve për çështjet që kanë të bëjnë me konfliktet gjeopolitike është klasik, i zakonitë, me disa veçori, si për shembull misionet hetimore të dërguara në vend dhe dëgjimet e dëshmitarëve, përgjithësisht shumë të frytshme.

Me qëllim që të përcaktohen faktet, Gjykata merr parasysh vëzhgimet dhe provat dokumentuese të shkruara, paraqitur nga palët gjatë procedurave, si dhe dëshmitë gojore për sqarimin e fakteve të përmendura. Në çështjen *Ilascu kundër Moldavisë e kundër Rusisë*, Gjykata bëri në vend një hetim, në Kisinou e Tiraspol, për të hedhur dritë mbi disa çështje të kundërshtuara e, në mënyrë të veçantë, lidhur me përgjegjësinë të Moldavisë dhe/ose të Federatës së Rusisë, përsa i përket shkeljeve të bëra dhe kushteve të mbajtjes në burgim të ankuesve. Ajo i përqendroi hetimet e veta mbi faktet e duhura

²² Vendimi *Ilascu kundër Moldavisë e Rusisë*, 8 korrik 2004, f. 144.

lidhur me përcaktimin e juridiksionit të Moldavisë e të Federatës së Rusisë. Në këtë mision hetimi, selia e misionit të OSBE-së në Moldavi ndihmoi mjaft për organizimin e seancave dëgjimore, duke dëshmuar për bashkëpunim midis Këshillit të Europës dhe OSBE-së.

Në çështjen *Issaieva*, përballë kundërshtimit midis palëve për mënyrën se si kishin ndodhur bombardimet e Katyr-Yourt-it dhe për vetë hetimin e çështjes më pas, Gjykata i kërkoi Qeverisë të paraqiste kopje të tërë dosjes së hetimit të bërë lidhur me bombardimin, si dhe të humbjeve civile që kishin ndodhur. Nga ana tjetër, Gjykata i kërkoi edhe ankueses të paraqiste prova dokumentuese dëgjimore në mbështetje të pohimeve të saj.

Çështja *Qipro kundër Turqisë*, është domethënëse për faktin se Komisioni jo vetëm dërgoi në vend ekspertët e tij për të mbledhur prova konkrete lidhur me kushtet e jetesës së qipriotëve grekë dhe gjendjen e qipriotëve turq që jetonin në veri të Qipros, por ai paraqiti, gjithashtu, si dëshmi, edhe raportet mbi veprimtarinë e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Gjatë procedurës hetimore, Gjykata studioi po ashtu edhe pjesë nga shtypi, mbledhi kaseta video që trajtonin konfliktet, mjaft dokumente publike nga organizata dhe organe ndërkombëtare, si OSBE, KPT, Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës, Komisari i të Drejtave të Njeriut i Këshillit të Europës dhe Këshilli i Bashkimit Ndërparlamentar.

Krejt procedura e hetimit në çështjet që kanë të bëjnë me konfliktet gjeopolitike, mbështetet te neni 38 § 1,a) të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, që parashtron shprehimisht:

“Kur Gjykata deklaron të pranueshme një kërkesë, ajo

a. vazhdon shqyrtimin e çështjes me përfaqësuesit e palëve dhe, kur është rasti, procedon nëpërmjet hetimit për zhvillimin efektiv të të cilit shtetet e interesuara duhet të krijojnë të gjitha lehtësitë e nevojshme; (...)”

Ky nen sanksionon parimin sipas të cilit shtetet kontraktuese duhet të bashkëpunojnë me Gjykatën, çka përben një rëndësi themelore në procedurën

e hetimit të çështjeve (çështja e lartpërmendur *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* e ilustron më së miri një bashkëpunim të tillë).

Mbledhja e fakteve shpesh është e vështirë. Jo gjithmonë qeveritë tregohen të gatshme për të ndihmuar Gjykatën në këtë detyrë delikate. Një gjë e tillë ndodhi konkretisht gjatë misionit të Komisarit të Drejtave të Njeriut të Këshillit të Europës në Transnistri, ku autoritetet vendore nuk e pranuan kërkesën e tij për të verifikuar kushtet e burgimit të Z. Ila^ocu. Edhe vetë Gjykatës iu kundërshtua mundësia për të realizuar një mision hetimor në vend, për të dëgjuar drejtpërdrejt dëshmitarët, sepse autoritetet ruse nuk e pranuan një kërkesë të tillë.

Megjithatë, me ndihmën e palëve, Gjykata arriti të bëjë një hetim në vend lidhur me rrethanat e veçanta të arrestimit, të dënimit e të burgimit të ankuesve. Dëgjoi, gjithashtu, dëshmitarët lidhur me masat e marra nga Moldavia për të arritur lirimin e ankuesve dhe për marrëdhëniet e saj me Federatën e Rusisë dhe Transilvaninë. Nëse Gjykata nuk mundi të dëgjojë tërë dëshmitarët e parashikuar, kjo për faktin se ajo “nuk ka fuqi detyruese për t’i detyruar dëshmitarët të paraqiten para saj”.²³

Në çështjen *Chamaiev*, orvatjet e Gjykatës për të realizuar një mision hetimi në vend dështuan. Gjykata nuk arriti të marrë kontakt të drejtpërdrejtë me katër ankuesit e dëbuar, edhe pse i kishte tërhequr vëmendjen Qeverisë Ruse lidhur me nenin 38 §1 a) të Konventës, duke i kujtuar se “shtetet kontraktuese duhet të krijojnë të gjitha lehtësirat e nevojshme për mbarëvajtjen e frytshme të hetimit dhe se këto lehtësi kanë të bëjnë në radhë të parë me mundësinë që i jepet Gjykatës për të shkuar në vend tek ankuesit, për të cilët ajo ka vendosur se duhet t’i dëgjojë, si dhe në mjediset ku ajo e sheh të nevojshme se duhen vizituar”²⁴ dhe se “...në mungesë të realizimit të misionit,

²³Vendimi *Iliascu kundër Moldavisë e Rusisë*, 8 korrik 2004, f. 7.

²⁴ Vendimi *Chamaiev kundër Gjeorgjisë e Rusisë*, § 496.

²⁵ Ibid. § 46.

...ajo do të hartojë vendimin përfundimtar mbi bazën e elementëve që ajo zotëron”.²⁵

Autoritetet ruse e kundërshtuan takimin e delegacionit të Gjykatës me ankuesit duke deklaruar se “zhvillimi i misionit hetimor nga ana e Gjykatës ishte shkelje e legjislacionit të brendshëm penal...”²⁶; jo vetëm kaq, por e vonuan një vit korrespondencën që përmbante formularin e ankesës.

Së fundi, tërë faktet e mbledhura nga një mision hetimor ose nga një seancë dëgjimi gojore ia kanë lehtësuar punën Gjykatës për të hedhur dritë mbi çështje mjaft delikate. Pasi ka mbledhur faktet, Gjykata ka marrë vendimin mbështetur në jurisprudencën e saj, ndonjëherë mjaft komplekse në rrafshin ndërkombëtar për një kontekst politik delikat.

III. Ndihmesa që ka sjellë jurisprudenca e Gjykatës për konfliktet gjeopolitike në evolucionin e nocioneve juridike

1. Referimi i së drejtës ndërkombëtare

Së pari, le të shohim rastet se kur Gjykata i është referuar së drejtës ndërkombëtare për marrjen e vendimeve të saj.

E drejta europiane dhe e drejta ndërkombëtare për të drejtat e njeriut bëjnë pjesë në të drejtën ndërkombëtare. Siç e thekson me të drejtë dekani G. Cohen-Jonathan “sistemi mbrojtës i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut e bazon forcën e vet juridike në të drejtën ndërkombëtare të përbashkët. Është pikërisht kjo e drejtë që përcakton rregulla të shumta, qoftë për autoritetin e vet në të drejtën e brendshme, qoftë për procedurën ndërkombëtare zbatuese, madje në ndonjë rast edhe për përmbajtjen normative të të drejtave të garantuara.”²⁷ Ky raport i ngushtë midis Konventës

²⁶ Ibid. § 31.

²⁷ G. Cohen Jonathan, *Cour européenne des Droits de l'Homme et droit international général*, AFDI 1999, f. 767.

Europiane nga njëra anë dhe së drejtës ndërkombëtare nga ana tjetër, në fushën e të drejtave të njeriut, e ka shtyrë të njëjtin autor të pohojë më pas se “Rendi lidhës i të drejtave të njeriut është e drejta ndërkombëtare: kjo e drejtë është “një” dhe e drejta ndërkombëtare është e drejta e përbashkët”.²⁸

Me internacionalizimin e të drejtave të njeriut, këto të drejta nuk kanë të bëjnë më vetëm me shtetet sovrane, por edhe me çdo individ në cilësinë e tij si subjekt i së drejtës ndërkombëtare dhe që ndodhet nën juridiksionin e shtetit të akuzuar. Në këtë aspekt, Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut i detyron shtetet të respektojnë standardet e përcaktuara ndaj shtetasve të tyre. Në këtë fushë, referimi që i bëhet të drejtës ndërkombëtare ndihmon për përmirësimin e mbrojtjes së të drejtave individuale.

A. Referimi tek e drejta ndërkombëtare për nocionin e juridiksionit

Jurisprudenca e Gjykatës Europiane po i referohet të drejtës ndërkombëtare gjithnjë e më shpesh. Në të vërtetë, Gjykata ka theksuar gjithmonë se Konventa Europiane përfshihet në kuadrin e së drejtës ndërkombëtare dhe se “ajo duhet interpretuar nën dritën e parimeve të parashtruara nga Konventa e Vjenës lidhur me të drejtën e traktateve”, në mënyrë të veçantë të parimit sipas të cilit “duhet mbajtur parasysh çdo rregull i së drejtës ndërkombëtare të zbatueshme në marrëdhëniet midis palëve”²⁹. Duke u mbështetur në këtë parim, si dhe në punimet e Komisionit të së Drejtës ndërkombëtare, Gjykata do të pranonte të figurojnë në nenin 1 të Konventës³⁰ interpretimi “kryesisht territoriale” i nocionit të “juridiksionit”. Vendimi *Bankovic* (12 dhjetor 2001) është shumë i rëndësishëm në këtë aspekt dhe “mbahet si një precedent”³¹, duke qenë se në çështjet e shqyrtuara më pas,

²⁸ Po aty, AFDI 2003, f. 663.

²⁹ *Vendimi Al-Adsani kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 21 nëntor 2001, §55.

³⁰ *Vendimi Bankovic*, §§ 55 dhe 61.

³¹ G. C-Jonathan, *Protection internationale des droits de l'homme*, AFDI 2002, f. 675.

Gjykata e Strasburgut i referohet nocionit të juridiksionit që përmban pikërisht ky vendim, çka pasqyron konceptin territorial të këtij nocioni në të drejtën ndërkombëtare. Përdorimi i së drejtës ndërkombëtare në këtë çështje priret drejt kufizimit të karakterit të veçantë të mbrojtjes të të drejtave të njeriut. Kësisoj, “Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut i ka përcaktuar qartë kufijtë e shtrirjes ekstraterritoriale të juridiksionit mbi bazën e nenit 1”.³²

B. Për autoritetin e vendimeve përfundimtare

Një tjetër fushë, në të cilën Gjykata e Strasburgut frymëzohet nga e drejta ndërkombëtare, është autoriteti i vendimeve të saj, dhe e vërteta është që në jurisprudencën e vet, Gjykata i referohet përherë e më shumë së drejtës ndërkombëtare. Edhe pse ka ruajtur një konceptim kryesisht deklarativ për vendimet që merr (kur shpall për shembull se *ka shkelje të Konventës*), ajo përsëri i jep shtetit mundësinë të zgjedhë mjetet e nevojshme për të ndrequr sistemin juridik të brendshëm, me qëllim që të përmbushë detyrimet që rrjedhin nga neni 46³³ i Konventës, duke e nxitur t’i përmbahet vendimit të Gjykatës. Një gjë e tillë lejon rezerva të përcaktuara vetëm për sa i përket ankesave lidhur me kthimin e pronës. Në këtë pikë, për disa çështje që kanë të bëjnë me marrjen e pronës, Gjykata ka deklaruar në diapozitivin e vendimeve të veta se shteti *duhet* t’ua kthejë pronat ankuesve. Por *restitutio in integrum*, kjo kategori çështjesh nuk është e detyrueshme veçse brenda kufijve të së mundurës. Në rast pamundësie, detyrimi për kthim prone zëvendësohet me detyrimin për të paguar në të holla barasvlerën e pronës.

Në fushën e autoritetit të vendimeve përfundimtare, vetë lirimi i Z.

³² J.P. Costa, *Qui relève de la juridiction de quel Etat au sens de l'article 1^{er} de la Convention européenne des Droits de l'Homme ?*, in “Mélanges en hommages au doyen Cohen-Jonathan - Libertés, Justice, Tolérance”, Bruylant, Vol. I, f. 492.

³³ Neni i vjetër 53 i Konventës.

Assanidze dy ditë pas dhënies së vendimit të Gjykatës Europiane përbën, siç deklaroi ish-Kryetari i Gjykatës Z. Wildhaber, “një shembull të shkëlqyer që dëshmon në të njëjtën kohë për efektshmërinë e mbrojtjes të të drejtave të njeriut siguruar nga Konventa dhe për rëndësinë konkrete të zbatimit të vendimeve të Gjykatës”.³⁴

Për herë të parë, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut bëri një hap “të kënaqshëm e logjik,”³⁵ duke vendosur në vetë dispozitivin e vendimit të saj përfundimtar detyrimin e shtetit për marrje masash, me qëllim që t’i jepte fund mbajtjes në burg të ankuesit, duke vendosur njëzëri që “shteti mbrojtës duhet të sigurojë lirinë e ankuesit në afate sa më të shpejta.”³⁶

Po ashtu, çështja *Assanidze kundër Gjeorgjisë* (prill 2004) shënon një qëndrim të ri të Gjykatës së Strasburgut. Mbajtja në burgim, pa asnjë bazë ligjore, e ankuesit, të cilit i ishte njohur pafajësia nëpërmjet një gjykimi përfundimtar të bërë para tre vjetësh, kërkoi qëndrimin e vendosur të Gjykatës, e cila e vlerësoi si të palogjikshëm faktin që t’i lihej Gjeorgjisë në dorë për zgjedhjen e mjeteve juridike, ndërkohë që mënyra e vetme për t’i dhënë fund një mbajtjeje të tillë arbitrare në burg ishte lirimi i menjëhershëm i të burgosurit. Gjykata nuk ngurroi t’i vërë në dukje Qeverisë së shtetit mbrojtës, në vetë dispozitivin e vendimit përfundimtar, se duhej që ajo (Gjykata) të sigurohej se ankuesit do të liroheshin brenda afateve sa më të shpejta. Kemi të bëjmë edhe këtu me një ndihmesë të konsiderueshme e të dukshme të Gjykatës Europiane që vërteton pa mëdyshje “ndërveprimin midis juridiksioneve ndërkombëtare”³⁷ lidhur me të drejtat e njeriut pikërisht në çështjet që kanë të bëjnë me konfliktet gjeopolitike. Nëpërmjet këtij vendimi,

³⁴ L. Wildhaber, Fjalim i mbajtur me rastin e çeljes së vitit gjyqësor të Gjykatës Europiane, 21 janar 2005.

³⁵ *Vendimi Assanidze kundër Gjeorgjisë*, 8 prill 2004, opinion pjesërisht pajtues i gjyqtarit J-P.Costa.

³⁶ Ibid. f. 51.

³⁷ G. Cohen-Jonathan, *CEDH et droit international*, AFDI 2003, f. 665.

Gjykata bëri një hap të dytë drejt forcimit të autoritetit të vendimeve të saj, duke hyrë kështu në një etapë të re, drejt vendimesh me karakter të detyrueshëm.

Kjo çështje u bë shembull që do të ndiqet më pas në krejt jurisprudencën e Gjykatës. Kështu, në çështjen *Ilaşcu kundër Moldavisë dhe Federatës së Rusisë* (vendimi përfundimtar i 8 korrikut 2004), Gjykata shpreh qartë dhe prerë detyrimin e shteteve mbrojtëse për të liruar ankuesit. Edhe pse toni është disi i ndryshëm, detyrimi është po aq i qartë: “Shtetet mbrojtëse duhet të marrin të gjitha masat e nevojshme për t’i dhënë fund mbajtjes arbitrare të ankuesve që vazhdojnë të jenë ende të burgosur dhe të sigurojnë lirin e tyre të menjëhershëm.”³⁸

Megjithatë, duhet theksuar këtu se shpesh herë ekzekutimi i vendimeve të dhëna nga Gjykata europiane pengohet nga autoritetet kombëtare. Kështu, dy ankuesit ZZ. Ivantoc dhe Popa të çështjes *Iliia^ocu* u liruan vetëm më 2 dhe 4 qershor 2007, kur kishte përfunduar në të vërtetë afati i dënimit të tyre. Kjo përbënte një arsye të dytë që ata t’i drejtoheshin me një ankesë të re Gjykatës kundër Moldavisë dhe Federatës së Rusisë, shtete që zgjatën arbitrarisht mbajtjen e tyre në burgim.³⁹

Një element i ri dhe shumë i rëndësishëm për t’u vlerësuar në këto çështje është fakti se Gjykata vlerëson që është në të drejtën e saj t’u kërkojë shteteve mbrojtëse të marrin të gjitha masat e nevojshme për t’i dhënë fund shkeljeve të paligjshme, burim i ankesave të përsëritura.

Vendimet e mësipërme dëshmojnë për faktin që vetë natyra e të drejtave shkakton tashmë të njëjtat reagime juridiksionale në përkrahje të “individëve ose “të të drejtave më themelore të njeriut”. Sepse pikërisht në dy vendimet e mësipërme, Gjykata vërejti shkelje flagrante të neneve 2 dhe 3 të Konventës, nene që përbëjnë në të vërtetë bërthamën e saj kryesore. Është kjo arsyeja që

³⁸ *Vendimi Ilaşcu kundër Moldavisë e Rusisë*, 8 korrik 2004, f. 119.

³⁹ Rezolutë e përkohshme CM/ResDH (2007), 106.

Gjykata nuk mund t'i lejojë autoritetet kombëtare t'i konsiderojnë shkelje të tilla si shkelje të çfarëdoshme të të drejtave të njeriut. Ka rregulla e detyrime të tilla, për t'u respektuar, për të cilat Gjykata tregohet tepër e vendosur dhe e prerë.

2. *Ndihmesa e jurisprudencës së Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut lidhur me konfliktet gjeopolitike në çuarjen përpara të nocioneve juridike.*

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut frymëzohet nga e drejta ndërkombëtare dhe “e bazon vlefshmërinë dhe forcën e saj juridike në të drejtën ndërkombëtare të përbashkët”, duke ruajtur njëkohësisht njëfarë autonomie për t'u garantuar drejtpërdrejt të gjithë individëve një mbrojtje të efektshme të të drejtave dhe duke luajtur kështu një “rol kyç”⁴⁰ e aktiv në zhvillimin e nocioneve juridike.

A. *Lidhur me rezervat*

Shprehja më tipike e autonomisë së KEDNJ-së shfaqet në terrenin e rezervave që depozitojnë Shtetet në çastin e ratifikimit të Konventës, si dhe në pasojat që shkaktojnë këto rezerva për mbajtjen e zotimeve të marra nga ana e tyre. Edhe pse shtetet kanë të drejtën të depozitojnë rezerva ndaj Konventës, përsëri ka pasur raste kur Gjykata Europiane i ka zhvleftësuar ato rezerva të cilat nuk i dukeshin të pranueshme ose në përputhje me Konventën. Në çështjen *Loizidu*, për shembull, pasi shqyrtoi rezervat territoriale të Turqisë, Gjykata i konsideroi ato të pavlefshme dhe vlerësoi se këto rezerva binin ndesh me aktin themeltar.⁴¹ Ajo deklaroi se mospranimi i rezervave nuk cenonte aspak angazhimin fillestar të shteteve nën akuzë dhe rrjedhimisht bëri kontrollin e vet. “Ndonëse ky qëndrim i Gjykatës u pa me sy

⁴⁰L. Wildhaber, «E drejta ndërkombëtare në Europë : midis traditës dhe së resë», Fjala në Konferencën përurimore të «shoqërisë europiane të së drejtës ndërkombëtare», Firenze, 14 maj 2004.

⁴¹*Loizidou*, (exc.Prel.) §§ 96/98.

⁴²C.C.P.R./C/Rev.1/Add.6(11 nëntor 1994), cituar nga L. Wildhaber.

kritik, kjo nuk e pengoi Komitetin e të drejtave të njeriut të Kombeve të Bashkuara të frymëzohej prej tij, duke mbajtur të njëjtin qëndrim pak kohë më pas”.⁴² Nën shembullin e Gjykatës Europiane, ky Komitet e zhvleftësoi rezervën e paraqitur nga Trinidadit dhe deklaroi se “zhvleftësimi i rezervave nuk pengon aspak pranimin e kompetencës së organit të kontrollit”. Një qëndrim i tillë është frymëzuar drejtpërdrejt nga jurisprudenca e Gjykatës së Strasburgut.

Edhe pse referimi i së drejtës ndërkombëtare në jurisprudencën e Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut duket i shpeshtë, ai sigurisht që ka kufizimet e veta. Gjykata zbaton një traktat ndërkombëtar vetëm nëse ai nuk arrin të përbëjë shkelje të Konventës. Kështu, në vendimin e saj përfundimtar të çështjes *Slivenko e të tjerë kundër Letonisë*, në tetor 2003, duke qenë se bëhej fjalë për raportet midis Konventës Europiane dhe traktateve të tjera të përfunduara midis shteteve palë, Gjykata vlerësoi se largimi nga Letonia i dy ankueseve (nënë e bijë) nuk ishte i nevojshëm në një shoqëri demokratike, në bazë të kriterëve të KEDNJ-së, megjithëse përfshihej në kuadrin e një marrëveshjeje dypalëshe midis Letonisë e Ruisë lidhur me tërheqjen e forcave të armatosura ruse për zhdukjen e pasojave të dominimit të Letonisë nga ish-BRSS. Ajo vërjeti se “autoritetet letone e kanë tejkaluar kuadrin vlerësues që gëzojnë shtetet kontraktuese në një fushë të tillë dhe se ato nuk kanë ruajtur një baraspeshë të drejtë midis qëllimit të ligjshëm që përbën mbrojtja e sigurisë kombëtare dhe interesi i ankueseve.”⁴³ Gjykata arriti kështu në përfundimin se kishte shkelje të nenit 8 të Konventës. Duke qenë se në çastin e ratifikimit të Konventës, Letonia kishte depozituar një rezervë vetëm për sa i përket nenit 1 të Protokollit 1, por asnjë rezervë lidhur me marrëveshjen ruso-letone, kjo palë kontraktuese mbetej e zotuar ndaj nenit 1 të Konventës, çka do të thotë se çdo ligj lidhur me territorin e saj është në pajtim me Konventën.

E njëjta gjë edhe në çështjen *Ilasku e të tjerë kundër Moldavisë e Ruisë*. Instrumenti i ratifikimit të Konventës depozituar nga Republika e

⁴³ *Vendimi Slivenko kundër Letonisë*, 9 tetor 2003, § 128.

Moldavisë pranë Këshillit të Europës në shtator 1997 përmbante shumë deklarata e rezerva që parashikonin se “Republika e Moldavisë deklaroi se nuk mund të sigurojë respektimin e dispozitave të Konventës për mungesat ose aktet e kryera nga organet e Republikës së vetëshpallur të Transnistriës mbi territorin e kontrolluar efektivisht nga organet e saj, deri në zgjidhjen përfundimtare të konfliktit në rajon(...)”.

Për Gjykatën, deklarata të tilla që kufizojnë juridiksionin territorial të një shteti shtrojnë probleme serioze juridike, duke krijuar zbrazëti juridike në sistemin europian të mbrojtjes të së drejtave të njeriut. Ajo nuk i përziën ato me rezervat dhe rikujton se neni 57 i Konventës nuk lejon rezerva të karakterit të përgjithshëm. Gjykata mbajti kështu një qëndrim të tillë që i lejoi të shprehej se deklarata e Moldavisë “...ka një karakter të përgjithshëm, të pakufizuar lidhur me dispozitat e Konventës, por të kufizuar në hapësirë e në kohë, efekti i së cilës do të ishte zhveshja tërësisht, dhe për një periudhë të pakufizuar, e personave, që gjenden në këto “territore”, nga mbrojtja e Konventës”.

Me një fjalë, për Gjykatën, rezervat e shteteve kontraktuese që do të synonin në mënyrë të përgjithshme të kufizonin juridiksionin e tyre territorial nuk do mund të konsideroheshin të vlefshme. Në vendimin e saj për pranueshmërinë e ankesës, Gjykata vlerësoi se deklarata e paraqitur nga Moldavia në instrumentin e saj ratifikues të Konventës, lidhur me pamundësinë për të siguruar respektimin e dispozitave të Konventës për sa i përket pjesës së territorit të saj që kontrollohej nga “republika e vetëshpallur transnistriane”, nuk përbënte një rezervë të vlefshme në kuptimin e nenit 57 të Konventës.

B. Lidhur me nocionin e juridiksionit

“Jurisprudenca e Gjykatës Europiane, nënvizon Prof. Cohen-Jonathan, është mjaft e saktë dhe shembullore për të shërbyer si model për juridiksionet

⁴⁴ G. Cohen-Jonathan, « Cour européenne des Droits de l’Homme et Droit International », AFDI 2003, f. 664.

e tjera, si dhe për të marrë pjesë fuqimisht në përcaktimin e parimeve të përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare në fushën e mbrojtjes të të drejtave të njeriut.”⁴⁴ Në këtë aspekt, evolucioni i nocionit të juridiksionit në jurisprudencën e Gjykatës Europiane lidhur me konfliktet gjeopolitike bie dukshëm në sy.

Veç territorit shtetëror, kompetenca e territorit përfshin, gjithashtu, çdo hapësirë që gjendet nën “kontrollin e përgjithshëm” të një shteti të vënë nën akuzë (*Loizidu kundër Turqisë* (përfjashtime paraprake), 23 mars 1995). Në këtë dokument, termi “juridiksion” merr kuptimin e “autoritetit”, çka do të thotë se vihen nën akuzë jo vetëm aktet e kryera mbi territor, por edhe vetë “kompetencat”⁴⁵ e palës së paditur. Gjykata vlerësoi se vetëm Turqia ushtronte në praktikë “një kontroll të përgjithshëm” mbi territorin e Republikës Turke të Qipros së Veriut (RTCN)⁴⁶ dhe se pikërisht Turqia duhej të siguronte respektimin e tërësisë të të drejtave të parashtruara në Konventë.

Nocioni i “juridiksionit” për territoret nën pushtim zhvillohet edhe më shumë në çështjen *Qipro kundër Turqisë* (25781/94), ku qëndrimi i Gjykatës është më se i qartë: “...duke qenë se Turqia ushtron në praktikë një kontroll tërësor mbi Veriun e Qipros, përgjegjësia e saj nuk mund të kufizohet vetëm në aktet e kryera nga ushtarët ose funksionarët e saj në këtë zonë, por shtrihet edhe më tej në akte të tjera...”⁴⁷

Siç është vënë tashmë në dukje, konkretisht në çështjen *Bankovia*, Gjykata Europiane u frymëzua nga e drejta ndërkombëtare për t’iu përmbajtur pranimit të shprehjes “kryesisht territoriale” të nocionit të “juridiksionit”. Për të arritur në këtë konkluzion, Gjykata konsultoi, midis të tjerave, punimet

⁴⁵ Ibid. F. 769.

⁴⁶ Benoît-Rohmer. « Pour la construction d’un espace juridique européenne de protection des droits de l’homme », *L’Europe des Libertés*.

⁴⁷ *Qipro kundër Turqisë*, vendim përfundimtar i 2001, § 77.

përgatitore, ku termat “banues mbi një territor” u zëvendësuan nga shprehja “në varësi të juridiksionit të tyre”, me qëllim që çdo person që ndodhet në territorin e shteteve nënshkruese të mund të përfitojë nga Konventa.

Në këtë vendim, Gjykata hartoi, gjithashtu, nën dritën e zgjidhjeve sanksionuar nga e drejta ndërkombëtare e përgjithshme, një listë “të akteve ekstraterritoriale të njohura si të analizuara rast pas rasti nga shteti përkatës i juridiksionit që i ka mbuluar.”⁴⁸ Ky vendim do të shërbejë si paraprirës për shqyrtimet e mëpasshme.

Në çështjen *Asanidze kundër Gjeorgjisë* (8 prill 2004), Gjykata rikujtoi se Gjeorgjia ka ratifikuar Konventën pa depozituar asnjë rezervë lidhur me RA të Axharisë. Me gjithë mosfunksionimin e disa mekanizmave shtetërore në Gjeorgji dhe ekzistencën e territoreve me status të veçantë, RA e Axharisë i nënshtrohet juridikisht kontrollit të shtetit gjeorgjian dhe ky i fundit merr përgjegjësinë e plotë ndërkombëtare për të krijuar një sistem shtetëror që garanton respektimin e Konventës në krejt territorin e tij për sa i përket çdo individ.

Gjykata vëren se autoritetet qendrore kanë bërë të gjitha përpjekjet e mundshme për të arritur lirin e ankuesit (*Asanidze* §145). Në të kundërt, ajo vlerëson që edhe pse “për sa i përket fakteve, përgjegjësia i takon drejtpërdrejt RA të Axharisë, përsëri, në bazë të Konventës, përgjegjësia nuk i njihet veçse shtetit gjeorgjian.” Sipas saj, “‘janë pikërisht autoritetet e larta që, në bazë të Konventës, mbajnë përgjegjësinë objektive lidhur me qëndrimet e vartësve të tyre’ (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 159). Me fjalë të tjera, “shtetet palë përgjigjen për të gjitha aktet...që ndodhin në territorin e tyre, qoftë edhe kur kryhen nga një regjim rebel ose separatist”.

Lidhur me çështjen *Ilasku*, Gjykata njeht se ka përgjegjësi edhe Moldavia,

⁴⁸ *Vendimi Bankovic*, f. 18.

për sa i përket një territori ku ajo e ka të pamundur ta kontrollojë. Duke mos dashur të ngushtojë juridiksionin territorial të Moldavisë, Gjykata përcakton se, megjithëse Qeveria Moldave nuk ushtron autoritet mbi rajonin e Transnistrisë, “ajo, nëpërmjet detyrimit pozitiv, e ka për detyrë, në bazë të nenit 1 të Konventës, të marrë masat që varen prej saj dhe që janë në përputhje me të drejtën ndërkombëtare – pavarësisht nga rendi diplomatik, ekonomik, juridik e të tjerë – me qëllim që të sigurojë në interes të ankuesve respektimin e të drejtave të garantuara nga Konventa”⁴⁹. Theksojmë, megjithatë, që kjo përgjegjësi e Moldavisë nuk është e drejtpërdrejtë, sepse shkeljet e denoncuara nuk janë bërë prej organeve të saj, por nga një regjim rebel, i mbështetur nga një shtet tjetër palë.

Siç e ka nënvizuar me të drejtë Znj. Benoit Rohmer: “Zgjidhjet e arritura nga Gjykata në çështjen *Ilasku* ndihmojnë në krijimin e një hapësire europiane të mbrojtjes të së drejtave të njeriut, ndërthurur me detyrime – pozitive ose negative – të shteteve kontraktuese, në të cilën asnjë zbrazëti jurideik nuk mund të vërehet”⁵⁰.

Në vendimet përfundimtare të çështjeve *Asanidze* dhe *Ilasku*, koncepti territorial i juridiksionit merr një rëndësi të ndryshme nga ai i çështjes *Bankoviæ*. Nëse në këtë të fundit përcaktohen kufijtë e shtrirjes extraterritoriale të Konventës, çështjet *Asanidze* dhe *Ilasku* “e shohin të lidhur nocionin e sovranitetit territorial me nocionin e juridiksionit, pikërisht për të pasqyruar një dyshim përgjegjësie të shteteve lidhur me shkeljet e bëra në territorin e tyre.”⁵⁰

Vlen të përmendim këtu edhe fjalët e ish-Kryetarit të Gjykatës

⁴⁹ *Vendimi përfundimtar Iliascu kundër Moldavisë e Rusisë*, §331.

* *L'Europe des libertés...*, artikull i cituar.

⁵⁰ F. Krenc, « La peur du vide : «la juridiction» des Etats parties à la Convention européenne des droits de l'homme », *Périodique Journal des tribunaux-droit européen*, n° 120, (juin 2005), f. 170.

Z. Wildhaber për natyrën e sovranitetit dhe raportin e tij me të drejtën: “Në të vërtetë, nuk mund pranojmë më përkufizimin që i ka bërë sovranitetit Jean Bodin, i cili e përshkruante si “*summa in cives ac subditos legibusque soluta potestas*”. Një sovranitet që i dhënka shtetit ndaj individëve fuqi absolute të ligjit, pa respekt për ligjin, pa kontroll gjyqësor (?). Një nocion të tillë nuk kam se si ta pranoj. Përkundrazi, siç thoshte Pierre-Henri Teitgen, një nga etrit themelues të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, “sovraniteti duhet kuptuar si i nënshtruar ndaj së drejtës.”⁵¹

Ndihmesa e jurisprudencës së Gjykatës së Strasburgut lidhur me konfliktet gjeopolitike shfaqet, gjithashtu, edhe në fusha të tjera zbatuese të nocioneve juridike:

C. Lidhur me përcaktimin e nocionit “keqtrajtim”

E shohim konkretisht këtë ndihmesë sidomos nëpërmjet nocionit të ndalimit të torturës, të ndëshkimeve ose trajtimeve çnjerëzore a poshtëruese.

Gjykata i ka sistemuar parimet lidhur me rëndësinë e ndalimit të torturës duke përcaktuar qartë se çfarë do të konsiderohet keqtrajtim dhe, nëpërmjet një përpjekjeje të guximshme, vetë kushtet e burgimit të të dënuarve i sheh të lidhura me respektimin e nenit 3 të Konventës⁵².

Tre konceptet e parashtruara në nenin 3 të Konventës, Gjykata i sheh të lidhura me këto dy kritere:

i. kriteri i intensitetit të vuajtjeve që u bëhen viktimave, i cili lejon të bëhet dallimi midis llojeve të “trajtimeve” që kanë lidhje me nenin 3, çka sjell edhe diferencim të fushës zbatuese të vetë koncepteve – torturë, trajtim çnjerëzor,

⁵¹ Asembleja konsultative, seanca 8 e 19 gushtit 1949 (Pierre-Henri Teitgen), përmendur nga M. L. Wildhaber « Le droit international en Europe : entre tradition et renouveau », Firenze 2004, f. 2.

⁵² F. Sudre, *Vepër e cituar*, f. 283.

trajtim poshtërues. Kështu, në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, torturë njihet çdo “trajtim çnjerëzor i qëllimshëm, që shkakton vuajtje tepër të rënda e mizore” (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, 18 janar 1978, § 167).

ii. kriteri i vlerësimit relativ i ashpërsisë së keqtrajtimit, i cili lejon të bëhet një përcaktim *in concerto* i keqtrajtimit të bërë. Vërejmë se ky vlerësim varet nga “tërësia e të dhënave të shkakut, konkretisht nga zgjatja e keqtrajtimit dhe e pasojave fizike ose mendore, si dhe shpesh nga seksi, mosha, gjendja shëndetësore e viktimës etj. (*Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, § 162). Një këndvështrim i tillë i çështjes bën që gjykatësi evropian të përcaktojë si trajtime “çnjerëzore” ose “çnjerëzore e poshtëruese” keqtrajtimet që u bëhen personave të cilët i nënshtrohen autoritetit të funksionarëve shtetërorë (polici, forca të armatosura, personel i burgjeve) kur akti është i organizuar dhe i përgjigjet një plani të caktuar. Kështu, në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar* “pesë teknikat” pyetësore “të thelluara” përdorur nga forcat e armatosura britanike në Irlandën e Veriut janë cilësuar si çnjerëzore e poshtëruese (§ 67 dhe 159).

Përmendim, gjithashtu, çështjen *Chamaiev e të tjerë kundër Gjeorgjisë e Rusisë*, e cila vë më së miri në dukje mënyrën e dhunshme të marrjes së vetë vendimit të ekstradimit. Ankuesit nuk ishin vënë në dijeni për ekstradimin e tyre të menjëhershëm. Vetëm nëpërmjet lajmeve televizive morën vesh “ekstradimin e menjëhershëm të *disa* çëqenëve drejt Rusisë”, pa qenë të njoftuar më parë nga autoritetet se bëhej fjalë konkretisht për ata vetë .

Evakuimi i tyre u realizua gjatë natës dhe në dhunën më të ashpër, sipas një taktike “mashtrimi e ngutjeje”, me “argumente” të rreme, “arsye” të sajua, që çuan në plagosje dhe mungesë ndihme mjekësore, çka solli me

⁵³ *Vendimi përfundimtar Chamaiev kundër Gjeorgjisë e Rusisë*, 12 tetor 2005, §§ 378 e 385.

një fjalë “vuajtje fizike e morale, që përbëjnë në vetvete trajtim çnjerëzor.”⁵³

Ç. Lidhur me të drejtën për kushte gjatë mbajtjes në burgim

Jurisprudenca e Gjykatës ka dhënë ndihmesën e vet edhe për sa i përket të drejtës për të pasur kushte të tilla burgimi të cilat duhet të jenë në përputhje me dinjitetin njerëzor.

Në çështjen *Irlanda kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Gjykata kishte vlerësuar se mbajtja në “korridorin e vdekjes” ishte e ndjeshme për t’u trajtuar si një akt që binte ndesh me nenin 3 të Konventës, duke pasur parasysh gjendjen vetjake të të dënuarit. Në çështjen *Ilasku e të tjerë kundër Moldavisë e Ruisë* (Dhomë e Madhe, 8 korrik 2004), frymëzuar nga vendimi *Soering kundër Gjermanisë*, Gjykata theksoi se ankthi i gjithëfuqishëm i ekzekutimit të ndëshkimit kapital, që ndiejnë te dënuarit gjatë një periudhe të gjatë kombinohet me kushtet e ruajtjes në korridorin e vdekjes (regjim i ashpër izolimi, qeli pa ngrohje, mungesë ndihme mjekësore, pushtet arbitrar i autoriteteve të burgut) dhe përbën trajtim “veçanërisht të rëndë e mizor që meriton të cilësohet torturë.⁵⁴ Dënimi i ankuesit me ndëshkim kapital kombinuar me kushtet në të cilat ai ka jetuar gjatë burgimit marrin një karakter veçanërisht të rëndë e mizor dhe duhen konsideruar si akte torture në kuptimin e nenit 3 të Konventës.

D. Lidhur me të drejtën për liri e siguri

Organet e kontrollit janë të mendimit se e drejta për liri e siguri nuk synon vetëm rastet e heqjes zyrtare të lirisë, por edhe rastet e zhdukjeve të paqëllimshme që “përbëjnë shkelje veçanërisht të rënda të kësaj së drejte (*Qipro kundër Turqisë*, 10 maj 2001, RTDH, 2002, 807 vëzhg. P.Tavernier). Në vendimin e saj përfundimtar për këtë çështje, Gjykata vërejtë se “kishte shkelje të vazhdueshme të nenit 5 të Konventës, duke qenë se autoritetet e

⁵⁴ *Vendimi përfundimtar Iliascu e të tjerë kundër Moldavisë e Ruisë*, §440.

shtetit mbrojtës nuk kishin ndërmarrë hetim të efektshëm për fatin e qipriotëve grekë të zhdukur, për të cilët thuhej se, me qëllim të garantohej mbrojtja e tyre, ishin nën ruajtje të autoritetit të Turqisë në çastin e zhdukjes së tyre, dhe në vendin ku ndodheshin”. (*Qipro kundër Turqisë*, § 150).

Dh. Lidhur me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale

Në vendimin e saj *Asanidze kundër Gjeorgjisë* (Dhomë e Madhe, 8 prill 2004), Gjykata vlerësoi se e drejta për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore ka të bëjë edhe me procedurën penale. Mosekzekutimi (për një periudhë mbi trevjeçare) i një vendimi për pafajësi i bën utopike garancitë që jep neni 6, kur një personi i është njohur pafajësia gjatë procesit kundër tij, çka zhvesh nga çdo efekt i dobishëm dispozitat e nenit 6 §1.

Si përfundim, mund të themi se pavarësisht nga zbrazëtië, sistemi evropian mbetet aktualisht një sistem pionier dhe shembullor që paraqet një bilanc objektiv e të pavarur të fakteve e të përgjegjësisve, duke u dhënë kështu shpresë viktimave të shkeljeve të Konventës, duke ringjallur opinionet publike dhe duke përshpejtuar reformat juridiksionale në shtetet anëtare të Këshillit të Europës.

Gjykata në politikë

Gustavo Zagrebelsky

Përktheu: Diana Estrefi

Titulli i kësaj teme – që dëshiroj t’ia kushtoj Gjykatës dhe gjyqtarëve me të cilët kam pasur privilegjin të punoj për 9 vjet – është edhe një lojë fjalësh mjaft e tejudukshme që i detyrohet vetëm kërkesës për të qenë konciz: “*në*”, referuar “*politikës*” qoftë si mbiemër qoftë edhe si emër: “*në*” hera herë si “*jo*” dhe hera herë si “*brenda*”. Pra, Gjykatë Kushtetuese politikisht e implikuar dhe njëkohësisht e paimplikuar.

Këtu nuk kemi të bëjmë me kontradiksion. Dy janë kuptimet e politikës që mund të futen në këtë relacion. I pari, është *kooperimi* midis aleatësh, për të krijuar bashkëjetesë dhe përfshirje shoqërore, domethënë miqësi, sipas Aristotelit. I dyti, është *konflikti* midis kundërshtarësh që synojnë të mbijetojnë, ku në lojë janë vënë marrja dhe ushtrimi i pushtetit publik¹. Le ta

¹ Po e lë mënjanë, për mendimin tim, përkufizimin arbitrar të Karl Shmitit: “Politikani” si kundërvënie radikale mik-armik, që ka si rezultat natyror e të skajshëm asgjë tjetër veçse asgjësimin e njërit nga ana e tjetrit. “Armiku” është thjesht “tjetri”, i panjohuri, i huaji (*der Fremde*), ashtu siç thotë edhe vetë Shmiti (Kategoritë e “politikanit”, nën kujdesin e G. Miglio dhe P.Schiera, Bologna, Il Mulino, 1974, 109), “ në një kuptim tepër intensiv”. Fakti që ky përkufizim i famshëm dhe i kobshëm ka lindur si përshkrim i jetës publike europiane, brenda shteteve dhe midis shteteve, në shekullin XX – “lufta civile europiane” – nuk do të thotë aspak se ai shpreh thelbin më të kulluar të politikës. Në të vërtetë, ai do të thotë që në të vërtetë asaj i mungon objekti, politika, dhe përmban një tjetër, luftën. Thelbi i luftës, dhe në veçanti i luftës asgjësuese, qëndron në kundërvënien mik-armik. Nëse hapësira publike

mbajmë parasysh në sfond këtë dyshe: *bashkëjetesën* dhe *konkurrimin* (*garën*). Kjo do të na vlejë për çka do të trajtoj.

Më poshtë do të shpjegoj njërin ndër shkaqet e drejtësisë kushtetuese, domethënë të kontrollit kushtetues ndaj procedurave dhe përmbajtjes së vendimmarrjeve kolektive, kryesisht të kontrollit kushtetues ndaj ligjeve.

Në një shoqëri ideale rreptësisht homogjene, të përbërë nga qenie njerëzore të njëjta për nga zotësitë, idealet, interesat, shijet dhe aspiratat, miratimi i vendimeve kolektive do të mund t'i besohej pa u merakosur aspak – këtu po kapërcej nga njëri skaj te tjetri – një bashkësie anëtarësh të saj që vendos njëzëri ose nga një anëtar i vetëm që vendos për të gjithë, për veten dhe për të tjerët. Nuk do të kishte aspak rëndësi se kush bën pjesë në këtë bashkësi ligjvënese ose kush do të jetë ky individ ligjvënës dhe, për këtë arsye, këta anëtarë mund të zgjidheshin rastësisht ose me short. Situata të këtij lloji janë hasur në kohën e mitologjisë kushtetuese klasike (këtu bëhet fjalë për *Kushtetutën e Athinasve* të Aristotelit), në atë shoqëri që nuk njihte dallime (ose që për më tepër i rrafshonin këto) dhe, për këtë arsye, njerëzit ishin të lumtur (ose, sipas shumë gjasash, nuk ishin aspak të lumtur).

Nuk ndodh pikërisht kështu në shoqëritë e trazuara demokratike të kohëve tona që karakterizohen nga dallime dhe përçarje të çfarëdollojshme. Në këto shoqëri tregohet kujdes shumë i vëmendshëm për procedurat e zgjedhjes së qeveritarëve, pasi këta do të përzgjedhin interesa, ideale dhe perspektiva të jetës kolektive. Kuptohet se në këtë shoqëri nuk do të ketë vendimmarrje të njëzëshme, për shkak se kjo do të ishte e pamundur të arrihej ngaqë shoqëria nuk është homogjene. Përrjashtohet delegimi rastësor te një individ

europiane karakterizohet tërësisht nga kjo kundërvënie, kjo do të thotë se në atë kohë, në Europë thjesht nuk ishte mbrujtur politika. Të quash politikën luftë, do të thotë pikërisht të korruptosh konceptet. Shih për këtë D. Sternberger, *Fjala politikë dhe koncepti i politikës në Immagini enigmatiche dell'uomo*, Bologna, Il Mulino, 1991, fq. 149).

i vetëm, për shkak të karakterit krejtësisht arbitrar që ky do të shpaloste në një shoqëri të përçarë. Nuk mbetet rrugë tjetër veçse të kërkojmë zgjidhjen te rregulli i shumicës. Por, ashtu siç u tha, kjo sjell që regjimet demokratike të krijojnë një pronë për të cilën nuk mund të flitet me aq lehtësi: i imponohet pakicës t'u nënshtrohet dhe të pranojë vendimet e shumicës².

A mund të jetë i pakushtëzuar ky detyrim? A mund të detyrohet pakica të përulet dhe të pranojë vendimet e shumicës?

Sa më shumë homogjene të jetë shoqëria aq më pak i mprehtë shfaqet ky problem. Për më tepër, në demokracinë mitike të antikitetit në shekujt V dhe IV para Krishtit, ky problem nuk shtrohej fare. Në kundërvëniet midis ligjeve të shkruara dhe ligjeve të amshuara të pashkruara (kujtojmë këtu tragjedinë *Antigona* të Sofokliut), *nomoi* dhe *psefismata*, *nomoi* të përgjithshme dhe *nomos basileus*, dhe në paditë për antikushtetutshmëri të personave³ – mjete që janë mjaft të afërta me kërkesat e sotme për antikushtetutshmëri – synohej jo thjesht mbrojtja e pakicës, por në të vërtetë synohej diçka tjetër: mbrojtja e vetë demokracisë, e vënë në rrezik nga demagogë me pikësnyime tiranike ose e rrezikuar nga prirje vetëvrasëse.

Ky problem në realitet shfaqet në mënyrë të mprehtë në shoqëritë e sotme demokratike, pluraliste dhe johomogjene. Arsyeja qëndron në faktin

² P.Pasquino, *Il giudice e il voto (Gjyqtari dhe vota)*, Mulino, n. 5, shtator-tetor 2003, fq. 803

³ Në studimet më të mira të prejardhjes së institucioneve, kryesisht në vepra me karakter përgjithësues të drejtësisë kushtetuese, studime që nuk i janë nënshtruar kritikës, nuk është e vështirë të gjejmë të rreshtuara këto institucione krahas atyre të kohës sonë, por që karakterizohen nga mungesa e plotë e logjikave të ndryshme ku ata mbështeten, ku janë pleksur bashkërisht institucione nga demokracia e lashtësisë gjer në ato të demokracisë moderne. Për mbrojtjen në gjykatë në demokracinë athinase, shih M.H. Hansen, *Eisangelia. La sovrانيتa del Tribunale popolare ad Atene nel IV secolo a.C.: e l'accusa centro strategji e politici*, nga M.C. Rogozinski, Torino, Giappichelli, 1998, e *Graphe Paranomon. La sovrانيتa del Tribunale popolare ad Atene nel IV secolo a.C.: e l'azione pubblica centro proposte incostituzionali*, nga M.C. Rogozinski, Torino, Giappichelli, 2001.

se mund të pranohet të qeverisemi nga shumica me kusht që pakica të jetë e sigurt për rrethanën që, cilido qoftë rezultati i zgjedhjeve popullore, nuk do të ketë rrjedhoja shkatërrimtare për humbësin. Nëse nuk do të kishte siguri ndaj rrezikut të zhdukjes ose persekutimit nga ana e “*fituesit demokrat*”, zgjedhjet do të shndërroheshin në beteja për jetë a vdekje: saktësisht e kundërta e asaj që duhet të quhet demokraci, domethënë e një rruge paqësore dhe konsensuale për të zgjidhur divergjencat dhe konfliktet.

Këtu na shfaqet një funksion i Kushtetutës, mbase ai kryesor, dhe pikërisht: përcaktimi i kushteve të bashkëjetesës midis të gjithëve, domethënë, i parimeve substanciale të jetës së përbashkët dhe i rregullave të ushtrimit të pushtetit publik të pranuar nga të gjithë, që qëndrojnë për këtë arsye jashtë njerëzve, për më tepër, përtej zënkave dhe debateve politike; parime dhe rregulla për të cilat – me një fjalë – *nuk votohet*⁴. Ose për t’u shprehur më saktë, pasi ato të jenë shkruar në një Kartë kushtetuese nuk mund të votohet më. Mund të themi se Kushtetuta, nëse i referohemi këtu një pohimi të lashtë dhe shumë të respektuar, përcakton atë që quhet *pactum societatis*, sipas të cilit njerëzit merren vesh për kushtet e bashkëjetesës në respekt të ndërsjellë që i mbron ata nga lufta për jetë a vdekje. Mbi bazën e kësaj marrëveshje fillestare, mund të krijohet një *pactum subiectionis*, me të cilin anëtarët e shoqërisë premtojnë t’iu binden - t’iu nënshtrohen – në mënyrë të ndërsjellë vendimeve të qeverisë së ligjshme, domethënë të pushtetit të shumicës, i cili vepron sipas rregullave dhe në respekt të parimeve që përmbahen në *pactum societatis*⁵. Është e lehtë të kuptohet së në çfarë

⁴ Shprehja është një citim i opinionit të gjyqtarit të Gjykatës Supreme Amerikane Robert Jackson, me rastin vendimit të 1942 mbi mbrojtjen e flamurit kombëtar dhe lirisë së shprehjes.

⁵ Me *pactum societas* kuptojmë atë pakt në bazë të të cilit një numër i caktuar individësh vendos me marrëveshje të përbashkët të jetojnë në shoqëri; me *pactum subiectionis*, kuptojmë atë pakt në bazën e të cilit individët, të bashkuar midis tyre, i nënshtrohen një pushteti të përbashkët; për këtë mund të lexoni N.Bobbio, *Il giusnaturalismo*, në *Storia delle idee politiche economiche e sociali*, nga L.Firpo, vol, tomo I, Torino, UTET, 1980, pp.504 ss.

mënyre dy nocionet e politikës të parashtruara më lart – politika si bashkëpunim dhe politika si konflikt – kanë se çfarë të gjejnë, e para, në *pactum societatis* dhe e dyta, në *pactum subiectionis*: koncepte që të dy të domosdoshme, sepse bashkimi pa nënshtrim është i pafuqishëm dhe nënshtrimi pa bashkim është tiranik⁶.

Mos vallë këto janë dallime, skema teorike që nuk kanë lidhje me jetën politike konkrete, ku trazohet çdo gjë, pa asnjë dallim? Në asnjë mënyrë. Në demokraci, qeverisësit e mençuruar nga mësimet e nxjerra nga përvoja, shpesh nga ato të nxjerra prej pësimeve, e dinë që respekti i *pactum societatis*, domethënë i Kushtetutës, është garanci për emëruesin më të vogël të përbashkët të homogjenitetit politik dhe që kjo përbën kushtin e domosdoshëm për qeverisjen. Detyra parësore e Kushtetutës, integrimi në këtë minimum uniteti, e ka vendin para detyrës së organizimit të institucioneve dhe të veprimtarisë së qeverisë, e cila megjithëse është thelbësore, renditet e dyta në radhë. Çdo politikan demokrat që preokupohet për të ashtuquajturën mënyrë qeverisje, domethënë (kundër përdorimit të zakonshëm të termit) për kushtet që e bëjnë shoqërinë për t'u qeverisur, është i ndërgjegjshëm se ruajtja e kushteve të homogjenitetit kushtetues, pra respekti ndaj Kushtetutës dhe, në radhë të parë, besimi në luajalitetin kushtetues përbëjnë parësoren e këtyre kushteve. Në rast se këto mungojnë, atëherë pakica do të ishte më pak e gatshme për të pranuar si të ligjshme vendimet e shumicës. Në rastin e skajshëm, konflikti do të zgjidhej jashtë demokracisë: ose duke përmbysur qeverinë, ose duke ia marrë frymën pakicës. Brenda këtyre dy rasteve të

⁶ Në fakt, në mënyrë analoge, teoritë kontraktore që parashikojnë vetëm një pakt, me të cilin të gjithë dhe secili cedejnë ndaj një të treti, ndaj sovranit, pushtetit të vërtetë natyror të vetëqeverisjes, me kusht që të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë – *pactum unions*, në një qeveri të përbashkët, i Hobsit – ose teoritë kontraktore që parashikojnë vetëm paktin e shoqërisë që krijon vetëm një subjekt të aftë të vullnetit të përgjithshëm – *kontrata shoqërore* e Rusoit – të gjitha këto të shpien në pushtetin e pakufizuar dhe tiranik.

skajshme do të gjejmë rraskapitjen e qeverisë dhe humbjen e frytshmërisë të veprimeve të saj. Prandaj, krejtësisht ndryshe nga ajo çka na shfaqet – ose më saktësisht, duke hedhur vështrimin tej iluzioneve – mund të thuhet që Kushtetuta, me urdhërimet dhe kufizimet e saj, madje: pikërisht me urdhërimet dhe kufizimet që shpalosin një funksion integrues gjithëpërfshirës, përbën mjetin qeverisës dhe nuk nxjerr aspak pengesë ose shqetësim për qeverisjen. Aty ku sundon mendimi i kundërt, po aty do të ketë mungesë ndërgjegjeje ose shpirt aventurieri.

* * *

Tani po kaloj, nga maja më e lartë (*empireu* - maja më e lartë e qiellit sipas Ptolemeut), te themelet e shtetit kushtetues; ndokush mund të mendojë gabimisht se unë po zbres nga lartësitë e koncepteve te problemet e drejtësisë kushtetuese.

Zbritja është e natyrshme: një gjykatë që nuk është dhe që duhet të ndruhet të jetë ose qoftë edhe të duket se është organ i politikës dhe në politikë si konflikt, domethënë si organ politik i llojit të dytë (përshkrimi plekset me parashkrimin; qenia me detyrimin për të qenë; konstatimi me kërkesën; realiteti me shfaqjen). Në të vërtetë, jemi dhe duhet të jemi organ politik i llojit të parë, pra politik, por jo në kuptimin e parlamentit, qeverisë, partive politike ose të subjekteve gjedhore.

Drejtesia kushtetuese nuk është vijim i një forme tjetër debatimi që zhvillohet në këto institucione. Tradhtia më e madhe e këtyre klerikëve siç jemi ne (ose siç kemi qenë) do të ishte shndërrimi ynë në një dhomë të tretë, ku do të vazhdonte me ndërmjetës konfrontimi midis palëve të konfliktit politik. Një gjykatë kushtetuese e rreshtuar politikisht (gjithmonë në kuptimin e dytë) do të meritonte të fshihej nga faqja e dheut, sepse, nëse ajo do të ishte në favor të shumicës, atëherë nuk do të kuptohej dobia e saj veçse do të shërbente si vitrinë për të mashtruar opinionin publik; nëse do të ishte e

kundërta, pra nëse do të kuptohej dobia, atëherë do të mungonte plotësisht legjitimiteti. Dëmi më i madh që vetë ne mund t'i shkaktojmë institucionit ku ne veprojmë dhe bëjmë pjesë, është krijimi i përshtypjes se ne veprojmë si kolonë e pestë.

Gjykata kushtetuese është rojë e *pactum societatis*, garanci e kushteve më minimale të jetës kolektive. Asaj i takon mbrojtja e parimeve kushtetuese për të cilat “nuk mund të votohet”. Përballja më e madhe nuk është kur dëgjojmë të na thonë “gaboni!”, por kur ne na trajtojnë si aktorë të konfliktit politik. Gjë që ka ndodhur ndonjëherë, madje në mjaft raste ka marrë shkas nga një informacion politiko-gjyqësor që nuk ka qenë në gjendje të bëjë dallimet e duhura, i përhapur me pathemelësi dhe me paramendim nga gjyqtarë me përkatësi politike. Kjo gjë ushqen në mënyrë të paarsyeshme dhe të ashpër idenë që për gjithçka dhe në të gjitha selitë (edhe në zyrat e gazetave të tyre?) të shpërthejë sërish lufta midis partive.

Merret me mend shqetësimi që ne ndjejmë në rast se zgjidhja e dhënë me vendim për një çështje kushtetuese përkon me atë çka është dëshiruar nga pala politike (qoftë e shumicës ose e pakicës), megjithëse vendimi është mbështetur në argumente kushtetuese të paqortueshme: shqetësim që vjen nga rreziku i ngatërrimit midis dy llojeve të dallueshme të argumenteve. Në mënyrë të ndërjegjshme ose të pandërgjegjshme, dhe këtu shtoj: konform rolit të gjykatës, ne shpallim pa dallim parapëlqimet e mundshme të zgjidhjeve që nuk janë as të njëjës dhe as të tjetrës palë. Nuk besoj se gabohem nëse përmend këtu njëfarë prirje psikologjike për “trugën e tretë” në pjesët e dispozitivave dhe ato arsytuese të vendimeve tona, sidomos për çështjet më të mprehta dhe politikisht të debatuar. Mendoj për shkaqe me rëndësi të madhe politike dhe kulturore që qëndrojnë pezull, lidhur me tema, ku opinionet janë të ndara. “Rruga e tretë”, eventualisht e sajuar nga vetë gjykata, e ekspozon këtë para akuzës së ambiguitetit “politik” dhe u lejon shpesh palëve kundërshtarë të thërrasin, *pro parte*, fitore: mirëpo në këtë rast bëhet fjalë pikërisht për politikën e llojit të dytë, së cilës gjykata përpiqet me të drejtë t'i shmanget.

Dikush mund të thotë: e megjithatë në gjykatë bëhet llogari, aty votohet dhe votohet pikërisht për të vendosur çështje, siç janë ato kushtetuese, për të cilat “nuk duhet të votohet”. Nëse nuk janë të pranueshme shumicat dhe pakicat ndër zgjedhësit ose ndër përfaqësuesit në parlament, atëherë si ndodh që votojnë pesëmbëdhjetë gjyqtarë të gjykatës dhe pikërisht që midis tyre të ketë ndarje? Ku i katandisim qëllimet tona të mira, nëse me anë të votës njëra palë shtyp tjetrën?

Këto pyetje shtrojnë një çështje mjaft serioze. Në fakt, ekziston ndër ne njëfarë kryeneçsie “*për të kaluar çështjet në votim*”. Nuk është se në po nxjerr në shesh ndonjë sekret kur them se për çështjet më të rëndësishme, për ato që ngërthejnë vërtet çështje të së drejtës kushtetuese, do të ishte mirë të mos votohet ose, më mirë akoma, të merret vendimi pa qenë e nevojshme të kalohet në votim ose kjo të bëhet krejt formalisht. Është gjë e mirë që gjykata të ketë kohë të mjaftueshme, që ajo të mos ngutet dhe të mos përshpejtojë ritmet. Është konstatim i mirënjohur në psikologji se në një trupë vendimmarrëse në fillim bëhet rreshtimi i forcave, pra bëhet ndarja e prerë e trupës; në fazën vijuese nis të mbizotërojë kërkesa për të gjetur një zgjidhje, për të bërë ujdi dhe, në këtë mënyrë, njëra pjesë tregohet më e gatshme për të kuptuar argumentet e pjesës tjetër. Në fillim militohet, më pas bashkëpunohet. Është gjë e mirë që Gjykata Italiane, ndryshe nga organet homologe të saj në vendet e tjera, nuk detyrohet të marrë vendimet brenda afatesh kohorë të caktuar.

E mira e të mirave do të ishte marrja e njëzëshme e vendimeve. Pikësynimi realist është zgjidhja që fiton më shumë mbështetje. Kur ne mund të formojmë shumicë dërrmuese, por të rrezikshme, që është në gjendje të imponojë zgjidhjen e vet në mënyrë të njëanshme, parapëlqejmë – veçanërisht për çështje të rëndësishme – të kërkojmë që për këtë zgjidhje të bashkohen sa më shumë gjyqtarë që të jetë e mundur. Që kjo të arrihet, kërkohet të kryhet punë e pandërprerë, shpesh jashtëzakonisht e kujdesshme, si për diapozitivin, ashtu edhe për argumentet, për të bashkuar numrin më të madh të mundshëm

të argumenteve kushtetues. Votimi vendimmarrës është *extrema ratio*⁷, tek i cili do të shkohet, sepse në fund të fundit, kur nuk ka qenë e mundur të bëhet pa të, ai nevojitet për t'i dhënë udhë punëve. Por pasi votohet, mbetet gjithnjë një shije e hidhur edhe në rast se kemi qenë në anën e shumicës. Është tashmë e mirënjohur⁸ se parlamentet ngjasojnë me arenat ku bëhet luftë, ku përçarjet politike strukturohen, në aspektin psikologjik, si ushtri të rreshtuara në fushëbetejë. Votimi përbën momentin kur gjërat kthjellohen, çastin kur kalohet nga tensionimi në shkrehje dhe ai që del fitimtar thotë: luftova dhe fitova betejën, bëra detyrën time. Ai mund edhe të shtojë duke thënë: e shpartallova kundërshtarin, dhe fytyra e tij merr pamjen e njeriut të kënaqur. Në gjykatë, nuk ndodh kështu. Si ai që fiton pas votimit, si ai që humbet, që të dy bashkërisht pësojnë humbje dhe duhet që secili të pyesë veten: në çfarë mase më ka munguar aftësia bindëse?

Nuk është një gjë që unë mund ta bëj tani, por do të kisha kërkuar të thellohet kuptimi i nenit 18 i Rregullores sonë të brendshme: “Relatori voton i pari, pastaj votojnë gjyqtarët e tjerë, duke filluar nga më i riu në moshë; i fundit voton Kryetari”. Vëmendja e pakët që i është kushtuar kësaj norme mund të shpjegohet me faktin se nuk jemi thelluar në kuptimin e thelbit të kësaj dispozite. Ajo do të thotë që në Gjykatë nuk ka votim në bllok. Vlejnë votat e individëve si të tillë dhe aspak votat e ndonjë grupimi (të shumicës ose të pakicës). Mund të merret me mend se Kryetari, pasi ka numëruar votat që janë të mjaftueshme për pranimin ose rrëzimin e kërkesës (shumica absolute e votuesve: neni 16 i ligjit nr. 87 të vitit 1953), ai nuk bën ndonjë veprim tjetër, kështu që grupimet nuk arrijnë të krijohen.

Kështu që ekziston një prirje për të arritur një konsensus më të gjerë, e kapërcen kërkesën formale për të arritur shumicën. Me që ra fjala, dëshiroj

⁷ Latinisht: shkak, arsyeja e fundit.

⁸ E. Canetti, *Masse und Macht* (1960), trad. It. *Massa e potere*, in *Opere*. 1932-1973, Milano, Bompiani, 1972, p.1203 ss.

të sjell një dëshmi të një kryetari të Gjykatës, emrin e të cilit për shumë arsye nuk po e përmend. Bëhet fjalë për një çështje tejet të brishtë që ka të bëjë me problemin e fuqisë prapavepruese të ligjit, çështje para-penale, së cilës ai i ishte përkushtuar shumë në të kaluarën dhe i kishte dhënë zgjidhje të ndryshme nga precedentët, duke paraqitur dokumente, duke ngritur hipoteza, duke mbledhur kolegët dhe duke diskutuar me ta. Pra, me pak fjalë, ai e kishte shumë për zemër këtë temë. Mirëpo, kur kjo çështje ishte në shqyrtim, ai ndodhej në pozicionin e Kryetarit të Gjykatës dhe gjyqtarët që formonin trupën ishin në numër çift. Në raste si ky, ka përparësi vota e Kryetarit. Votat e gjyqtarëve për atë çështje u ndanë në mënyrë të barabartë. A përbënte kjo çështjeje një rast ideal për pikëpamjen e tij? Jo, aspak. Vendimi i kësaj çështjeje të rëndësishme, me votën prevalente të kryetarit, do të ishte diçka e nxjerrë me pahir: vendimi merrej vërtet konform ligjit dhe me të shtyrë, por ama ai do të binte ndesh me shpirtin e këtij institucioni. Kryetari, për të cilin bëj fjalë, e di sesa shumë është vlerësuar prapësimi nga pikëpamja e tij.

Kam thënë: në Gjykatë nuk bëhet thirrje për t'u bashkuar, nuk krijohen grupime dhe aq më pak formacione luftimi. Çdo vendim, të paktën për çështje që kanë njëfarë rëndësie, merret me pjesëmarrjen vetjake dhe të drejtpërdrejtë të të gjithë gjyqtarëve. Secili duhet të përmbushë përgjegjësitë e veta. Askush nuk mund të mos marrë pjesë, jo vetëm në votim, por edhe në diskutimet që bëhen gjatë këshillimeve. Nuk është aspak e pëlqyeshme t'i nënshtrohesh mendimit të tjetrit ngaqë mund të duket se je në të njëjtën hulli me të. Fatmirësisht, rrallë herë ky qëndrim merret në kuptimin e varësisë ndaj tjetrit. Vlera e gjyqtarit shprehet pikërisht me pjesëmarrje të këtij lloji, vlerë matematikisht e pallogaritshme në krahasim me vlerën që përfaqëson një votë e thjeshtë: një votë ndër pesëmbëdhjetë të tilla!

Kështu pra, veprimtaria e Gjykatës mbështetet në personalitetet individuale të gjyqtarëve. Ajo ushtrohet njëkohësisht në mënyrë kolegjiale. Kjo veçori ka kuptim të thellë që shkon shumë më larg se respektimi rigoroz i rregullave procedurale. Për më tepër, nëse në sistemet e tjera secili gjyqtar kushtetues

ka veçanërisht personalitet dhe individualitet institucional, te ne gjyqtarët kushtetues, të cilëve u njihet plotësisht subjektiviteti brenda trupës gjyqësore, nuk janë asgjë jashtë kësaj trupe. Ekzistojnë vetëm si pjesë e Gjykatës: jashtë kësaj ata nuk janë të ngarkuar me detyra, nuk mund as edhe të shprehin opinionet e tyre. Pra, del se ajo është një trupë gjyqësore vendimmarrëse e konceptuar si një e tërë, si një gjyqtar gjigant që përbëhet nga pesëmbëdhjetë gjyqtarë xhuxhë.

Mungesa e mendimit të pakicës dhe atij paralel mbetet për t' u diskutuar, me të gjitha pikëpamjet *pro* dhe *kundër*. Është t vërtetë se edhe ajo mban lart frymën e trupës kolegjiale, shpie në arritjen e marrëveshjes, duke sakrifikuar sa më pak vlerësime kushtetuese të rëndësishme, pavarësisht nga fakti se ato mbrohen nga pakica. Logjika që vë në lëvizje Gjykatën nuk është logjika vertikale që nxjerr përfundim nga një parim i vetëm kushtetues duke përjashtuar të tjerë, pra një logjikë që përçan dhe që kërkon të bësh llogari votash; është logjika horizontale me hallka përbërëse që merr parasysh çdo argument kushtetues të mundshëm dhe i bashkon ato pa bërë llogari. Mendimi i pakicës, duke i bërë të qëndrueshme pozitat e veçanta të gjyqtarëve, zor se do të pajtohej me frymën e kolegjalitetit, e konceptuar me këtë kuptim të thelluar.

Mirëpo, *do të thotë dikush*, Gjykata në vendimet e saj shpreh qëndrime të caktuara. Po, por jo në kuptimin e qëndrimit politik të një qeverie ose të një shumice parlamentare. Çdo çështje ka veçoritë e veta. Nuk ekziston shumicë e krijuar paraprakisht për vendimmarrjen për çështje të veçanta dhe as përcaktim qëndrimesh të përgjithshme, të cilëve duhet t' u përmbahesh. Programi, që do të ndërfohet mes vendimit për një çështje dhe Kushtetutës, do të binte ndesh me kërkesën e besnikërisë ndaj Kushtetutës në përgjithësi, kërkesë që përjashton çdo detyrim të veçantë si program palësh. Nëse mund të flitet për qëndrime të politikës gjyqësore, kjo duhet të merret në kuptimin retrospektiv, si *balanc a posteriori* i një qëndrimi që nuk futet brenda shabllonesh të paracaktuara. Në Parlament, ekziston një shumicë

parlamentare që ka për detyrë të jetë e qëndrueshme si e tillë, për të zbatuar një program politik. Nëse kjo shumicë përçahet, duke dobësuar në këtë mënyrë vazhdimësinë e veprimit të vet, atëherë nuk ka më asnjë arsye që ajo të ekzistojë. Prandaj është normale që në organet parlamentare vendimet të merren gjithnjë nga e njëjta shumicë parlamentare, gjersa kjo të mos jetë zëvendësuar nga një shumicë tjetër. Në Gjykatë nuk ndodh kështu. Vendime merren ditë për ditë dhe në varësi të çdo çështjeje të veçantë. Në të njëjtën ditë, formimi dhe përbërja e shumicës vendimmarrëse ndryshojnë nga çështja në çështje. Në Parlament, pakica ka pranuar qenien e saj si të tillë dhe ajo mbetet në pritje të përmbysjes, me anë të zgjedhjeve, të raportit të forcave që ajo të kalojë nga pakica në shumicë. Po këtu? A mendoni se gjyqtarët do të pranenin vallë të bëjnë pjesë në një formacion ku ata të mos ndryshojnë qëndrim qoftë edhe për një mandat? Ose do të pranenin të mos bënin asgjë gjersa të bëhej një ndryshim eventual i paparashikueshëm i ekuilibrave të brendshëm? Në fund të fundit, nëse në Gjykatë do të ekzistonte një qëndrim politik i paracaktuar, atëherë nuk do të ishte e natyrshme që Kryetari të mos ishte shprehja dhe garancia e këtij qëndrimi? Mirëpo, është fare e qartë se kriteri parësor që përcakton zgjedhjen e Kryetarit është mosha: pra, nuk është politika, por është natyra.

Mungesa e qëndrimeve të përcaktuara paraprakisht nuk do të thotë, megjithatë, se nuk ekziston vazhdimësi e jurisprudencës. Këtu kemi të bëjmë me vazhdimësi në një plan më të lartë, në planin kushtetues. Një organ i tillë si Parlamenti është në atë pozicion për të bërë ligje sipas nevojave politike dhe shoqërore të kohës. Kur një çështje shtrohet haptazi në aspektin ligjvënës, atëherë lipset të hartohet ligj i ri me supozimin paraprak, që ligji i mëparshëm duhet zëvendësuar, që ai të riformulohet dhe, nëse është e nevojshme, të hartohet tërësisht nga e para. Për një organ gjyqësor, dhe për Gjykatën në veçanti, situata paraqitet krejtësisht e kundërt. Kur një çështje është në shqyrtim para Gjykatës sonë, bëhet fjalë për të ritheksuar vazhdimësinë e vlerës së Kushtetutës. Ne nuk mund t'ia nisim kurrë nga e para. Po të mos

ishite kështu, vendimi do të dukej, madje do të ishte, produkt i vullnetit të kulluar të çastit dhe aspak rezultat i arsyetimit juridik të mbështetur në dispozitat kushtetuese dhe të përpunuar përgjatë viteve të jurisprudencës. Vlera e jashtëzakonshme që i vishet precedentit është kaq e rëndësishme saqë parapëlqehet që ky të përforcohet me tej edhe kur mund të dalin shkaqe juridike për ta kapërcyer ose për ta përmbysur atë. Kërkesa për vazhdimësi ka vlerë shumë të madhe. Megjithëse mund të ketë pakënaqësi për një vendim të caktuar, këtu bëhet fjalë për të mbrojtur një kërkesë më të lartë, qëndrueshmërinë e parimit juridik dhe karakterin e parashikueshëm të zbatimit të tij; në fund të fundit, bëhet fjalë për të mbrojtur karakterin e një organi që “jep” dhe nuk “krijon” të drejtën. A bëhen ndryshime? Sigurisht që bëhen. Do të ishte vërtet mjerim nëse jurisprudenca nuk do të ishte “e gjallë”; mirëpo zhvillimi bëhet shkallë-shkallë, rregullime e saktësime bëhen në mënyrë progresive. *Reirements* (kthesat rrënjësore) janë shumë të rralla dhe, me një fjalë, ato nuk e ngrenë aspak reputacionin e Gjykatës.

Mirëpo, *më në fund dikush mund të thotë*, në përbërje të Gjykatës ka gjithmonë persona me të kaluar politike (në kuptimin e dytë të termit). Në të vërtetë, është pikërisht kështu, nisur nga sistemi i emërimit dhe i zgjedhjes së tyre (megjithatë, ndër sistemet që njihen në të drejtën e krahasuar, ky është sistemi më pak i politizuar). Mirëpo, përveç kohëzgjatjes së mandatit nëntëvjeçar të tyre (më i gjati ndër ata që parashikon Kushtetuta), duhen vlerësuar edhe garancitë për ushtrim të veprimtarisë në pavarësi të plotë, kushti psikologjik i gjyqtarëve: respekti për vetveten dhe sedra.

Personat e ngarkuar në detyrën e gjyqtarit kushtetues janë si rregull njerëz me personalitet të fortë dhe me të kaluar shumë dinjitoze, qoftë edhe politike, që ata i kanë vënë vetes detyrë për t'i mbrojtur. Është e domosdoshme të jetë tamam kështu, jo vetëm për arsye që kuptohen vetiu, por mbi të gjitha sepse ato përbëjnë garanci për pavarësinë nga politika e rastit. Është njëqind herë më mirë kjo zgjidhje sesa të emërohen ose zgjidhen

individë as mish as peshk ose *Nikodemë*⁹ që nuk janë besnikë ose që e fshehin besnikërinë. Këta figura gjysmake nuk kanë asnjë motiv për të respektuar vetveten dhe mundet që me shumë lehtësi të bëhen për nga persona të tjerë për të bërë lëshime për këtë ose atë çështje.

Sedra, në fund të fundit, shtyn cilindo, veçanërisht edhe gjyqtarin kushtetues, të ketë dëshirën për t'u vlerësuar, të paktën për aq kohë sa ai është në përbërje të kësaj Gjykate. Por, që të kesh vlera nevojitet të fitosh besimin e kolegëve. Pjesëmarrja për nëntë vjet radhazi në kolegjin këshillimor përbën provë për këtë. Këtu, e shkuara ka vlerë vetëm për ndërgjegjen tonë të brendshme (respekti për veten), jo për të tjerët. Nuk jemi të interesuar të dimë se nga vijnë kolegët tanë. Kjo çështje u përket atyre që i emërojnë dhe i zgjedhin. Këtu vlen, dhe vlen shumë, ajo çfarë është e çfarë bëhet në kolegji, bëhet në trupë, në veprimtarinë e përditshme të gjykimit. Do të kishte marrë fund gjyqtari që në veprimtarinë e përditshme të tij do të zhdepej me kritika nga ne për shkak se ai është bërë *longa manus*¹⁰ e politikës. Sedra do të na detyronte të ndërrojmë mendim për të.

* * *

Për këto arsye ne mund ta përkufizojmë shkurtimisht dhe në mënyrë të sintetizuar Gjykatën si *homeostazi*¹¹, ekuilibër që krijohet pothuaj vetvetiu midis forcash vetërregulluese që e mbajnë atë mbi rrota dhe e ruajnë të mos humbasë drejtimin. Kjo është Gjykata ime, zoti Kryetar, Gjykata në të cilën

⁹ Nikodemi është cilësuar dishepull i Krishtit; ai përmendet në dy vende në Ungjill. Janë hedhur dyshime lidhur me shënjtërimin e tij, sepse ai shkon të takojë Krishtin kur është errësuar nga që kishte frikë se çfarë do të thoshin njerëzit për këtë.

¹⁰ Latinisht, dora e gjatë

¹¹ Homeostazia është term që shpreh aftësinë për të ruajtur ekuilibrin e funksionimit, me gjithë veprimin e rrethanave shtrënguese të jashtme.

kam bërë pjesë. Ndërsa flisja, më lindi pyetja: mos vallë ky është vizion idilik? Po, mund të jetë i tillë për ndonjë aspekt. Mirëpo, siç thashë në krye, këtu qenia prek detyrimin për të qenë, realiteti e mbështet.

Gjykata, ashtu siç u përpoqa ta paraqes atë, është fryt i përbashkët si i shkaqeve juridike, ashtu edhe i qëndrimeve shpirtërore dhe motiveve psikologjike. Të parat ndikojnë të dytat dhe anasjelltas. Ekuilibri është tejet i brishtë dhe mund të thyhet lehtësisht, kështu që duhet të jemi të vetëdijshëm. Fryma dhe psikologjia që i shërbejnë interesit të lartë të mbrojtjes së Kushtetutës nga trazirat e politikës konfliktore janë çështje që u takojnë gjyqtarëve. Krijimi i kushteve paraprake është çështje që i përket ligjvënësit. Jemi të sigurt, ose dëshirojmë të shprehim sigurinë, që në morinë e përkujdesjeve reformatore të saj, në radhë të parë të jetë qëndrimi i patundshëm i Gjykatës në vendin që asaj i është caktuar nga Kushtetuta.

Garancia e fundit, megjithatë, nuk qëndron as te gjyqtarët, as te shumica ligjvënëse. Ajo qëndron gjatë dhe u përket të gjithëve. Po e rinis që nga kreu. Ajo qëndron te nevoja e shkrirë brenda vullnetit të përgjithshëm të Kushtetutës: dua të them i kushtetutës si *pactum societatis*, i kuptuar si kusht paraprak për një bashkëjetesë civile, paqësore dhe konstruktive. Në rast se do të mungonte kjo nevojë dhe ky vullnet, duke vënë në plan të parë idenë e djallëzuar (atë të republikës së djajve) të një kushtetute që do ta bënte vendin tonë fushë beteje ku njëra palë shtyp tjetrën, atëherë era e politikës partiake do të frynte pa pengesa edhe në zyrat e Gjykatës dhe drejtësia kushtetues do të shndërrohet në farsë kushtetuese.

Informacion për legjislacionin e miratuar në Kuvend

Filip Lako

Jurist

Qendra e Studimeve Parlamentare

Ligji nr. 9585, datë 17.7.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Sipas nenit 19 të ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, fondet për administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të degëve të saj në rrethe sigurohen nga Buxheti i Shtetit. Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve i lihet 1 për qind e shumës vjetore të tatimeve të mbledhura. Jo më pak se 60 për qind të kësaj shume përdoret për investime, për përmirësimin e modernizimin e mjediseve, për krijimin e kushteve të punës e të banimit dhe për trajnimin e punonjësve të administratës tatimore. Pjesa e mbetur përdoret për shpërblimin e punonjësve të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe të punonjësve të degëve të tatimeve në rrethe. Këto fonde shpërndahen nga Këshilli i Tatimeve dhe administrohen nga Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve. Ligjit nr. 8560, datë 22.12.1999 i janë bërë disa shtesa e ndryshime me ligjet nr. 8710, datë 15.12.2000, nr. 8846, datë 11.12.2002, nr. 9160, datë 18.12.2003 dhe nr. 9333, datë 6.12.2004. Të gjitha ndryshimet ose shtesat kanë prekur nene të veçanta të ligjit nr. 8560, datë

22.12.1999. Edhe në nenin 19 janë bërë shtesa e ndryshime.Me ligjin nr. 9585, datë 17.7.2006, neni 19 ndryshohet krejtësisht. Sipas këtij ndryshimi, fondet për administrimin e Drejtorisë së Përgjithshme dhe të degëve të saj në rrethe sigurohen nga Buxheti i Shtetit. Përbashimisht, për vitin 2006, pjesa e të ardhurave, që do të përdoret për investime e shpenzime operative, është sipas ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2846.

Ligji nr. 9586, datë 20.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European për aspekte të caktuara të shërbimeve ajrore”. Kjo Marrëveshje është bërë në Strasburg më 5 maj të vitit 2006 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit European. Shtysat për të ratifikuar këtë Marrëveshje kanë qenë disa. Ndër më kryesoret është fakti që ishte vënë re se marrëveshjet dypalëshe të shërbimit ajror që janë përfunduar ndërmjet disa shteteve anëtare të Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë, përmbajnë dispozita në kundërshtim me ligjin e Komunitetit. Megjithatë, kjo ka ndodhur, edhe pse Komuniteti European ka kompetencë ekskluzive në lidhje me disa aspekte që mund të përfshiheshin në marrëveshjet dypalëshe të shërbimit ajror ndërmjet Shteteve Anëtare të Komunitetit European dhe vendeve të treta. Pra, duke ditur se disa dispozita të marrëveshjes dypalëshe të shërbimit ajror, ndërmjet shteteve anëtare të Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë, janë në kundërshtim me ligjin e Komunitetit European, ato duhet të sillen në përputhje me të, me qëllim vendosjen e një baze të shëndoshë ligjore për shërbimet ajrore ndërmjet Komunitetit European dhe Republikës së Shqipërisë dhe ruajtjen e vazhdimësisë së shërbimeve të tilla ajrore, duke u realizuar në përputhje nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje. Përveç detajeve shumë teknike, në këtë Marrëveshje është parashikuar që ankesat e saj do të konsiderohen pjesë

përbërëse, si dhe fakti që palët në çdo kohë mund të rishikojnë ose ndryshojnë këtë. Hyrja në fuqi e Marrëveshjes kushtëzohet me detyrimin e palëve për të njoftuar me shkrim njëra-tjetrën për plotësimin e procedurave të nevojshme përkatëse të brendshme të hyrjes në fuqi. Marrëveshja ka edhe Aneksin 1, që përmban listën e marrëveshjeve dypalëshe, midis vendeve europiane dhe Republikës së Shqipërisë për shërbimin ajror, ka Aneksin 2 me listën e neve që u referohen marrëveshjeve dypalëshe dhe Aneksin 3 me listën e disa shteteve europiane që përmenden në nenin 2 të Marrëveshjes. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86 të vitit 2006 në faqen 2935. Marrëveshjes i bashkëlidhen 3 anekse.

Ligji nr. 9587, datë 20.7.2006 “Për mbrojtjen e biodiversitetit”.

Ligji i lartpërmendur zbatohet për të gjitha sipërfaqet gjeografike, tokësore, ujore dhe detare të Republikës së Shqipërisë, pronë shtetërore ose private. Për ruajtjen dhe përdorimin e qëndrueshëm të racave dhe të varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, autoriteti drejtues dhe përgjegjës është Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, kurse për ruajtjen e biodiversitetit dhe për përdorimin e qëndrueshëm të përbërësve të tij, në nivel kombëtar dhe vendor, është Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave. Ligji trajton edhe probleme lidhur me strategjinë dhe planin e veprimit të biodiversitetit, ku përfshihen edhe problemet që kanë të bëjnë me rrjetin e inventarizimit dhe monitorimit të biodiversitetit, me planifikimin për emergjencat, ndikimet ndërkuftare etj. Ruajtja e ekosistemeve, habitateve dhe peizazheve, që ndodhen jashtë rrjetit përfaqësues të zonave të mbrojtura, që gjendet në kreun IV, bën fjalë edhe për identifikimin e kategorive të përgjithshme të ekosistemeve, si dhe për masat e menaxhimit. Përveç përcaktimit të masave mbrojtëse për llojet (speciet) tokësore, ujore dhe detare, ligji ka parashikuar edhe statusin e llojeve të mbrojtura, sipas të cilit kapja, marrja, mbrojtja dhe përdorimi i individëve dhe llojeve të kafshëve dhe bimëve të mbrojtura janë të ndaluara, përveç

rasteve kur në këtë ligji përcaktohet ndryshe. Sipas ligjit që po trajtojmë, ruajtja dhe përdorimi i qëndrueshëm i racave dhe varieteteve autoktone, të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi, janë pjesë e strategjisë, planeve, programeve dhe vendimmarrjeve, në nivel kombëtar dhe vendor. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit mban regjistrin e racave dhe të varieteteve autoktone të rëndësishme për ushqim dhe bujqësi. Kjo Ministri dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, urdhërojnë asgjësimin ose frenimin e përhapjes së llojeve të huaja invazive të futura me ose pa qëllim. Është vendosur edhe detyrimi që Ministria e Bujqësisë t'i njoftojë shtetet e prekura ose potencialisht të prekura, si dhe organizatat përkatëse ndërkombëtare, kur në territorin e Republikës së Shqipërisë ndodh ose mund të ndodhë një transport ndërkufitar i llojit të huaj dhe/ose lloji i huaj invaziv, që mund të ketë ndikime negative në shtete të tjera ose në një sipërfaqe jashtë kufijve të çdo juridiksioni ndërkombëtar. Në ligji trajtohen edhe probleme që kanë të bëjnë me veprimtari kërkimore që lidhen me biodiversitetin, me ndarjen e përfitimeve nga përdorimi i materialit gjenetik dhe i molekulave të tjera biologjike, probleme të kontrollit për zbatimin e këtij ligji, të kundërvajtjeve e sanksioneve etj. Ligji ka 57 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2847.

Ligj nr. 9588, datë 25.7.2006 “Për rillogaritjen e pensioneve”.

Në ligjin e lartpërmendur bëhet fjalë kryesisht për rillogaritjen e pensioneve të pleqërisë në qytet. Kështu, pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1994 deri më 31.12.1996, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten duke indeksuar pagat, mbi të cilat është llogaritur baza e vlerësuar dhe pagën neto, sipas koeficienteve të indeksimit të miratuar çdo vit me vendim të Këshillit të Ministrave. Indeksi bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit. Rillogaritja, siç e thamë më lart, u përket

pensioneve të pleqërisë të caktuara në periudhën nga 1.1.1994 deri më 31.12.1996. Tjetër rillogaritje do të bëhet për pensionet për periudhën nga 1.1.1997 deri më 14.6.2005. Kështu, pensionet e pleqërisë në qytet, që kanë datë fillimi datën 1.1.1997 deri më 14.6.2005, përfshirë edhe këtë datë dhe që vazhdojnë të paguhen pas datës 1.7.2006, rillogariten sipas neneve 32, 33, 34, 59, 60, 61 dhe 62 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe të akteve nënligjore në fuqi, të dala në zbatim të tij. Rillogaritja bëhet në bazë të pagave të dokumentuara e të paraqitura në kohën e caktimit të pensionit. Masa e rillogaritur e pensionit ritet sipas vendimeve të Këshillit të Ministrave për rritjen e pensioneve. Ky ligj i fillon afatet financiare nga data 1.7.2006. Bazuar në parimin e të drejtës të fituar, kur masa e pensionit të rillogaritur rezulton më e vogël se pensioni ekzistues, pensioni nuk ndryshon, duke u vlerësuar si e drejtë e fituar. Ligji ka 8 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2864.

Ligji nr. 9589, datë 25.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së huasë ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) për financimin e projektit “Zhvillimi i rrugëve në Bashkinë e Tiranës””. Sipas Marrëveshjes, Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) ka rënë dakord që t’i japë një hua Huamarrësit (Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë) në shumën 14.600.000 euro, për projektin për zhvillimin e rrugëve të Bashkisë së Tiranës. Në qëllimet e lidhjes së kësaj Marrëveshje del se kjo Bankë është krijuar për të siguruar financime për projekte të veçanta, për të nxitur kalimin drejt ekonomive me orientim ndaj tregut të lirë dhe për t’i dhënë shtysë nismës private dhe sipërmarrëse në vendet e Europës Qendrore dhe Lindore, që zbatojnë parimet e demokracisë shumëpartiake, pluralizmit dhe të ekonomisë së tregut. Pagesat e huas do të fillojnë të bëhen me dy këste në vit, nga data 6 qershor 2009

deri më 6 dhjetor 2020. Me qëllim që të bashkërendohen, drejtohen, vëzhgohen dhe vlerësohen të gjitha aspektet e vënies në jetë të Projektit, duke përfshirë këtu blerjen e mallrave, punimet e shërbimet për Projektin, Huamarrësi do të verë në veprim, në çdo kohë gjatë zbatimit të Projektit, një njësi për vënien në jetë të projektit me burime të përshtatshme dhe me personel të kualifikuar në mënyrë të përshtatshme, si dhe me synime dhe përgjegjësi të pranueshme për Bankën. Këshilltarët, që do të punësohen nga Huamarrësi për të ndihmuar në përmbushjen e Projektit, do të zgjidhen në përputhje me procedurat në rregullat e prokurimit të BERZH-it. Gjithashtu, do të punësohen ose do t'u krijohen kushte për punësim këshilltarë, kualifikimet, përvoja dhe termat e referencës të cilëve janë të kënaqshme për Bankën. Me rëndësi janë edhe parashikimet në Shtojcën e Programit 2. Aty specifikohen kategoritë e punëve, shuma e Huas së lëvruar për çdo kategori dhe përqindja e shpenzimeve që do të financohen. Në përshkrimin e Projektit gjendet edhe Programi i Investimit. Nga kjo del se është planifikuar rehabilitimi dhe përmirësimi i Unazës së Tiranës, midis Zogut të Zi dhe Stacionit të Trenit, rehabilitimi dhe përmirësimi i Unazës së Tiranës midis Stacionit të Trenit dhe Rrugës “Dibra” dhe Bulevardit “J. D’ Arc”, rehabilitimi dhe përmirësimi i kryqëzimit të Kamzës dhe i rrugës së Kavajës dhe rrugës së Unazës së Madhe në kryqëzim. Projekti duhet të përfundojë brenda datës 31 dhjetor 2008. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 25.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 86 të vitit 2006 në faqen 2941. Ligjit i bashkëlidhet Marrëveshja dhe Aneksat.

Ligj nr.9590, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Europiane e shteteve të tyre anëtare”. Në nënshkrimin e kësaj Marrëveshjeje është pasur parasysh lidhja e fortë ndërmjet palëve dhe vlerat që i bashkojnë, dëshira e tyre për të forcuar këto lidhje dhe për të vendosur marrëdhënie të ngushta e të qëndrueshme, bazuar në reciprocitetin

dhe interesin e ndërsjellë, të cilat duhet t'i japin mundësi Shqipërisë të forcojë dhe të zgjerojë më tej marrëdhëniet e vendosura më parë me Komunitetin nëpërmjet Marrëveshjes për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik të vitit 1992 me Komunitetin e shtetet e tij anëtare. Gjithashtu, është pasur parasysh edhe angazhimi i palëve për të kontribuar me të gjitha për stabilizimin politik, ekonomik e institucional të Shqipërisë dhe rajonit nëpërmjet zhvillimit të shoqërisë civile dhe demokratizimit, ndërtimit të institucioneve dhe reformës administrative publike, integritit në tregtinë rajonale dhe rritjes së bashkëpunimit ekonomik, si dhe nëpërmjet bashkëpunimit në një gamë të gjerë fushash, veçanërisht në drejtësi e çështjet e brendshme dhe forcimin e sigurisë kombëtare dhe rajonale. Marrëveshja përmban angazhimet e Shqipërisë për të nxitur bashkëpunimin dhe marrëdhëniet e fqinjësisë së mirë, me lëvizjen e personave, mallrave, kapitalit dhe shërbimit, si dhe zhvillimin e projekteve me interes të përbashkët, veçanërisht atyre që lidhen me luftën kundër krimit të organizuar, korrupsionit, pastrimit të parave, emigrimit të paligjshëm dhe trafikimit. Ky angazhim përbën një faktor kyç për zhvillimin e marrëdhënieve të bashkëpunimit ndërmjet palëve, duke kontribuar kështu në stabilitetin rajonal. Marrëveshja trajton veçmas dhe gjerësisht edhe probleme të dialogut politik, të bashkëpunimit rajonal, të lëvizjes së lirë të mallrave, produkteve industriale, bujqësore dhe peshkimit, lëvizjen e punonjësve, ndërmarrjeve dhe ofrimin e shërbimeve e të kapitalit. Me interes janë sidomos dispozitat lidhur me përafrimin e legjislacionit, imponimi i ligjeve dhe rregullave të konkurrencës, të lirisë, drejtësisë dhe sigurisë, e politikave të bashkëpunimit, përfshi edhe atë financiar. Marrëveshja ka 137 nene, 7 shtojca dhe 6 protokolle. Shtojca 1 trajton probleme lidhur me koncesionet tarifore të Shqipërisë për produktet industriale të komunitetit. Shtojca 2(a) tregon tarifën koncesionare shqiptare për prodhimet parësore bujqësore të prodhuara në Komunitet. Shtojca 2 (b) jep tarifën koncesionare shqiptare për prodhimet kryesore bujqësore të prodhuara në Komunitet. Shtojca 2 (c) jep tarifën koncesionare shqiptare

për prodhimet bazë bujqësore të prodhuara në Komunitet. Shtojca 3 jep tarifën koncesionare të KE-së për peshkun dhe nënproduktet e peshkut shqiptar. Shtojca 4 trajton shërbimet financiare. Shtojca 5 trajton të drejtën e pronësisë intelektuale, industriale dhe tregtare. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 29.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.87 të vitit 2006, në faqen 2955. Ligji i bashkëlidhet Marrëveshja me 137 nene, 7 shtojca në 341 faqe dhe 6 protokolle.

Ligji nr. 9591, datë 27.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes së përkohshme ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Europian për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar””. Siç del edhe nga përmbajtja e saj, Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ka për qëllim vendosjen e lidhjeve të ngushta dhe të qëndrueshme bazuar në reciprocitet dhe interes të ndërsjellë, që duhet t’i japë mundësinë Shqipërisë të forcojë dhe zgjerojë më tej marrëdhëniet e vendosura më parë. Kjo Marrëveshje ndërmjet Komuniteteve Europiane dhe shteteve të tyre anëtare nga njëra anë, dhe Shqipërisë nga ana tjetër, është nënshkruar në Luksemburg më 12 qershor 2006. Nënshkrimi i kësaj Marrëveshjeje, gjithashtu, bën të nevojshëm zhvillimin e lidhjeve tregtare nëpërmjet forcimit dhe zgjerimit të marrëdhënieve të vendosura më parë, veçanërisht nëpërmjet Marrëveshjes për Tregtinë dhe Bashkëpunimin Tregtar dhe Ekonomik nënshkruar më 11 maj 1992, e cila hyri në fuqi më 4 dhjetor 1992. Në pjesën e Marrëveshjes që trajton lëvizjen e lirë të mallrave, parashikohet që Komunitetit Europian dhe Shqipëria të vendosin gradualisht një zonë të tregtisë së lirë gjatë një periudhe maksimumi dhjetëvjeçare, duke nisur nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje, në përputhje me dispozitat e saj dhe me dispozitat e GATT – 1994 dhe të Organizatës Botërore të Tregtisë. Dispozita me rëndësi të veçantë janë dhe ato që kanë të bëjnë me doganat. Kështu, detyrimet doganore për importet drejt Komunitetit të produkteve, që kanë origjinë Shqipërinë, shfuqizohen me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje. Po ashtu, edhe kufizimet sasiore

për importet drejt Komunitetit për produktet, që kanë origjinë Shqipërinë, shfuqizohen. Përveç kësaj, Komuniteti dhe Shqipëria, me hyrje në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, shfuqizojnë në tregtinë ndërmjet tyre çdo detyrim që ka efekt të barabartë me detyrimet doganore për importet. Veç kësaj, me hyrjen në fuqi të Marrëveshjes, nuk vendosen detyrime doganore të reja për importet ose eksportet, ose tarifa të reja me efekt të njëjtë me to dhe as nuk rriten as ato që zbatohen tashmë në tregtinë ndërmjet Komunitetit dhe Shqipërisë. Marrëveshja trajton edhe probleme lidhur me ndikimin e diskriminimit fiskal, me bashkimet doganore, zonat e tregtisë së lirë, rregullimet ndërkufitare, klauzolat e përgjithshme për masat mbrojtëse, monopolet shtetërore, konkurrencën, pronësinë intelektuale, industriale dhe tregtare, kontratat publike etj. Marrëveshjes i janë bashkëlidhur 6 shtojca dhe 5 protokolle që trajtojnë probleme të prodhimit të hekurit dhe çelikut, të tregtisë për produktet bujqësore të përpunuara, të koncesioneve preferenciale të ndërsjella, të ndihmës së ndërsjellë administrative në çështje doganore etj. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 2.9.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 89 të vitit 2006, në faqen 3249 deri në faqen 3500. Marrëveshjes i lidhen shtojcat dhe protokollat.

Ligji nr. 9592, datë 27.7.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”. Me ligjin e lartpërmendur, ligjit në fuqi i bëhen 6 shtesa e ndryshime. Disa nga këto janë teknike, kurse të tjerat kanë të bëjnë me përmbytjen. Me këto ndryshime, pranë Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve ngrihet Komiteti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Shpirtërore, i cili kryesohet nga ministri. Me rëndësi janë problemet që trajtohen lidhur me mirëmbajtjen dhe restaurimin e monumenteve të kulturës. Kështu, sipas nenit 13 të ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, që kanë në pronësi objekte me vlera të trashëgimisë kulturore, të luajtshme e të paluajtshme, të regjistruara, janë të detyruar të krijojnë kushtet e nevojshme për mirëmbajtjen e tyre. Sipas nenit 17 (të

ndryshuar) projektet e restaurimit dhe restaurimi i monumenteve të kulturës bëhen nga institucione shtetërore të specializuara dhe nga subjektet e licencuara për këtë qëllim. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve miraton kriteret për licencimin e subjekteve e të personave fizikë e juridikë. Ky këshill, pas plotësimit të kriterëve të miratuara për këtë qëllim, i propozon Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve licencimin e personave fizikë ose juridikë në fushën e projektimit ose të restaurimit të objekteve të trashëgimisë kulturore. Rregullat dhe kriteret e punimeve të restaurimit në objektet e trashëgimisë kulturore përcaktohen në Kartën Shqiptare të Restaurimeve, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave me propozimin e Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve. Me rëndësi është edhe ndryshimi që bëhet në pikën 1 të nenit 25 lidhur me përcaktimin e objekteve në vrojtim. Sipas këtij ndryshimi, objekte në vrojtim janë të gjitha objektet në gjendje rrënoje, kështjellat, objektet e kultit, ndërtimet inxhinierike, ndërtimet publike ose të luksit, të ndërtuara përpara vitit 1900, si dhe ato në shfrytëzim, të ndërtuara përpara vitit 1944, ose edhe në raste kur kemi raste ndërtimesh të spikatura edhe pas këtij viti. Ndryshimet në nenin 50 kanë të bëjnë me procedurat për vënien e gjobës në rastet e kundërvajtjeve administrative. Ligji ka 16 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006 në faqen 2865.

Ligji nr. 9593, datë 27.7.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8950, datë 10.10.2002 “Për gjendjen civile”, të ndryshuar. Në nenin 2 të ligjit në fuqi janë shtuar dy paragrafë, të cilët përkufizojnë nocionet “vendbanim” dhe “vendqëndrim”. Kështu, sipas këtyre shtesave, vendbanimi është njëësia e qeverisjes vendore, ku shtetasi ka banesën e vet për një periudhë më të gjatë se një vit, kurse vendqëndrimi është njëësia e qeverisjes vendore ku shtetasi ka banesën e vetë për një periudhë më shumë se 45 ditë dhe më pak se një vit. Neni 12 i ligjit në fuqi titullohet “Transferimi dhe bashkimi i familjes”, kurse pas ndryshimit titullohet “Transferimi, bashkimi

i familjes dhe deklarimi i vendqëndrimit”. Pra, siç shihet harmonizohet me dy ndryshimet që përmendëm më lart. Po në nenin 12 është shtuar pika 4/1 sipas të cilit shtetasit që qëndrojnë në një njësi vendore për më shumë se 45 ditë dhe më pak se një vit, janë të detyruar të deklarojnë pranë zyrës së gjendjes civile vendqëndrimin e tyre. Shtetasit nuk mund të deklarojnë dhe të kenë njëherazi më shumë se një vendqëndrim. Deklarimi regjistrohet në zyrën e gjendjes civile të vendqëndrimit. Zyra e gjendjes civile të vendqëndrimit të shtetasit njofton zyrën e gjendjes civile të vendbanimit, cila bën shënimin përkatës. Në nenin 19 të ligjit në fuqi tregohet se cilët janë regjistrat e gjendjes civile, dhe në fakt ato janë: “Regjistri themeltar i gjendjes civile” dhe “Regjistri Kombëtar i Gjendjes Civile”. Me shtesën që i bëhet tani do të kemi edhe “Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile, me vendbanim” dhe “Regjistrin Themeltar të Gjendjes Civile, me vendqëndrim”. Në nenin 24 ku tregohet mënyra e plotësimit të regjistrave, është shtuar një pikë që tregon mënyrën e plotësimit të regjistrave të rinj që janë shtuar. Kështu për krijimin e regjistrave themeltarë të gjendjes civile, me vendqëndrim, përdoren të dhënat e përditësuara, që përmbajnë regjistrat e përkohshëm të shtetasve, të krijuara në zbatim të ligjit nr. 9296, datë 21.10.2004 “Për verifikimin, identifikimin e shtetasve nga njësitë e qeverisjes vendore” dhe të ligjit nr. 9087, datë 19.6.2003 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”. Ligji ka 9 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2896.

Ligj nr.9594, datë 27.7.2006 “Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në Konventën Ndërkombëtare Detare “Për parandalimin e ndotjeve nga anijet, 1973”, të ndryshuar me Protokollin e vitit 1978 (MARPOL 73/78). Sipas kësaj Kovente palët angazhohen të zbatojnë dispozitat e saj, si dhe dispozitat e Ankesave me qëllim që të parandalohet ndotja e mjedisit detar nga hedhjet e substancave të dëmshme ose të ujërave të përdorura të anijeve që përmbajnë substanca të tilla në kundërvajtje me

dispozitat e Konventës. Konventa zbatohet për anijet e autorizuar, që mbajnë flamurin e një pale të Konventës, dhe për anijet që nuk janë të autorizuar të mbajnë flamurin e një pale, por që përdoren nën autoritetin e një pale tjetër. Konventa nuk zbatohet për anijet e luftës ose anijet ndihmëse të luftës. Në Konventë gjenden edhe llojet e kundërvajtjeve dhe sanksionet ndaj tyre, procedurat për rregullat e posaçme speciale lidhur me inspektimin e anijes, procedurat e nënshkrimit, të ratifikimit, pranimit, miratimit dhe anëtarësimit, procedurat për amendamentet dhe promovimin për bashkëpunimin teknik. Kjo Konventë është miratuar më 2.11.1973 dhe i janë bërë shumë ndryshime me Protokollin e vitit 1978. Pjesë të Konventës janë edhe 6 Aneksë. Aneksi 1 trajton rregullat në lidhje me parandalimin e ndotjes nga hidrokarburet. Aneksi 2 trajton rregullat në lidhje me parandalimin e ndotjes nga substancat e lëngshme të dëmshme të transportuara rifuxho. Rregullat në lidhje me parandalimin e ndotjes nga substancat e dëmshme të transportuara nga deti me koli trajtohen në Aneksin 3, kurse Aneksi 4 përmban rregulla në lidhje me parandalimin e ndotjes nga ujërat e përdorura të anijeve, Aneksi 5 përmban rregullat për parandalimin e ndotjes nga plehrat e anijeve dhe Aneksi 6 rregullat për parandalimin e ndotjes së atmosferës nga anijet. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 1.9.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.90 të vitit 2006 në faqen 3505. Ligji i bashkëlidhet Konventa dhe anekset, të cilat gjenden nga faqja 3505 deri në faqen 3780 të Fletores Zyrtare.

Ligji nr. 9595, datë 27.7.2006 “Për krijimin e Inspektoratit Qendror Teknik”. Inspektorati, për të cilin bëhet fjalë në këtë ligj, krijohet si Inspektorat Qendror Teknik, në varësi të ministrit përgjegjës për ekonominë. Funkcionet, kompetencat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për Inspektoratin Shtetëror të Kontrollit të Naftës dhe Gazit, Inspektoratin e Pajisjeve me Presion dhe Inspektoratin e Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike, si dhe asetet, të drejtat dhe detyrimet e këtyre inspektorateve, i kalojnë Inspektoratit Qendror Teknik. Ky inspektorat

drejtohet nga Kryeinspektorati, i cili emërohet dhe shkarkohet nga ministri përgjegjës për ekonominë, kurse struktura dhe organika miratohen nga Kryeministri, me propozimin e ministrit përgjegjës për ekonominë. Ministri përgjegjës për ekonominë, miraton, gjithashtu, edhe rregulloren e brendshme të Inspektoratit Qendror Teknik. Inspektorati Qendror Teknik është institucion publik buxhetor dhe siguron të ardhura edhe nga shërbimet që kryhen në zbatim të legjislacionit në fuqi, të cilat derdhen 100 për qind në Buxhetin e Shtetit. Ky buxhet është i veçantë dhe miratohet me buxhetin e ministrisë përgjegjëse për ekonominë. Buxheti i Inspektoratit Qendror Teknik për vitin 2006, ishte buxheti i miratuar për Inspektoratin Shtetëror të Naftës dhe Gazit, Inspektoratin e Instalimeve dhe Pajisjeve Elektrike dhe Inspektoratin e Pajisjeve nën Presion. Emërtimet “Inspektorati Shtetëror i Kontrollit të Naftës dhe Gazit” (të parashikuar në ligjin nr. 8450, datë 24.2.1999), Inspektorati i Pajisjeve dhe Instalimeve Elektrike” (parashikuar në ligjin nr. 8734, datë 1.2.2001) dhe “Inspektorati i Pajisjeve nën Presion” (parashikuar në ligjin nr. 8739, datë 12.2.2001) zëvendësohen me emërtimin “Inspektorati Qendror Teknik”. Ligji ka 8 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2871.

Ligji nr. 9596, datë 27.7.2006 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ligjit nr.8560, datë 22.12.1999 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë” i janë bërë disa shtesa e ndryshime me 7 ligje në vitet 2000, 2001, 2002 (dy herë), 2003 (dy herë) dhe 2004. Shtesa dhe ndryshime bëhen edhe në ligjin e lartpërmendur, pra me ligjin nr. 9596, datë 27.7.2006. Kështu në nenin 17/2 “Detyrat e Policisë Tatimore”, pas pikës 7, shtohet pika 7/1 me këtë përmbajtje: “Verifikon në vend numrin e punonjësve të punësuar te punëdhënësi dhe vendos penalitetet e përcaktuara në nenin 52/3 të ligjit për çdo punonjës të padeklaruar në administratë tatimore”. Ndryshim bëhet edhe për pajisjen me certifikatë

tatimore, të parashikuar në pikën 2 të nenit 30. Sipas ndryshimit, për t'u pajisur me certifikatë tatimore, tatimpaguesi duhet të paraqesë vetëm vendimin e gjykatës dhe të plotësojë formularin "Kërkesë për regjistrim". Administrata tatimore përpunon kërkesën për certifikatë tatimore brenda 5 ditëve nga data e paraqitjes së kërkesës. Tatimpaguesi regjistrohet vetëm një herë, në çastin e fillimit të veprimtarisë ekonomike. Nëse tatimpaguesi nuk pajiset me certifikatë tatimore brenda pesë ditëve, ai quhet i regjistruar. Pika 3 e nenit 30 "Pajisja me certifikatë tatimore" shfuqizohet. Ligjit në fuqi i shtohet neni 52/3 pas nenit 52/2. Neni 52/3 trajton shkeljet dhe dënimet për mosregjistrimin ose mosdeklarimin e punonjësve për sigurimet shoqërore e shëndetësore. Kështu mosdeklarimi i çdo punonjësi në administratën tatimore konsiderohet shkelje dhe përveç detyrimit për pagimin e shumës së kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore të papaguara ose të tatimeve të papaguara, dënohet edhe me 10.000 lekë gjobë për çdo punonjës të padeklaruar. Në këtë rast, gjoba për çdo punonjës të padeklaruar vendoset në vend nga punonjësi i Policisë Tatimore ose çdo punonjës tjetër i administratës tatimore, i autorizuar për këtë qëllim. Vlerësimi i shumës së kontributeve ose i shumës së tatimeve, që duhet të paguajë tatimpaguesi, sipas asaj çka u tha më lart, bëhet nga punonjësit e vlerësimit në bazë të dhënave të punonjësve të Policisë Tatimore ose të çdo punonjësi tjetër të kësaj administrate, të autorizuar me shkrim për kontrollin e numrit të punonjësve. Ligji ka 5 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2872.

Ligji nr. 9597, datë 27.7.2006 "Për një ndryshim në ligjin nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", të ndryshuar. Sipas pikës 2 të nenit 26 (Importimi i mallrave) të ligjit nr. 7928, datë 27.4.1995 "Për tatimin mbi vlerën e shtuar", tatimi mbi vlerën e shtuar llogaritet, zbatohet dhe paguhet në importimin e mallrave sikur tatimi mbi vlerën e shtuar i pagueshëm është taksë doganore e përcaktuar nga ligji nr. 7609, datë

22.9.1992 “Për tarifatat doganore”. Me ndryshimin që i bëhet me ligjin nr. 9597, datë 27.7.2006 kësaj pike, përcaktohet se për makineritë dhe pajisjet e importuara nga personat e tatueshëm, në kuptim të këtij ligji, në funksion të veprimtarisë së tyre ekonomike, pavarësisht llojit të saj, zbatohet shuma e shtyrjes së pagesës së tatimit mbi vlerën e shtuar deri në gjashtë muaj. Sipas kësaj skeme, tatimi mbi vlerën e shtuar nuk paguhet në doganë në çastin e importit. Skema e shtyrjes së pagesës përcaktohet me udhëzim të Këshillit të Ministrave. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2873.

Ligji nr. 9598, datë 27.7.2006 “Për një ndryshim në ligjin nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat”, të ndryshuar. Ligji nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” përmban 56 nene dhe ka edhe Shtojcën 1 që bëhet pjesë e ligjit. Kjo Shtojcë tregon mallrat e tatueshme me akcizë. Po në këtë Shtojcë gjendet Kodi NK, domethënë klasifikimi i mallrave sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave, bazuar në sistemin e harmonizuar, gjendet përshkrimi i mallrave dhe shkalla tatimore. Me ligjin nr. 9598, datë 27.8.2006, Shtojca 1, bashkëlidhur ligjit nr. 8976, datë 12.12.2002 “Për akcizat” zëvendësohet me Shtojcën 1 që i bashkëlidhet ligjit nr. 9598, datë 27.7.2006. Sipas Shtojcës të re, ka vetëm rritje të shkallës tatimore, kryesisht në artikuj si kafeja, alkooli dhe pijet alkoolike, duhani dhe nënproduktet e tij. Ligji ka 2 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2874.

Ligji nr. 9599, datë 27.7.2006 “Për një shtesë në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar. Me ligjin e lartpërmendur, reduktohen në 0 për qind tarifatat doganore për disa nga kodet doganore të krerëve 84, 85 e 87 të nomenklaturës së mallrave. Ky ndryshim bëhet duke shtuar nenin 1/4 në ligjin nr. 8981, datë 12.12.2002. Sipas Aneksit që i bashkëlidhet ligjit, krerët

84, 85 e 87 përmbajnë më shumë se 687 artikuj që reduktohet në 0 për qind tarifa doganore. Këta artikuj përdoren kryesisht në industri, bujqësi e artizanat, si p.sh. gjeneratorë, turbina, pajisje për mjete ujore, detare, pompa, njësi hidraulike, traktorë, motorë me avull, pompa të llojeve të ndryshme, kompresorë, makineri për impiante pastruese, makineri për përgatitjen e ushqimeve të kafshëve, inkubatorë, bateri të të gjitha llojeve, motokultivatorë, makina vinç, autobetonierë, makine zjarrfikëse, makineri për pompimin e betonit etj., etj. Në Aneks gjendet klasifikimi i mallrave sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave, përshkrimi i tyre dhe niveli i tarifës tatimore, sa ishte dhe sa bëhet. Ky Aneks fillon me kodin tarifor 84041000 dhe mbaron me kodin tarifor 87099000. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84, të vitit 2006, në faqen 2877. Ligjit i bashkëlidhet Aneksi.

Ligji nr. 9600, datë 27.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Ndryshimet që bëhen në nenet 10 dhe 14 të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë” kanë të bëjnë me masën e kontributeve që paguhet për sigurimet shoqërore në fondet e sigurimeve për sëmundje, barrëlindje dhe pensione (neni 10) dhe me shpërndarjen e kontributeve në tri degët që administrojnë fondet e sigurimeve shoqërore. Neni 15 i ligjit në fuqi trajton pagesat e kontributeve. Ky nen ndryshohet tërësisht dhe, sipas nenit të ndryshuar, punëdhënësit dhe të vetëpunësuarit, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, i paguajnë kontributet në fondin e sigurimeve shoqërore, sipas afatit dhe procedurave të përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”. Të vetëpunësuarit në bujqësi i paguajnë kontributet gjatë vitit kalendarik, një herë në tre muaj. Afati i pagesës së tyre është jo më shumë se dita e fundit e muajit të tretë, brenda çdo

tremujori kalendarik. Është ndryshuar tërësisht edhe neni 16 që trajton sanksionet. Sipas ndryshimit, ndaj punëdhënësve dhe të vetëpunësorve, përjashtuar personat e vetëpunësuar në bujqësi, që nuk zbatojnë afatet dhe procedurat e pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore, zbatohen sanksionet e përcaktuara në ligjin nr. 9136, datë 11.9.2003 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”. Nëse personat e vetëpunësuar në bujqësi nuk i paguajnë kontributet në afatet e përcaktuara në këtë ligj, ata detyrohen të paguajnë kamatëvonesa, të cilat llogariten mbi shumën e kontributeve të papaguara. Kamatëvonesa për kontributet e paguara jashtë afateve është 2 për qind muajin e parë ose pjesë e tij dhe 1 për qind muajin për çdo muaj që vijon. Kamatëvonesa zbatohet e plotë, si në rastin kur vonesa është për 1 muaj të plotë, ashtu edhe kur periudha e vonesës është më e vogël se 1 muaj. Edhe neni 81 që trajton problemin e regjistrimit të personave juridikë, publikë e privatë dhe personat fizikë, që fillojnë veprimtari ekonomike për herë të parë, ka ndryshuar tërësisht. Ligji ka 6 nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006, në faqen 2906.

Ligji nr. 9601, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006””. Me ligjin nr. 9601, datë 28.7.2006 janë bërë ndryshime gati në të gjitha nenet e ligjit nr. 9464, datë 28.12.2005 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2006”. Sipas nenit 1, Buxheti i Shtetit kishte parashikuar si të ardhura 221.745 milionë lekë, shpenzime 258.376 milionë lekë dhe një deficit prej 36.631 milionë lekë. Me ndryshimin e nenit 1, të ardhurat planifikohen 229.932 milionë lekë, shpenzimet 226.751 milionë lekë dhe deficitin 36.819 milionë lekë. Ndryshime ka edhe te Fondi i Konsoliduar në Buxhetin Qendror, duke ndryshuar të ardhurat nga 170.507 milionë lekë në 181.532 milionë lekë dhe shpenzimet nga 207.138 milionë lekë në 218.351 milionë lekë. Përse i përket Buxhetit të Pushtetit Vendor (gjithmonë të fondi i konsoliduar) të ardhurat nga 21.316

milionë lekë parashikohen në 23.100 milionë lekë, kurse shpenzimet nga 21.316 milionë lekë në 23.100 milionë lekë. Buxheti i sigurimeve shoqërore (skema e sigurimit të detyrueshëm shoqëror) ndryshon nga 49.030 milionë lekë shpenzime dhe po kaq të ardhura në 50.271 milionë lekë të ardhura dhe po kaq shpenzime. Në skemën e sigurimit suplementar të ardhurat e shpenzimet ndryshojnë nga 3.575 milionë lekë të ardhura e po kaq shpenzime në 3.534 milionë lekë të ardhura e shpenzime. Në burimet për mbështetjen e shpenzimeve të fondit të konsoliduar është parashikuar që grandet nga 8.637 milionë lekë të jenë 6.000 milion lekë, të ardhurat tatimore nga 154.338 milionë lekë në 159.000 milion lekë. Kufiri i financimit të Buxhetit të Shtetit nga burime të brendshme mbetet i njëjtë, 26.797 milion lekë, por ndryshon financimi nga të ardhurat e privatizimit që shtohen nga 3000 milion lekë në 4000 milion lekë, kurse kufiri neto i financimit nga burime të huaja bëhet nga 9.834 milion lekë në 10.022 milion lekë. Ndryshime në shifra në rritje ka edhe në shpenzimet e fondit të konsoliduar. Fondi rezervë për rritjen e pagave nga 3.325 milion lekë bëhet 3.631 milion lekë. Ligjit i bashkëlidhen disa tabela siç janë Tabela 1 (Buxheti i vitit 2006 sipas ministrive dhe institucioneve, Tabela 1/1 (Institucionet e pavarura), Tabela 2 (Investimet sipas ministrive), Tabela 3 (Organet e drejtësisë) dhe Tabela 4 (Transferta e pakushtëzuara nga bashkitë e komunat). Ligji ka 11 nene dhe ka hyrë në fuqi më 23.8.3006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 85 të vitit 2006, në faqen 2911. Ligjit i bashkëlidhen tabelat.

Ligji nr. 9602, datë 28.7.2006 “Për disa ndryshime në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”. Në nenin 4 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore” jepen kuptimet e disa termave që përmban ligji. Kështu, në pikën 13 të nenit 4 jepet kuptimi i termave “Të ardhurat e familjes”. Sipas shpjegimit që i bëhet, të ardhurat e familjes janë të ardhurat e të gjithë anëtarëve të familjes nga çdo lloj burimi, duke përfshirë edhe ato që përkohësisht jetojnë

dhe punojnë jashtë shtetit. Nuk përfshihen në të, të ardhurat e familjes, pagesat që marrin pjesëtarët e familjes me aftësi të kufizuar mendore ose fizike, të verbrit, paraplegjikët e tetraplegjikët, përfitimet e invalidëve sipas statusit të Invalidit të Punës, si dhe pagesat për fëmijët e lindur trinjakë a më shumë. Me ligjin nr.9602, datë 28.7.2006 përjashtohen të verbrit, pra kjo do të thotë që pagesa e tyre do të përfshihet në të ardhurat e familjes. Në nenin 7 të ligjit nr. 9355, tregohet se kush janë përfitues të pagesës për aftësi të kufizuar. Ky nen ka 4 pika. Në pikën 1 përmenden si përfitues të verbrit, me mungesë të plotë ose të pjesshme të shikimit, të lindur ose të fituar, të cilët janë deklaruar të paaftë për punë me vendim të Komisionit Mjekësor të Përcaktimit të Verbërisë. Me ligjin e lartpërmendur, pra me ligjin nr. 9602, datë 28.7.2006, pika 1 e nenit 7 të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005 “Për ndihmë dhe shërbimet shoqërore”, shfuqizohet. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 24.8.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 84 të vitit 2006.

Ligji nr. 9603, datë 28.7.2006 “Për ratifikimin e “Marrëveshjes financiare ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA) për projektin “Cilësi dhe barazi në arsim””. Sipas kësaj Marrëveshjeje Financiare, Shoqata Ndërkombëtare për Zhvillim (IDA), që më tej do citohet “Shoqata” i jep Republikës së Shqipërisë, që më tej citohet “Marrësi” një hua me një vlerë prej 10.500.000 të Drejta Speciale Tërheqjeje (Special Drawing Rights-SDR) për të ndihmuar në financimin e projektit “Cilësi dhe barazi në arsim”. Pikësynimet e projektit janë në mbështetje të programit për të përmirësuar cilësinë e kushteve të mësimdhënies për studentët, për të rritur regjistrimin në shkollë (ndjekjen e shkollës) nga studentët e arsimit të mesëm dhe për të filluar reformën në arsimin e lartë. Projekti konsiston në forcimin e menaxhimit, lidërshiptit dhe qeverisjes në sistemin arsimor nëpërmjet zhvillimit dhe zbatimit të trajnimeve për lidërshiptin dhe programin e zhvillimit profesional për drejtorët e shkollave, trajnimin e punonjësve të financës dhe prokurimeve në nivel qendror, rajonal

dhe vendor. Sipas Projektit, synim është edhe përmirësimi i cilësisë së rendimentit mësimor, nëpërmjet mësimdhënies dhe mësimnxënies në sistemin arsimor parauniversitar, duke paraqitur zbatimin e metodave të reja, kurikulave dhe teknologjive të informacionit dhe komunikimit në shkollat e arsimit bazë dhe të mesëm, përgatitjen e një manuali për përzgjedhjen e shkollave, të cilat do të marrin pjesë. Pjesë e projektit është edhe zhvillimi dhe përmirësimi i infrastrukturës arsimore, ku përfshihen përgatitja e vazhdueshme e hartës së shkollave dhe inventarit të mjediseve arsimore, zhvillimi i kriterëve për rehabilitimin e shkollave dhe ndërtimi i shkollave të reja etj. Modernizimi i sistemit të arsimit të lartë është, gjithashtu, pjesë e projektit. Për zbatimin e përgjithshëm të Projektit do të jetë përgjegjëse Ministria e Arsimit dhe Shkencës. Këtu do të përfshihet edhe vendosja e përparësive dhe bashkëpunimi i veprimtarive të Projektit, përgatitja e programeve vjetore për reformën dhe monitorimin e mjeteve mbrojtëse dhe të besueshme, siç është paraqitur në Manualin Operacional (MO). Në Marrëveshje janë përcaktuar edhe procedurat e rregullat për prokurimet. Kështu, për të gjitha mallrat dhe punimet që nevojiten për Projektin, dhe që do të financohen nga jashtë të ardhurave të financimit, do të prokurohen në përputhje me kërkesat që përcaktohen ose që referohen në seksionin I të Udhëzimeve të Prokurimeve dhe me dispozitat e këtij Programi. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 5.9.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr. 91 të vitit 2006, në faqen 3785. Ligjit i bashkëlidhet dhe Marrëveshja e Financimit, 3 programe dhe 1 shtojcë.

Ligji nr. 9604, datë 11.9.2006 “Për ratifikimin e “Konventës së bashkëpunimit policor për Europën Juglindore””. Për miratimin e kësaj Konvente palët janë nisur nga dëshira për të bashkëpunuar në përmbushjen e interesave të përbashkëta të sigurisë dhe për të luftuar me frytshmëri kërcënimet ndërkuftare ndaj rendit dhe sigurisë publike, si dhe krimin ndërkombëtar, duke hyrë në një partneritet për sigurinë. Ata do të forcojnë bashkëpunimin ndërmjet tyre në luftën kundër kërcënimeve dhe sigurinë publike, duke zbatuar ligjin kombëtar, nëse nuk parashikohet ndryshe në këtë

Konventë. Kjo e fundit trajton edhe problemet për marrjen e masave të përgjithshme të bashkëpunimit dhe të bashkëpunimit sipas kërkesës, duke vendosur detyrimin që palët duhet të japin asistencën e ndërsjellë brenda kuadrit të juridiksioneve të tyre përkatëse, për të marrë masa kundër kërcënimeve ndaj rendit ose sigurisë publike dhe për të parandaluar, zbuluar dhe hetuar veprat penale. Konventa ka parashikuar edhe zgjidhjen e problemeve që i përkasin sferës së informacioneve që shkëmbehen, shkëmbimit të informacionit pa kërkesë, shkëmbimit të rregullt të informacionit për të luftuar migracionin ilegal etj. Palët kontraktuese mund të përfundojnë marrëveshjen dypalëshe, duke mundësuar atashimin e oficerëve të kontaktit, për një periudhë të caktuar ose të pacaktuar kohore, nga një palë kontraktuese tek autoritetet e zbatimit të ligjit të një pale tjetër kontraktuese. Në këtë kuadër janë parashikuar detyrime për mbrojtjen e dëshmitarëve, janë dhënë me hollësi procedurat për ndjekjen në gjendjen e flagrancës, survejimin ndërkufitar, për hetimet e fshehta të krimeve, për kërkesat për mbledhjen e provave në rast të rrezikut imediat, për kërkesat për ekzaminimin fizik etj. Për plotësimin e detyrimeve të përmendura më lart, Konventa ka përcaktuar se cilat janë autoritetet përgjegjëse, cili është pozicioni ligjor i punonjësve të policisë që operojnë, cilat janë kushtet e bashkëpunimit, kur mund të kufizohet bashkëpunimi, si duhet të mbrohen të dhënat etj. Për mbarëvajtjen e punës, Konventa urdhëron ngritjen e një Komiteti të përbërë nga ministrat kompetentë të palëve kontraktuese. Komiteti i Ministrave vendos në mënyrë unanime për interpretimin, miratimin dhe zbatimin e kësaj Konvente. Institucioni për depozitim të kësaj Konvente është Republika e Shqipërisë. Versioni përfundimtar i Konventës është bërë më 31.3.2006 dhe është firmuar nga Republika e Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovina, Republika e Maqedonisë, Republika e Moldavisë, Rumania, Republika e Serbisë dhe Republika e Malit të Zi. Ligji ka dy nene dhe ka hyrë në fuqi më 28.10.2006. Botuar në Fletoren Zyrtare nr.107 të vitit 2006 në faqen 4199. Ligjit i bashkëlidhet Konventa.

